

VATH KORESHI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

1291

ndërrimi
i gjëjeve

tregime

214-5
K 91

VATH KORESHI

NDERRIMI I QIEJVE

T R E G I M E

57048

BIBLIOTEKA E SHËTETIT
GJIROKASTER

1578

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

F A T A

Ajo ishte plakë dhe rronte fare e vetme në një shtëpi në të dalë të fshatit. Shtëpia ishte e vjetër, në haure kakarishin pulat dhe te dera flinte një qen që mundohej të kapte miza. Po mizat ishin të shpejta dhe qeni kuiste me dëshpërim, duke futur turinjte midis putrave të ndotura.

— Të hanë, o i zi? — murmuriste plaka, kur dëgjonte qenin që kuiste. Dikur ai kishte qenë i fortë dhe i shkathët, po tani e pat thyer pleqëria e strukej haureve dhe flinte gjithë ditën.

Dhe plaka dikur kishte qenë një grua e shkathët dhe e bukur, po tani ishte plakë, këmbët i dhembnin nga reumatizma dhe sytë i kishte të përlotur. Ajo mezi ngrihej dhe dilte çalë-çalë në oborr, për të hapur çarçafin e misrit në diell. Pulat rendnin pranë çarçafit dhe ajo mundohej t'i përzente me plisa.

— Ah, ju preftë një flamë, moj të mallëkuara!

Po pulat e dinin që plaka ishte zemërmirë dhe nuk ja kishin frikën. Ato bënin ka-ka-ka, shkonin gjer te gardhi, ku harliseshin llastarët e fryrë nga lëngu të kungujve dhe ktheheshin prapë te misri.

Prapa shtëpisë plaka kishte një kopsht dhe një arë të vogël zhurigë, që e mbillte me thekër. Thekri vinte i mbarë dhe asaj i gëzohej syri, kur shikonte kallinjte

e blertë që i lëkundte era. Tokën ja punonin fqinjët, ata ishin njerëz të mirë dhe e donin këtë grua kërcure. I bënin dru, i korrnin arën dhe i bluanin në mulli. Bile kishin dashur ta merrnin në shtëpitë e tyre, po ajo s'kishite dëgjuar të ikte nga ajo vjetërsirë e saj që mezi rrinte në këmbë dhe nga ara e saj e thektrit.

Gjithë ditën kjo plakë vërtitej nëpër oborr si hije, duke folur në më të shumtën e herës me vete. Atë e merrte malli të bisedonte me njeri; kështu që herë fliste me vete, herë me lopën, Murgjinën, kur e nxirrte nëpër mezhda për ta kullotur, herë me pulat që i vardiseshin misrit dhe herë-herë i hakërrohej atij çamarrokut të vogël, viçit të Murgjinës, që shpëtonte nga kapistalli dhe rendte si i tërbuar nëpër oborr, duke trembur pulat e duke i rënë me kokë qenit plak. Ajo e kapte nga turinj-të, viçi zgurdullonte sytë e i lëshonte frymën në fytyrë, pastaj i lëpinte duart me atë gjuhën e gjatë e të ashpër.

Ishte një plakë që rronte fare e vetme dhe të hënave pasdite, vinte një shall të zi në kokë e ulej buzë rrugës duke shikuar matanë kaptirave nga ktheheshin ata që shkonin për pazar. Shkarravitte me majën e shkopit në tokë dhe mendohej me sytë të ngulur matanë gjerdheve që i trazonin erërat që zbrisnin nga varoshet. Ajo priste të kthehej Banushi nga pazari, hipur në atë gomarin e tij të vogël me këmbë të shtrembëra e me një torbë leshi në shpinë. Banushi vinte dhe herë i thoshte se s'kishite marrë vesh gjë, herë i thosh se Lifka kish bërë ca zullume andej nga fshatrat e bregut. I kish dalë një fshatarri në rrugë dhe i kishte marrë paratë e qeve. Plaka rrudhte buzët dhe tundte kokën me dëshpërim:

— Si u bërë, mor i zi, si u bërë!

Kishin kaluar 12 vjet që atëhere kur te plaka nisi të vinte dendur e më dendur Lifka. Ai ish një çunak dhjetë vjeç, me ca leshra të trasha ngjyrë kërpi e hundën e kish me quka. Ata të Lirkës e kishin shtëpinë në faqen tjetër të kodrës, kishin një tufë fëmijë dhe ishin fare të këputur. Plakës i gëzohej zemra kur shihte këtë çunak

që zbriste faqes së kodrës, që kapërcente pastaj gëmushat e rrodheve në kopsht dhe vinte tek ajo. Plaka i jepte një grusht me arra, ai ulej në një shkëmb druri e niste t'i çante, duke tundur gjurin.

Lifka ish një çamarrok i prapë, që s'linte dy gurë bashkë. Kur plaka shkonte prapa shtëpisë, ai rendte te koçeku, merrte një kallam bërë apostafat për ta futur nëpër të çarat e dërrasave dhe i pinte qumështin nga tava. Por plaka nuk i thoshte gjë, sepse s'desh ta zemëronte dhe ta përzente këtë djalë. Ajo ishte fare kërcure, fëmijë nuk kishte dhe ai sikur ja mbushte shtëpinë plot.

Një natë ajo e mbajti për të fjetur. I bëri një përsesh me qumësht, i dha arra e bajame dhe pastaj e vuri të flinte. Atë e zuri gjumi si shqerrë e plaka i rrinte mbi kokë, duke i murmuritur fjalë që i rridhnin si mjaltë. Fytyra e Lifkës sikur ëmbëlsohej nga kjo dashuri që përgjonte mbi të, buzëqeshte e zbukurohej. Plaka i lëmonte flokët, e mbulonte me kujdes dhe e puthte në ballë.

Një ditë ajo i tha të atit të Lifkës:

— Jepma mua atë djalë, o Sulo! Ti ke një vatër e zoti të t'i falë! Jepma ta rris unë! Bukë kam, ca bulmete kam, do ta mbaj si djalin tim. Pastaj ja ku e ke. Vjen dhe e sheh dhe ai do të vijë e do t'ju shohë.

Sulos i vinte keq ta nxirrte djalin nga shtëpia, por fundja plaka ja ku ish dhe ja dha.

Kështu që kjo grua kërcure u bë me djalë. Dhe mbrëmjeve, teksa e vinte në gjumë, nisi t'i këndonte një këngë që e kish blamburitur kaq e kaq herë me veten e saj:

*Prit, o Dalan bej, prit të rritet djali,
pa plumb do të derdh në lule të ballit.*

Një dhembje dhe një urrejtje e egër ja shtrembëronte buzën kur sillte ndër mend Dalan beun. I gjori Memë, burri i saj, shkoi e u ngatërrua me beun e sarajit për të ngrënë kokën e vet. I dha paratë për blerjen e një livadh i të nxirosur, po paratë beu i hëngri dhe livadhin nuk e lëshoi. Prit sa të korr barë, prit sa të ndaj sinorë dhe

më në fund e bëri fjalën hasha. Atëherë Mema, levend burrë sa dilte një kokë mbi shokët, i drejtë dhe gjaknxehtë, ja përplasi beut në fytyrë këtë maskarallëk atje në mes të pazarit:

«Që kur, o bej paske zënë të hash fjalën dhe paratë të kështu?»

Beu, hipur në majë të kalit, qe nxirë e qe vrejtur dhe u kish thënë qehajallarëve:

«Hiqmani sysh këtë pizeveng, se flet përçart!»

Tri javë pas kësaj grindje në pazar, beu, që qe zëmëruar keq, futi Mesun Qorrin dhe e vrau Memën te livadhet e Sopokut.

Atëhere kjo plakë ishte një grua e re dhe, kur i thanë se burrin ja patën vranë te livadhet e Sopokut, hodhi një shami të zezë në kokë dhe shkoi dhe e ngriti vetë. Gratë e mëhallës shkulnin faqet dhe qanin me dënësë për Memën e shkretë, po ajo rrudhte buzët, tuntte kokën me një pikëllim të thellë dhe nuk derdhi një pikë lot.

Mema i la një djalë, Mevlanin, që rritej i gjatë e syrin pishë, gjallë i ati. Atë vit që u vra Mema, Mevlani ish një djalë nëntë vjeç dhe pat qarë me ca britma të çuditshme sa u këputi zemrën të gjithëve. Qe përplasur mbi sënduk dhe nuk lëshonte lot, po sokëllinte me gjithë gjoksin: Aj, aj, aj!

Mevlani, megjithëse fëmijë, kishte vështrim prej të rrituri. Atëhere bënte klasën e dytë në Eret dhe vetë shkonte, vetë vinte dy orë rrugë me çantën në shpinë, i heshtur, i dashur, por serioz e me ata sytë e errët që të vështronin si një i madh. Ditën që i vranë të atin, shkroi në një fletore që e mbante në sënduk: «Sot, më 30 të marsit 192..., më vranë babanë njerëzit e Dalan beut. E shkruaj për mos ta harruar sa të jetë bota».

E ëma u rropat ta rritte këtë djalë mirë e më mirë. I shoqi kish dashur që të birin ta bënte me shkollë dhe ajo hëngri dynjanë me vuajtje, për ta rritur e mësuar atë. Si mbaroi klasën e tretë në Eret, ajo e dërgoi te ca miq në Korçë, që të vazhdonte shkollën atje. Po miqtë qëlluan njerëz të ftohtë dhe s'ja patën trajtuar mirë të birin.

Mevlani e ndjente këtë dhe, pa mbaruar klasën e pestë, një ditë dimri me shi e të ftohtë, u kthye vetëm nga Korça, i lagur e i përbaltur. përplasi librat në një qosh dhe u ul pranë zjarrit me sy të murrëtyer nga një mërzi e madhe. Nuk i tha asgjë së ëmës, vetëm vonë në darkë, kur ranë të flinin, i puthi duart dhe për herë të parë u ngashërye në prehër të saj.

Kur u bë gjashtëmbëdhjetë vjeç djalë, Mevlani i doli në pusi Dalan beut, po ai ishte ende një ferishte e njomë. plumbi dredhoi dhe trimat e beut e grinë me thika.

Brenda një jave u plak e u fishk kjo grua nga vdekja e të birit. «Si i duron zemra që s'i plas së nxirosurës!» qanin gratë në heshtje, pasi u hap varri i ri i Mevlanit, atje pranë Memës që qe tretur e po harrohej. Kurse kjo grua e mbetur kërcure, kish rënë në gjuhë dhe kish murruritur në një pikëllim të thellë: «Marrtë zoti hak për të gjitha këto!»

Po u tha bari i vjeshtës mbi varrin e Mevlanit, mbiu bari i ri i pranverës dhe Dalan beun s'po e dënonte as zoti, as robi.

Dhe ja, shpresa e vjetër për të marrë hak, ju ngjall përsëri kësaj plake kërcure, kur mori pranë gjirit të saj atë djalë me leshra të ashpra bojë kërpi dhe me quka te hunda:

*Prit, o Dalan bej, prit të rritet djali,
pa plumb do të derdhë në lule të ballit...*

Po Lifka, kur u bë 17 vjeç, krisi e iku me karvanin e qymyrxhive. U kthyen qymyrxhitë në pranverë, po Lifka nuk erdhi. I thanë se kish zbritur andej nga Tirana, kish hyrë në punë te një bej dhe i dërgonte ca sheqer kokël në një qese të vogël dhe nja dy kausha kafe. Më vonë mori vesh se beu i Tiranës e kishte nisur për në Korçë për të vrarë një hasmin e vet dhe që nga ajo kohë Lifka vërtitej si kaçak. Koburja s'i kish nderur në mes të kafes dhe ai s'mund të kthehej as te beu në Tiranë, as tek ajo në fshat, se punës i pat dalë era dhe e kërkonin kudo.

Vërtitej maleve dhe kish zënë të bënte zullume te njerëzit që ktheheshin nga pazari.

Kur mori vesh të gjitha këto, plaka hyri brenda dhe i hodhi në katua gjithë plaçkat e tij. Dhe u bë e heshtur dhe nuk i hidhte më sytë andej nga sarajet e beut. «Kështu paska qenë e thënë, murmuriste. Tashti rro, or pusht, kur ai që rrita unë u bë pusht».

Po Dalan beu e paskësh pasur mortjen nga tjetër-kush. Qe krijuar partia. Malit dilte djemuria për të përzënë zaptuesit e për të marrë hak te bejlerët e agallarët për vuajtjet e fukarasë. Doli djali i Xhevos, djali i Myrtos. Doli më vonë vajza e madhe e Selimit, pastaj djali i dytë i Xhevos. Dilnin malit dhe kudo ndizej rrapëllima e madhe e luftës për çlirim.

Një mëngjez shtëpia e Xhevos u gdhi e bërë shkumb. Thoshin se ra zjarri nga mullarët, po kjo ishte puna e Dalan beut bashkë me njerëzit e tij të ballit. Një javë më vonë plasi flaka në sarajet e Dalan beut. Xhevoja me të tijtë iku nga fshati dhe beu për hakmarrje çoi dhe vrau një të nipin e Xhevos në arë duke ngarë qetë. Dalan beu, pas kësaj, zbriti në qytet bashkë me njerëzit e tij të ballit dhe sarajeve u mbetën në këmbë vetëm muret e nxira nga tymi.

Dhe atë që donte ajo plakë e kishte bërë djali i Myrtos, Zalu. Erdhën dhe i thanë se Dalan beut ja kishte numëruar djali i Myrtos mu në mes të kasabasë dhe kështu qeni i kishte larë haqet që kishte në këtë botë. Kishte lëshuar duart kjo plakë dhe, duke parë nga shtëpia e Myrtos që nxirrte çatinë mbi pemët e kopshtit, kishte murmuritur: «Kurban nënja ty, more Zalo! Ditët njëmijë t'u bëfshin!»

Këtë gëzim ja farmakosi një lajm që i erdhi për Lifkën. I thanë se ai kishte shkuar me ballin. Plakës i rëndoi plumb në zemër. Plaçkat që ja kishte hedhur në katua, i nxori prapa shtëpisë dhe ja dogji.

«Si të ma nxish faqen, mor i zi?»

Kjo plakë desh ta shihte si ai, kapedani i Myrtos, kurse ai qe bërë një këlysh i ballit kundër partizanëve.

«Si të ma nxish faqen, mor i zi? Të më ishe bërë djalë i partisë e të ma gëzojë zemrën në pleqëri, mor i zi!» murmuriste ajo me dëshpërim.

Në pranverën e dyzetekatrës, partizanët i ranë një autokolone të gjermanit në rrugën e Leskovikut dhe pastaj u tërhoqën për në male. Gjermanët dhe balli u ngjiten nëpër fshatra. Ata morën rrugën e madhe të Drebeshës, dolën në fshatrat matanë Kilbit dhe më pastaj u ngjiten përkëtej.

Në ndajnatë plaka dëgjoji në oborr zëra dhe hapi karnatën e dritares; një tufë burrash me qeleshe të bardha e me shqiponjë në qeleshe ishte dyndur në atë buzë muzgu. Njëri nga ata kishte hipur në këmbët e shkallës dhe shikonte nga ajo, duke qeshur si njeri i njohur. Lifka?! Ajo e njohu nga sytë dhe nga një e çarë që kishte mbi vetull. Lifka që rrëzuar kur ishte i vogël te gurët prapa shtëpisë dhe e kishte carë vetullën si me thikë.

— S'më njeh, a? — ja bëri ai dhe plaka vuri re se zëri i qe trashur e i qe ngjirur.

Ajo tundi kokën, mblodhi buzët si me pikëllim dhe doli në krye të shkallëve.

— A erdhe, a? — ja bëri pa lëvizur nga vendi.

Lifka u bëri me shenjë shokëve dhe ata nisën të ngjiten grrap e grrup nëpër shkallë me ato këpucë të rënda. Ai e qafoi plakën, pastaj hynë në konak, hoqën armët dhe i vunë kopicë pranë derës.

— O nëne! — tha Lifka. — Çfarë ka për të ngrënë? Kemi bërë gjithë ditën rrugë dhe s'kemi vënë gjë në gojë.

— Ku ka plaka për të ngrënë? — tha ajo. — Grua pa burrë e pa njeri, e kam a s'e kam një kothere për vete.

Lifka qeshi me të madhe.

— Më ke mua, mos u mërzit! Ja, sa ta bëjmë Shqipërinë dhe të gjitha të mirat do t'i kesh. Po unë e di, dy pula i ke ti dhe mos i kurse për mua. Më kish marrë malli që ç'të të them.

— Dv pula i kam, — tha plaka — po s'më bën zemra t'i ther. Më duhen për ndonjë vezë.

— E, moj nënë Fata dhe ti!

Ai zbriti në katua me vetulla të rrudhura nga zemërimi, kapi një gjel dhe i këputi kokën te kreu i shkallëve. Pastaj vuri dy ballistë ta ripnin e ta pinqnin.

Ndërkohë krisi lebetia në fshat. Bastisnin shtëpitë e njerëzve të luftës, merrnin çdo mashkull që gjenin dhe e mbyllnin në shtëpinë e Mesun Qorrit. Mallëkimi i grave dhe kuja e kalamajvë të ndillnin lemeri:

Si u shtruan të hanin, brenda erdhi një ballist që kishte rendur me të katra.

— Hë! — ja bëri Lifka, pa e ngritur kokën nga tepsia me mish gjeli.

— Eshtë në stane — tha i porsaardhuri. — Kthehet në sabah.

— Sakën se del njeri nga fshati! — tha Lifka dhe ballisti bëri temena e doli.

«Qenke bërë dhe për temena!» mendoi plaka.

Ata hëngrën e pinë gjer në mes të natës, pastaj morën pushkët e ikën. Plaka s'vuri dot gjumë në sy.

E nesërmja po gdhinte e heshtur dhe e zymtë. Në male nisi të mugëllojë drita e mëkur e agimit, që merrte poshtë honeve dhe përrenjve, duke shtyrë togje muzgu. Ish një mëngjez i thellë dhe i heshtur, në pyje s'frynte grimë ere dhe në qiell ende s'kish nisur fluturimi i zogjve. Vetëm qyqja atje në pyll kish nisur të kërkonte që në ag diçka që s'e gjente kurrë: Ku-ku, ku-ku...

Në rrugën e ngushtë, që shkonte poshtë arës së thekërit, u dëgjuan hapat e një mushke dhe pas kësaj ca britma të ngjirura, vringëllima armësh dhe një tufë burrash që hidheshin mbi dikë në befasi. Plaka hapi derën e ashefit, që binte prapa shtëpisë, dhe atje matanë gomradave të arës një grumbull burrash përlesheshin dhe nxirrnin britma të mbytura. Një tufë qeleshesh të bardha hakërroheshin dhe i hidhnin litarin dikujt. Cilin lidhnin ata ashtu?

Hodhi një sharp të zi në kokë dhe doli me ngarendje. I zihej fryma në atë vrap, këmbët i ngatërroheshin në thekërishtë, po rendte dhe ndjente zemrën që i rëndonte në gjoks. Cilin bir lidhnin atje poshtë gomradave? Në mesnatë ata patën dalë nga shtëpia, ajo kish kujtuar se

thyen qafën andej nga Mesun Qorri, kurse ata paskëshin qenë fshehur në thekërishtë e patën bërë pusi!

Tufa e tyre tani qe egërsuar më shumë; shtyheshin e brrisnin duke lëvizur krahët, hakërrheshin e hungërinin si ujçër. Ajo kapërceu thekrin e doli te shtegu. Në atë kohë një gërdallë me nofulla të dala u shkëput nga turma dhe ju shkreh me egërsi:

— Po ti ku shkon? Hajde kthehu!

Ai zgjati duart ta kthente, po plaka i dha një të shtyrë dhe bëri për nga grumbulli.

— Jazëk ju qoftë! — briti ajo. — A me këtë ferish-te po kapeni?!

Pranë një gorrice të re, që sapo i pat plasur gjethi, kishin vënë djalin e vogël të Myrtos dhe i kishin lidhur duart. Lifka qe bërë si bishë dhe kishte nxjerrë revolverin nga këllëfi. Djali i Myrtos që një çunak 14 vjeç, me flokë të bardhë, po me sy të vegjël e të egër. E kishin kapur tek kthehej nga stanet dhe tani atij i hidhej gjoksi përpjetë dhe shikonte i hakërryer atë tufë burrash.

— Jazëk ju qoftë! — thirri prapë plaka dhe u lëshua drejt tij.

Lifka i zgjati krahun përpara që ta mbante:

— Po ti pse përzihesh këtu? — u ngjir ai. — Hajde ikë!

— Lëreni — bërtiti plaka. — Me këtë ferishte merrni. që ju rëntë pika?

Një ballist mbantë vetullën me dorë dhe që andej i rridhte gjak.

— Ta lëmë thua këtë këlysh komunistësh, a? — dhe shkoi e i ra me shqelm djalit të Myrtos, Nazifit. — Di dhe të çjerrësh, jezit!

— Lërma mua! — u ngjir Lifka me dhëmbë të shtrënguar. — Këta qenër njëlloj janë.

Ai e shtyu Nazifin drejt hendekut dhe ngriti revolverin. Nazifi rrudhi vetullat e njoma, ngriti duart e lidhura, i çoi anës dhe ja ngjeshi hundëve sa i hanin krahët. «Gjallë i vëllai që ja numuroj Dalan beut», mendoj plaka dhe u lëshua drejt Lifkës.

— Lëshoje atë! — i bërtiti dhe ju hodh në krahë. —
Lëshoje, të rëntë pika!

Po Lifka e shtyu me dorezën e revolverit në gjoks,
i dha krahut me sa fuqi kishte përpara dhe ajo u rrëzua
te çizmet e tij.

— Hajde, lart! — bërtiti ai.

Plaka pa si kaluan me nxitim hapat e tyre mbi ko-
kën e saj, e vunë me të shtyra përpara djalin e Myrtos
dhe shkuan drejt pyllit. Zërat e hakërryer u larguan e u
larguan deri sa nuk u ndien më.

Në lëndinën me bar të ri, në fund të arës së thekrit,
zotëroi përnjëherësh një qetësi e thellë. Po lindte dielli.
Plaka dëgjonte frymëmarrjen e vet të rëndë dhe fësh-
fëritjen e tufëzave të barit, që i përziente era. Mushka
e Nazifit kish kapërcyer mezhdën dhe po kulloste pranë
gardhit. Ndjente dhembje në kryqe dhe mezi u ngrit.

Po përse i qenë prerë gjunjët kështu përnjëherësh,
zemra përse i hidhej si zog në kraharor dhe, ndërsa i ka-
lonin mornica në trup, përse shikonte tutje nga pylli me
gjak të ngrirë? Ferishtja e Myrtos, bir, o bir, partizani i
vogël i nënës që mbeti me torbën në krah e mblidhte bu-
kë për shokët e malit. Plakës s'i hiqej nga sytë fytyra e
tij e njomë, por e vrejtur si e një të madhi, vetullat e
bardha të mbledhura shuk nga urrejtja dhe ata krahët e
vegjël e të lidhur që i ngriti në ajër e goditi Lifkën. Fe-
rishtja e Myrtos! Një tufë qensh i ishin hedhur në shpi-
në, sikur trupi i tij i njomë e i përkulshëm të ishte bur-
rrëruar e shkuar burrërimin. Pështyma i qe tharë në
grykë kësaj plake dhe gjunjët i qenë mbërthyer në vend
nga aio pritje gjithë ankth.

«Krau, krau, krau», u dëgjuan tri krisma të
thata dhe pas kësaj heshtja sikur u bë dhe më
e thellë. Vetëm një gulç ere fryu mbas tyre, që
zbriste nga Kilbi ende i mbuluar me borë dhe trazoi me
fëshfërimë të shurdhër gjethet e reja të gorricës. Hesh-
tja sikur pushtoi gjithë qenjen e saj dhe plakës i ngjan-
te sikur zemra nuk i punonte më, sikur era që zbriste
nga Kilbi u mek e mbeti prapa gjerdheve, sikur tufëzat

e reja të barit mbetën mënjanë e nuk frushullonin më, sikur dhe qyqja, që kish zënë që në mëngjez të numëronte vitet e dikujt, heshti e u nemit atje në pyll. Në atë mëngjez herët, mbi luadhet e mbi rrugët, mbi varoshet e mbi hapësirat e largëta sikur ra një muzg ngjyrë hiri pa zhurmë e pa jetë.

Njëëz janë apo hije ata që dolën tek ara e gjatë rrëzë pyllit? Plaka ktheu fytyrën e rrudhur andej dhe e pa grumbullin me qeleshe të bardha që hapnin shalët me nxitim dhe shkonin drejt shtëpisë së saj. Ata kapërcyen arën, dolën te burimi i Meços dhe hynë në oborr.

Plaka shkoi drejt pyllit. Nuk e ndjente më dhembjen e kryqeve dhe gjunjët i ndjente hekur të fortë. Ngjitej nëpër bokërrima, po nuk i dhembte më poshtë lukthit të kraharorit dhe fryma nuk i zhej më. Kishte mbledhur buzët, sytë i zgjeronte e i zgjeronte për të parë mirë, sepse një perde lotësh i rridhte vetvetiu nga qepallat kësaj plake dhe ajo s'kishte kohë t'i fshinte. I ngrinte zemra sa herë shihte ndonjë kërcu të kalbur, rrëzuar mbi gjethet e vjetme, po që mbi to kish zënë të mbinte bari i ri i gjelbër dhe i hollë si push. Shikonte majtas e djathtas nëpër lirishtat e nëpër brigjet, pas drurëve e pas gëmushave, rrugëve të pyllit mbushur plot me gjurma dhish e gjurma dhensh. Shikonte majtas e djathtas me buzë të mbledhura shuk sikur desh të përmbante një ngashërim të madh e me sy të shqyer për habi me perde lotësh që i mjegullonte gjithshka. Ferishtia e Mvrtos, bir, o bir!

Plaka mbajti hapat. Në një lirishtë buzë rrugës, Nazi-fi kishte rënë në kurriz dhe sytë me atë vështrim të ngri-rë i kishin mbetur hapur. Të ngjante sikur shikonte qiellin matanë majave të larta të drurëve, sikur sodiste një re të madhe e të ngathët që ngjitej drejt kupës së qiellit.

U përkul mbi të, i futi dorën nën kokë dhe e tërhoqi drejt një vendi të sheshtë. I shtriu duart dhe këmbët, i mbylli qepallat dhe e mbuloi me sharpin, e saj të zi. Pastaj drejtoi trupin, lidhi duart në majë të kokës dhe nguli mjekrën në gjoks, duke parë trupin pa jetë të Nazifit. Sa ndenji ashtu? Kish zënë të frynte erë e fortë

dhe degëzat përplaseshin me njëra-tjetrën, kish plasur shiu në pyll, në fillim me pika të rralla, pastaj, si një tu-fë harabelash që fluturon me turr, pat shpërthyer potera e tij nëpër gjethe, kishin zënë të zbrisnin rrëkeza uji nga monopatet, kur ajo u lëshua mbi trupin e Nazifit me logori:

«Bir, q bir! Si i bëri dora atij katilit të të bëjë kësh-tu, o bir!»

Një vetëtimë e madhe ndriti pyllin dhe gjëmimi u rrokullis i vrazhdë e i rëndë nëpër hapësirat e mbytura në shi. Plaka u ngrit dhe nisi të nxitonte nëpër shkarrëzi-ma. Rrëketë e shiut e lagnin, degët i vrisnin fytyrën ku i qenë shpërndarë thinjat, po ajo zbriste duke gulçuar rrë-pirat dhe monopatet. «Si të bëri dora, mor katil, si të bëri dora?!»

Kurrë nuk kishte qenë kaq e gjallë fytyra e kësaj pla-ke, kurrë sytë e saj nuk e kishin pasur atë shkëlqim të egër e të zjarrtë. Në rrugë qenë sajuar pellgje, atje për-para nisi të shquhej shtëpia e saj, e vjetër dhe gjithë maz-galla. Pranë shkallëve dukeshin dy ballistë, që patën ngritur jakat e setrave dhe rrinin në strehë. Ajo do ta thërriste Lifkën në ashef dhe sëpatën do ta linte pas de-rës. Kur ai të dilte, atëhere... Dikush vraponte në rru-gë drejt saj dhe lebetitej. Ishte e Zikut që shkulte faqet, rendte dhe bërtiste:

— Po i vrasin, moj korba, po i vrasin!

Bënte me dorë nga lumenjtë e Mesun Qorrit, ku du-kej një grumbull njerëzish dhe thërriste:

— Po na i vrasin gjermanët, moj korba!..

E Zikut mori rrugën nga çesmja dhe nëpër oborre plasi potera.

Plaka hyri në oborr. Ajo ngjiti shkallët dhe njëri nga ballistët i tha:

— Mengadalë! Tërë natën kanë qenë pa gjumë dhe tashti po flenë.

Ajo e vështroi ballistin si e përhumbur. Po flenë? Sytë ju hapën si ta kish goditur vala e një mendimi. Ngjiti shkallaret ngadalë dhe hyri në odën e madhe.

Ata ishin shtrirë dhe po flinin. Lifka kish shtruar një poste dhe ish mbuluar me velenxë. Mjekra e plakës dritë dhe vetullat i kishte mbledhur mbi sytë e vegjël me një dritë të çuditshme. Shkoi në sobalkë, ndezi zjarrin dhe vuri një tigan me vaj.

— Do të na bësh petulla, nëne? — i tha një nga ballistët që rrinte përjashta, duke zgjatur kokën nga dritarja. — Mirë de, se gjeç na mbyte sot. — Ai u zgërdhi dhe u mblodh përsëri në strehë.

Plaka e dogji vajin mirë dhe shkoi me tigan në dorë në odën ku flinin ata. Kapërceu nja dy që ishin shtrirë në mes të dyshemesë dhe shkoi te Lifka. Hoqi thinjët që i qenë ngjitur në fytyrë e që s'e linin të shihte mirë, u ul në bisht dhe ja derdhi të gjithë vajin në vesh. U dëgjua një ulërimë e përbindshme, njerëzit që flinin u hodhën vrik përperjetë dhe ja mbajtën për nga dalja, kurse plaka e la tiganin përdhe dhe shkoi drejt sobalkës. Nën vetullat e rrudhura i vetëtinin sytë me një dritë të çuditshme.

— Qeni! — shfryu me një duf që i ziente përbrenda.

Gusht, 1971

LAMTUMIRË, MACILA!

Në stacion ishte pothuaj heshtje e plotë. Ogavi shikonte qiellin e errët të Osakës, i shtrirë në parmakët e një shkalle. Përtej vargut të përhimtë të ndërtesave, që thyenin horizontin e mjegulluar me çatitë e tyre të larta e të çrregullta, dremiste oqeani i pamasë, duke shtyrë drejt brigjeve të zhveshura dallgë të përgjumura. Ora s'kishte shkuar ende katër dhe nga Vakajama frynin erërat e buta të mëngjezit.

Ishin ditët e para të marsit. Në brigjet lindore të Paqësorit po shkelte si me drojtje pranvera e hershme me thellime e me mjegulla të bardha. Dielli vakte përherë e më shumë tokën e dalë nga dimri; nga ishujt e largët dhe nga vendet e ngrohta ktheheshin zogjtë shtegëtarë.

Kjo pranverë e kishte tronditur shumë Ogav Jircn. Ajo, duke hapur krahët e blertë kudo, i kishte pëshpëritur atij që pas xhamave të spitalit me një zë të dridhshëm e të dhemshur: «E Ogav! Ja, unë erdha prapë». Ogavi e dinte se pranvera me këto fjalë desh t'i thoshte: «Erdha, po, ty prapë këtu të gjeta, këtu, pas mureve të spitalit, pas perdeve të bardha. I gjori ti, o Ogav! I ngryse vitet e rinisë pa një gëzim, pa një pekule, i torturuar nga sëmundja pa shpëtim».

Dhe pranvera që trishtohej për të, dërgonte natën vonë erën e Oqeanit, që qante me pikëllim në të plasurat

e dritares. Vaji i kësaj ere të dhemshur e brengoste Ogavin e shkretë, që vërtitej në shtrat pa pikën e gjumit në sy.

Një natë më parë, sytë e një doktori të dëgjuar i thanë padashur se tragjedisë së tij po i vinte fundi. Ogavi ktheu kokën mënjanë dhe pa natën e thellë të Osakës: Në qiellin e zi që këputur një yll dhe që tretur sakaq në thellësi të oqeanit.

Nata që shkoi që për të nga më të tmerrshmet, nga më të ftohtat. Ai pat shpresuar se ndoshta një ditë, pas atë mundimesh e dhembjesh të egra, do të kthehej në jetën e zakonshme, po të gjitha këto tani kishin marrë fund. As një orë të bardhë s'kishte parë qysh prej pesëmbëdhjetë vjetësh dhe më e tmerrshmja ishte se ai kishte ndenjur në shtrat për të pritur vdekjen. «Jo! Jo! Më mirë një orë e më parë, se sa me këtë mundim të përhershëm, kishte menduar Ogavi. Më mirë ta shohësh vdekjen në sy, se sa të presësh me sot e me nesër që të vijë e të të marrë ajo».

Kishte ikur vjedhurazi nga spitali. Tani asgjë s'i hynte më në sy, asgjë s'i dhembej. Vërtitej nëpër rrugët e Osakës dhe mendohej se si të gjente ndonjë mënyrë për t'i dhënë fund të gjithave. Më afër kësaj gjëje që aty nga mesi i natës. Në drejtim të tij po vinte një automobil me shpejtësi, duke hedhur fashat e dritave në asfaltin e zi. Ogavi kapërdui pështymën, ua nguli sytë dritave të forta që të mos shihte asgjë dhe u bë gati. Po maqina ndali njëzet hapa më tej, nga ajo zbritën dy veta që hynë në një bar dhe Ogavi ndjeu se si ju drodh trupi dhe se si i rrihte zemra në kraharor. Në gojë ndjeu një shije të keqe dhe nga dobësia s'i bënin këmbët të shkonte më tej. U ul në një shkallare dhe mbështeti kokën në gjunjë.

Aty ndaj agimit që drejtuar për në stacion. Vërshtëllima e një lokomotive i pat sjellë ndër mend se gjatë udhëtimit me tren njeriu mund të giejë ndonjë mënyrë...

Ora po shkonte pesë. Në pesë e gjysmë nisej treni i parë Osakë-Tokuama. Së bashku me dritat e para të ditës së re, u derdh në sheshin e stacionit një grumbull i

madh njerëzish. Çdo gjë e heshtur nisi të gjallërohej. Nisën të vinin maqina, karroca dhe hamej të ngarkuar me valixhe. Ogavi u çua nga parmaku ku qe shtrirë dhe hyri në turmë. Në platformë, një lokomotivë e posandezur lëshonte në ajrin e brishtë shtëllunga avulli bojë hiri.

Papritur, diku nga mezi i turmës, krisi një poterë e madhe. Dy djem kapën për leshrash një vajzë dhe nisën ta godisnin. Ogavi, që u ndodh aty, kapi njërin për krahu dhe i tha:

— Ç'bën kështu, vëlla?! Si s'ju vjen keq për të? Lëreni! Hajde lëreni! — dhe u përpoq t'ua hiqte nga duart.

Po njëri nga ata, i bëshëm dhe i fortë si kalë, e shtyu tutje Ogavin duke shfryrë:

— Qërohu, se s'është punë për ty!

Shtriu duart përsëri dhe e kapi për krahësh vajzën që lebetitej e thërriste. Djali tjetër i çorri fustanin afër gjoksit dhe i dha një të shtyrë me sa fuqi që kishte. Vajza u përplas në shesh me krahë të kryqëzuar përpara fytyrës e nisi të thërriste me zë të shuar. Atëhere Ogavi s'u mbajti dot. Ngriti duart dhe u hodh mbi djalin e bëshëm, po ai as që pyeti për grushtat e Ogavit të drobitur nga sëmundjet dhe me një të goditur e hodhi në tokë. Krisi poterë e madhe. Njerëzit u mblodhën mizëri dhe përpiqeshin t'i ndanin. Dikush bërtiste me të madhe, dikush mbante për krahu ndonjë luftues të hakërryer, dikush tjetër përvishte llërët e lëshohej kundër kujt t'ja merrte mendja. Po në fund u futën në mes nja pesë-gjashtë burra shtatlartë, i mbërthyen për zverku djemtë dhe i flakën tej. Sherri u shua dhe turma nisi të shpërndahej.

Vajza kishte mbetur e shtrirë aty afër Ogavit, e çjerrë dhe e grisur për turp. Leshtrat e gjata i binin të ngatërruara mbi supe, mbi fytyrën e përplotur e mbi qarën plot shenja thonjsh. Ajo mbuloi gjunjët me krahë, u ngrit dhe vrapoi prapa një ndërtese të stacionit. Edhe Ogavi u çua, por me mundim të madh, dhe shkoi për nga treni. Një curril gjaku i kishte ndotur këmishën dhe mbi vetull i digjte një e gërvishur thoi.

Mori biletën dhe u çapit ngadalë për nga vagonat. Në

fytyrë i kishte rënë një hije e zbetë dhe çipi i buzës i dridhej lehtë. Pa bërë mirë 20-30 hapa, dëgjoji se dikush i thërriste nga prapa:

— O zot! O zot!

Ktheu kokën dhe vuri re atje tej vajzën e re, që vraponte dhe mezi mbante një valixhe të rëndë. Ajo e kishte hequr fustanin e çjerrë dhe kishte veshur një tjetër. Kraheve kishte hedhur një triko, që e tregonte më të mbushur trupin e saj të ajthëm. Vraponte dhe mezi mbushej me frymë. Dritat e mëngjezit, që po ndizeshin përherë e më shumë, i binin në fytyrën e zeshkët, ku dalloheshin njollat e kuqe. Ogavit ju dhimbs. Ai pa se si u ndal ajo aty pranë tij, si uli kokën e turpëruar e si i shtrëngoi dorën, duke i thënë:

— Të falemnderit, zot!

Pastaj vajza çoi sytë e skuqur nga të qarët dhe e pyeti me një fije zëri:

— Në Ube shkoni ju, o zot?

— Jo, në... Tokuama, — iu përgjegj Ogavi.

— O, sa mirë, zoti im! — u gjallërua ajo. — Sa mirë! Unë shkoj në Ube, po deri në Tokuama do të jemi bashkë.

Fliste dhe i merrej goja nga turpi, dihaste e nxiton-te të ecte çap për çap me Ogavin.

— U lodhe? — e pyeti ai.

— Jo, zot, pak.

— A të të ndihmoj unë?

— Te prindët shkon në Ube?

— Jo, zot! Unë s'kam prindër... me kanë vdekur. Një vëlla që kam, jeton larg, në Hakodate. Në Ube shkoj te tetua, se është vetëm fare, o zot!

Si të quajnë?

— Macila, zoti im!

— Mua më quajnë Ogav. Hipim këtu, Macila?

— Po, zot!

Hipën në një vagon dhe zunë vend pranë njëri-tjetrit. Heshtën një hop dhe pastaj, kur e pyeti Ogavi, Macila tregoi gjithë historinë e jetës së saj; ashtu me zemër të pastër dhe e çiltër siç ishte ajo.

— Jo, zoti im! Jam vajzë e varfër dhe ende s'më kalalë fati.

U skuq ajo e në fjalët që tha dridhej një notë dëshpërimi e trishtimi. Ogavit i erdhi keq. E kapi për supesh dhe i tha:

— O, do të dalë Macila, patjetër do të dalë dhe fati yt. Ti je kaq e mirë dhe kaq e bukur, sa patjetër do të gjesh një burrë si të ta dojë zemra.

Vajza heshti. Pas pak, çoi kokën e belbëzoi me zë të trashur nga mallëngjimi:

— Jo, zoti im! S'kam hasur asnjeri që të dojë të martohet me mua.

— O, Macila! Si ka mundësi të jetë e vërtetë kjo? Patjetër ti do të gjesh një njeri të mrekullueshëm. Ti je kaq e mirë, sa e meriton plotësisht këtë.

Këto fjalë qenë për të si era e luleve, që ta mbush gjoksin plot. Dihati, vështroi ëmbël e thirri lehtë që nga fundi i gjoksit:

— Sa i mirë je ti, zoti im!

Ishte hera e parë që haste një burrë, i cili fliste aq ëmbël, aq butë.

Lokomotiva, me leshrat e thinjura të shpleksura në erë, turrej përmes arave drejt vendeve të reja. Gulçonte me gjoksin e zi të përbindshëm. Gulçonte dhe zemra e Ogavit. Minutat dërmohen në rrotat e çeliktat (sa keq për një jetë që i kanë mbetur minuta!), çastet e ëmbëla vijnë e bien pa shpirt në ata binarë, që e çojnë udhëtarin e mjerë diku në një hon pa kthim. Ogavi do që ta ndalë atë vrull të çmendur, do që t'i mbetet qoftë dhe një minutë nga këto çaste, po gulçon lokomotiva dhe ditës tmerrësisht të shkurtër i erdhi fundi. Së largu duken hijet bojë jargavani të mbrëmjes që afron.

Macila e shikon me sytë e saj të bukur. Ogavi trembet dhe gëzohet nga sytë e saj dhe hesht.

«Po ç'më vështron kështu? O, hiqmi sytë, të lutem! Jeta të solli tek unë shumë vonë. Lërmë, lërmë të lutem!»

Macila ul sytë, shtrin fustanin me pëllëmbët e vogla dhe në çipat e buzëve i endet një buzëqeshje e ngrohtë.

«Po jo, jo! Shikomë përsëri, Macila, davaritma pak pikëllimin e egër! Pa çka, le të ndahemi!»

Ogavi u mbush me frymë dhe psherëtiu thellë.

— Ç'ke, zoti im?

— Asgjë, Macila.

— Ti psherëtime, zoti im.

— Jo, Macila! Ashtu të duket!

Ajo rrudhi vetullat dhe e shikoi me vëmendje.

Mbrëmja i syrgjynosi tej oqeanit të fundmet ngjyra të muzgut dhe lart në qiell u ndezën një nga një vjet. Udhëtarët e lodhur pulitën qepallat. Edhe Macila i puliti qepallat, e përkundur në raketakun monoton. Treni e kishte kaluar Kurjen dhe tani i avitej Hiroshimës.

— Të flihet, Macila?

— Oh, po, zoti im!

Ai u ngrys dhe ktheu kokën mënjanë. Ajo buzëqeshi dhe mezi hapi sytë e përgjumur. Koka e saj rrëshqiti ngadalë dhe u mbështet në supin e Ogavit. Ajo e ndjeu këtë, po nuk u shqetësua. Murmuriti diçka, duke lëvizur buzët dhe dremiti.

Natë! Natë ëndrrash të lehta, të kaltëra e të brishta. Natë kobesh, hijesh e mendimesh të vrazhda. Ogavi shikonte nga afër fytyrën e saj të kotur nga gjumi. Çoi gishtërinjtë dhe i preku një bullungë të buhavitur. Vajza lëvizi pak dhe hapi sytë. Siç duket ajo i ndjeu ato mollëza të buta që e përkëdhelnin aq lehtë, prandaj dhe u zgjua. Dihati si e çliruar dhe e la prapë kokën në supin e tij, duke murmuritur pothuaj me vete:

— Sa i mirë që je ti, zoti im!

E gjora vajzë! Zemra i ishte dorëzuar fare para butësisë dhe pekuleve të këtij njeriu. Kishte nevojë për gishtërinj të tillë, për fjalë të tilla të ëmbla. Buzëqeshte e lumtur dhe flinte në supin e tij.

Ishte si një vizion, një dritëz e shkurtër në një natë pa mbarim, një pasthënje e dëshpëruar.

«Oh, ç'është kështu, xhanëm? E ç'del nga kjo? I rrëmbej zemrën për t'ja hidhëruar më pastaj? Jo, jo!»

Ja ngriti kokën lehtë dhe i tha me një zë të thellë:

NDËRRIMI I QIEJVE

Kamioni ngjitej në Qafën e Dardhës. Kësaj qafe më kot i thoshin Qafa e Dardhës, sepse këtu, veç gurëve të bardhë që çaheshin nga vapa, nuk të zinte syri një fije bar e jo më një dardhë.

Shoferët e shanin me të gjitha markat sa herë që u binte rasti të kalonin andej, dhe nuk qenë të rralla maqinat që qenë gremisur në honet e saj. Në hapjen e rrugës nëpër këtë qafë qenë shkelur të gjitha normat teknike si të pjerrësisë ashtu dhe të kthesave, kështu që në dimër, kur qafën e zinte akulli, shoferët e ngjitnin me zemër të ngrirë. Papritur e pakujtuar maqina e dridhte bishtin dhe mend merrte rrokullimën nëpër shpatet që binin thikë 200 a 300 metra poshtë.

Ishte viti i katërt i pasçlirimit dhe këtë rrugë, që e patën hapur italianët për shfrytëzimin e bakrit të një miniere të vogël, po e zgjeronin në nja dy vende. Po punët ecnin ngadalë. Në një vend që quhej Kroj i Helmuar punonte vetëm një njeri. Po ç'do të bënte vetëm ai? Aty rruga përshkonte 50-60 metra në faqen e një shkëmbi që gremisej 600 metra poshtë. Gurët e bardhë e të mëdhenj i rrinin si strehë shiritut të hollë të rrugës dhe shoferët lutnin njëqind herë të mos u binte rasti të kalonin andej.

Te Kroj i Helmuar po shkonte të punonte dhe një-

djalë i ri flokëverdhë, me një vështrim pak si të egër, por me tipare të buta dhe i brishtë. Ai i pat nxjerrë dorën këtij kamioni që ngjitej për në qafë, dhe shoferi, të cilit i ishte bërë shpirti derr duke i hedhur ujë herë pas here radiatorit të shpuar, e pat marrë duke menduar se ky djalë i ri do t'i vinte në ndihmë. Dhe vërtet, në çdo tri-katër kilometra, ku uji shterte fare në radiator dhe kapaku i taposur me lecka shfrynte nga avulli, shoferi i jepte kanaçen djalit dhe ai shkonte deri larg për t'i sjellë një pikë ujë.

Kishin bërë kështu gati dy orë, por të përpjetave të qafës nuk po u gjendej fundi. Atë ditë bënte një e nxehtë përvëluese dhe gurët qenë nxehur si furrë. Rreth e qark qëndronte pezull një tis i murrëmë vape që i kridhte largësitë si në fundin e një uji të valuar. Djali që rraskapitur fare duke kërkuar ujë nëpër të çarat e shkëmbinje gëlqerorë. Llastikat e vjetra ju grinë fare dhe tani ndjente se si i cekte mishi i putrës në tokë. Në një të përpjetë, kamioni, që ish më tepër një grumbull hekurash dhe teneqesh të ndryshkura, rënkoi dhe mbeti. Ai ishte shumë i vjetër për t'i ngrënë këto rrugë në ditë të nxeh-ta dhe me pluhur si kjo. Dha e dha e më në fund shfryu i rraskapitur nëpër grykën e radiatorit, hodhi disa stër-kala të nxehta mbi llamarinën e ndryshkur të maskarinos dhe mbeti. Shoferi, një burrë i parruar dhe me duar e fytyrë të nxira nga nafta, përplasi derën duke sharë nëpër dhëmbë dhe shkoi e u ul në një gur buzë rrugës.

Edhe djali zbriti e po rrinte në këmbë pranë maqinës. Nuk dinte ç'duhej të bënte tani. Shoferi nuk ja dha më kanaçen e ujit dhe maqina nxirrte avull e vërshëllente sikur do të plaste nga çasti në çast.

— Ti, or birko, hipi këmbëve tashti, — i tha shoferi, kur e pa në atë gjendje. — Këtë e zuri përdhesi e s'bën çap përpara.

Djali, i cili sikur e ndjente veten fajtor për maqinën që mbeti, u kthye e tha me një fije zëri:

— Nuk do ta ndezësh më?

— Do ta ndizja po të kisha një vare e ta ndaja më

Po tani, Maxhuni, ndërsa ecte vetëm në këta shkëmbinj të bardhë që i digjte vapa, ndjehej i mërzitur e i lodhur sa më s'bëhej. Kurrë nuk qe larguar ndonjëherë nga shtëpia. Gjer atëhere kish ruajtur dhitë dhe nuk e kish marrë me mend se do të vinte një ditë që të ikte kaq larg. Por ishin të varfër. Dhe ishin plot gjashtë vëllezër. Ç'do të bënin gjashtë vëllezër me atë pak tokë që kishin? Tre nga djemtë i ati i rregulloi në punë shteti. Maxhuni po vinte për këtu, në mirëmbajtje.

Veshi i zuri ca goditje qysqie mbi gurë. Mbajti këmbët dhe i vuri veshin: Po, atje punonte Ziku. Rruga kalonte prapa një shkëmbi dhe atje punonte dikush. Po kush përveç Zikut? Vetullngrysur dhe serioz po shkonte ballë për ballë këtij njeriu. Ishte vetëm tetëmbëdhjetë vjeç dhe ende nuk kish çuar brisk në faqe.

Ja më në fund dhe Ziku. Ai qe ngjitur mbi një gur dhe mundohej ta çante me qysqi. Ju duk i pakët në trup, i pluhurosur dhe i plakur, sa djalit, kushedi përse, i erdhi keq. Dielli e kish nxirë e hirosur sa ishte zor t'ja dalloje tiparet e fytyrës. Ai e vuri re djalin dhe ktheu kokën ta shikonte. Djali qëndronte pa lëvizur. Atëhere Ziku filloi prapë të punonte, duke i rënë gurit me qysqi.

— Punë e mbarë! — i tha djali me zë të lartë.

Ziku nuk ju përgjegj. Qysqia bënte shumë zhurmë. Fytyra i qe mbuluar me bula djerse dhe mollëzat e kërcyera të faqeve i dilnin si dy kunjat.

Djali la torbën mbi një gur dhe, kur Ziku drejtoi trupin për t'u mbushur me frymë, i foli përsëri.

— Punë e mbarë, xha Ziku!

— Hajde! — tha tjetri me zë të butë.

— Më kanë sjellë të punoj me ty, — tha djali.

— Po mirë — tha Ziku dhe fshiu fytyrën me dorë.

— Po mirë — përsëriti.

Maxhuni mori torbën dhe shkoi drejt tij, duke e parë me një lloj dyshimi fytyrën e këtij njeriu të zbardhur nga pluhuri i gurit. Ai nuk ish aq i plakur sa ju duk në fillim dhe sytë i kish të butë e si të mbushur me një lëndë të lëngshme.

Djali solli pusullën që i kish dhënë drejtori i mirëmbajtjes për Zikun, po ky nuk e mori.

— Mirë, mirë, — i tha, — Halimi ta dha?

— Halimi — murmuriti Maxhuni.

— E mirë.

Pështyu pëllëmbët, kapi qysqinë e nisi prapë nga puna.

— Shiko se mos i stivos ata gurët aty! — i tha Maxhunit pas një hopi, kur vuri re se ky po rrinte në këmbë dhe shikonte pa ditur ç'të bënte.

Buzë rrugës ishin ca gurë të mëdhenj dhe Maxhuni nisi t'i renditte njëri pas tjetrit. «Pa marrë frymë dhe drejt e te gurët», mendoi djali, sepse ndjehej shumë i lodhur. Ziku nuk i foli më. Qysqia e tij rrihte me një ritëm monoton dhe të përhershëm shkëmbin.

Pas një ore Maxhuni u mbyt në djersë. Pëllëmbët i digjnin dhe, pa pyetur ç'do të thoshtë Ziku, u ul në bisht dhe nisi të bënte ca vija në tokë.

Afër mbrëmjes, Ziku e la punën dhe shkoi te grumbulli i gurëve që kishte mbledhur Maxhuni. I shtyu me këmbë dhe i tha i pakënaqur:

— Sot je sefte, po s'është punë kjo.

Mori xhaketën, e hodhi krahëve dhe bëri tatëpjetë një bregu të thepisur. Maxhuni i shkoi pas i mërzhitur. Atje poshtë hapeshin ca livadhe me bar të korrur. Në mesin e këtyre livadheve gjarpëronte shtrati i përroit dhe atje ku nisin kurrizet e malit të Kilbit dukeshin ndërtesat dhe instalimet e një miniere të vogël. Ziku banonte atje, në një barrakë të vjetër dy katëshe gjithë shkallë e të ndara si në vapor, me çati të lartë e kulm të pjerrët të mbuluar me llamarinë.

Dhomën, një e ndarë e vogël pranë shkallëve, me një dritare, e kish në katin e parë dhe ajo ish e freskët dhe e pastër. Ziku shkoi vetë në depon e minierës, mori një krevat hekuri e rroba për Maxhunin dhe e vendosën pranë dritares.

Dikur, kati i parë i kësaj shtëpie qe lyer me bojë të gjelbër, po shqota e kish gërryer dhe vende-vende dërra-

sat qenë kalbur. Kati i sipërm nuk kishte parë kurrë bojë dhe dërrasat aty ishin të nxira e të brejtura nga mola. Dikur kjo ndërtesë kishte qenë e punëtorëve të sharrës. Në brigjet e përroit dukeshin dhe tani themelet e sharrës, ca trungje të nxira gjithë mayshk e lagështirë. Po sharrë nuk kishte më. Aty qe hapur një minierë e vogël me dy galeri dhe me tri sonda të ekspeditës gjeologjike. Telefrikuri zbriste mineralin nga galeria e parë në trimoshat dhe gjithë ditën e ditës dëgjohej gërvëlima e vagonit, hija e të cilit rrëshqiste si një qift mbi çati.

Në këtë shtëpi banonin shumë veta. Në dhomat e katit të sipërm ishin dy mësuese të një fshati afër minierës dhe familja e një minatori (një tufë kalamaish, grujaja e një plakë që dukej mjaft noprane), kurse poshtë, veç Zikut me Maxhunin, banonte dhe një inxhinier dhe familja e drejtorit të minierës që kishte gjithashtu një tufë kalamaish.

Në ditët e fillimit të kësaj jete të re, Maxhuni vërente se Zikun e trajtonin në mënyra të ndryshme. E ëma e minatorit, që banonte aty, e shikonte vëngër dhe murmuriste ca falë gjithë mëllef, mësueset dhe inxhinieri e donin, kalamajtë i mblihdeshin trumbë nga pas sa herë që ai vinte nga klubi i minierës dhe u sillte karametele.

Ky Zik, megjithëse dukej i zyrtë dhe i vrarë, ishte njeri i mirë. Huqet që kishte, Maxhuni nisi t'ja kuptonte shpejt. Nëse punën s'e bëje mirë, me Zikun do të grindeshe. Po t'i thoshe «Fundi i fundit aq sa punoj, aq do të marr», prapë me Zikun do të grindeshe. Ziku ishte për punë të paqme, pa hile. Prandaj ndonjë që kish shkuar për të punuar me të, s'ja pat dalë dot e kishte ikur. «Jemi në punë të shtetit, u thoshte Ziku, jo në mall të agait.»

Tri ditë pas ardhjes së Maxhunit aty, ish e diel dhe të dielën Ziku e bënte pushim. Djali qe rraskapitur në punë dhe atë ditë pushimi fjeti deri vonë. Kur u zgjua, ndjeu se qe mbytur i tëri në djersë. Jashtë ziente kënga e gjinkallave dhe dielli të digjte. Ziku nuk ish aty. U ngrit, veshi rrobat dhe doli në oborr. Gjatë këtyre ditëve ai qe

cuar gati pa rënë drita dhe ktheheshin vonë në mbremje nga puna, kështu që s'kishte parë pothuaj fytyrë njeriu nga ata që banonin aty.

Në hijen e shtëpisë vuri re plakën, që pat hapur mbi një letër katrama ca lesh të larë dhe po e rrihte me një purtekë të gjatë. Fytyrën e kish gjithë rrudha të imta dhe sytë e vegjël i kish si të sëmurë.

— Ke ardhur të punosh me Zikun? — e pyeti ajo.

— Po — tha djali dhe ju hap goja.

Në dhomat lart plasi potera e kalamajve dhe u ndje e qeshura e një gruaje. Pastaj u dëgjuan hapa nëpër shkallë. Maxhuni ktheu kokën dhe pa një vajzë me flokë të shkurtër dhe me një nishan të vogël në mjekër. Ishte njëra nga mësueset, një vajzë 20-21 vjeçe, pak e dobët, me ca sy të mëdhenj.

— Hë, nënë Mone! — i tha plakës vajza, po sytë i kishte ngulur nga djali. — A po lodhesh?

— Eh! — psherëtiu plaka.

Maxhuni që mbështetur pas pezulit të derës dhe ndoqi me sy vajzën që shkoi gjer te gardhi dhe mori ca ndërresa.

Plaka Mone përzjeu leshin me purtekën e gjatë.

— Sot erdhe? — e pyeti plaka Mone Maxhunin.

— Kam tri ditë — tha Maxhuni.

Vajza po e shikonte me kureshtje.

— Ku? — pyeti ajo.

Maxhunit ju duk se ju drejtua atij dhe tha:

— Në mirëmbajtje, me Zikun.

— Vërtet?

Nga ana e përroit po vinte Ziku. Ai kish veshur një palë pantallona të ngushta dhe një këmishë të bardhë me grykë të hapur. Dukej mjaft më i ri dhe flokët i kishte lagur me ujë e i kishte krehur.

— Hë, mortja! — murmuriti me vete plaka në mënyrë të pakuptueshme.

Vajza pa nga ajo. Ziku sikur i dëgjoi këto fjalë, sepse u prish në fytyrë dhe mbërtheu nofullat fort. Kur u afrua, i tha plakës:

— Ti, Mone, shiko leshin! Dhe bëj dua që je e ëma e Latit.

— Uh, më març të keqen, mor horr! Mua të më thuash kështu ti? Na! Na! — dhe rrahu me shuplakë në një vend të turpshëm.

Nga një dritare nxori kokën inxhinieri, një djalë nja 26 vjeç dhe pa nga vajza me flokë të shkurtër. Kjo kish kthyer fytyrën nga gardhi dhe kukuriste mbyturazi.

Ziku qe zverdhur krejt.

— Tani e prishe muhabetin ti, Mone — i tha inxhinieri që nga dritarja.

Maxhuni nuk e kuptonte përse kishte një zemërim të çuditshëm kjo plakë kundër Zikut. Ai ishte njeri që nuk i binte njeriu në qafë, punonte sa i binte bretku dhe kish diçka prej babai në dashurinë dhe kujdesin e tij ndaj më të rinjve. Sidomos ai i donte në mënyrë të veçantë mësueset, inxhinierin, që ishte një djalë i urtë e i thjeshtë dhe vetë Maxhunin, sepse ky ja dëgjonte fjalën dhe punonte pa hile.

Në të vërtetë jo gjithshka shkonte mirë në atë minierë. Njerëzit aty sikur qenë ndarë më dysh dhe ushqenin një zemërim të pakuptueshëm për njëri-tjetrin. Matanë përroit ishin dy barraka të vogla. Aty banonin ca minatorë me familjet e tyre. Gratë e këtyre minatorëve dhe vetë ata nuk i shihje pothuaj kurrë nëpër sheshet e minierës. Herë-herë, nga ato barraka vinin lloj-lloj fjalësh kundër inxhinierit, mësueseve, djemve e vajzave të reja në përgjithësi dhe veçanërisht kundër Zikut, që, sipas fjalëve të tyre, kishte lajthitur dhe bënte gjëra të papjekura.

Maxhuni këtë gjë e mori vesh më mirë në mbrëmje, kur ai bashkë me Zikun, si qenë kthyer nga puna e si qenë çlodhur ca në dhomën e tyre, shkuan në klubin e minierës.

— Unë do të pi një gotë — tha Ziku. — Ti do?

— Jo — tha Maxhuni.

Ziku mori një dopio, kurse Maxhuni një gurabie.

Pas zagushisë dhe vapës së ditës kishte zbritur një natë e freskët me shushurima dhe me vezullime yjesh në qiellin e zi të shtatorit. Malet ngjanin si ca buaj të mëdhenj me qafa të shtruara. Klubi ish i vogël, i pastër dhe me tryeza të gjata, vendosur pranë paretëve të kompesatos. Dëgjohej shushurima e ujit të përroit dhe zëri i çjerrë i një shpendi në pyll.

Diku, në një barrakë, ja kishin marrë një kënge me çifteli. Pastaj kënga me çifteli mbaroi dhe pas një hesh-tjeje u dëgjuan tingujt e një fisarmonike. Atë natë, rinia e minierës bënte mbrëmje.

— Shko! — i tha Ziku djalit, kur vuri re që këtij i mbeti koka andej.

— Ku? — e pyeti ai.

— Dëfre! Mblidhet rinia atje dhe dëfrejnë. Mua këtu më gjen.

Maxhuni pa përsëri nga dritarja barrakën nga vinin tingujt e fisarmonikës. Ajo ish e gjatë e me kulme të pjerrëta; ndërtuar pranë një bregu të vogël me ca drurë në fund.

— Kush është atje? — pyeti Maxhuni.

— Ka plot — tha Ziku.

Djalit i rrahu zemra nga gëzimi. Atij i pëlqente të dëfrente. Në fshat, vetëm kur kishin ardhur vullnetarë nga rruga Kukës-Peshkopi, kishin bërë një mbrëmje dhe Maxhunit i kishte mësuar një vajzë të kërcente tango. Ja dhe tani, një tangoje apo rumboje po i binte fisarmonika dhe e mbushte zbrazëtirën e errët të luginës me jone të gëzueshme.

— Ku i njoh unë ata! — tha Maxhuni.

— Shko, shko — e shtyu Ziku. — Do të njihesh. Ju jeni të gjithë shokë.

Ai kapërdiu dhe një gllënkë raki dhe Maxhuni, si i mpirë e me lëvizje të plogëta, u ngrit e doli.

Në barrakë ishin gjithë-gjithë 10-12 veta dhe ai që i binte fisarmonikës, një djalë me fytyrë të gjatë e të hequr, që ulur mbi një tryezë dhe shtrëngonte mjekrën pas tastierës. Në mes të dyshemesë kërcenin tri çifte: Mira me një

djalë të shkurtër dhe dy vajza të tjera që ngjanin gjysmë fshatare, gjysmë qytetare me dy djem me kominoshe.

Maxhuni pa që po ja bënte me dorë Zana. Ajo rrinte në këmbë pranë një tryeze në qoshe.

— Di të kërcesh? — e pyeti ajo.

Maxhunit i mbetën sytë te fytyra e saj e bukur dhe te flokët e errët.

— Pak — tha ai.

— Tango?

— Po, tango.

Zana u dha flokëve me kokë prapa dhe i thirri fisarmoniçistit:

— Mezan, mer një tango?

Ai bëri «po» me kokë, mbështeti mjekrën pas tastierës dhe, si u mendua pak, me gishtërinjtë e zinj të hapur nëpër tasta, ja mori një tangoje.

Zana ja mori në pëllëmbë dorën, i mbështeti krahun lehtë në sup dhe ai ndjeu se si e tërhoqi drejt çifteve, duke u lëkundur lehtë dhe bukur nën ritmin e muzikës. Një si avull ju ngjit nga brenda dhe zemra i rrihte kaq me forcë, sa mend i çante kraharorin.

Ajo ngriti kokën dhe i pa sytë. Pastaj pa mënjanë nga Mira. Shoqja rrinte serioze dhe kërcente si pa qejf me djalin e shkurtër që i tundte bërrylet kohë e pa kohë. Maxhuni vuri re se Mira i buzëqeshi një grimë dhe i tundi kokën si me qërtim.

— E ke mbaruar shkollën? — e pyeti Zana.

— Tri — tha Maxhuni.

— Si tri? Tri klasë?

— Tri klasë.

— O, këtu do të të futim në shkollën e natës. Alamet djali ti dhe me tri klasë?

Maxhuni ndjeu përsëri avullin e nxehtë që ju ngjit nga brenda dhe këtë radhë balli i djersiu. Ai i pa nga afër sytë e Zanës, ca sy të bukur si bajame. Qeshi me ngathtësi, pastaj kafshoi buzën dhe rudhi ballin.

Ziku erdhi pas një gjysmë ore. Ata po kërcenin, kur ai hyri i heshtur dhe u ul diku në qoshe. Erdhi dhe in-

xhinieri dhe ndenji në këmbë afër Zikut, me duar të kryqëzuara përpara. Kishte veshur një pulovër të hollë dhe flokët e zinj e të dendur i dukeshin si të pakrehur.

Radhën tjetër, si bënë pak pushim, Zana kërceu me Zikun. Maxhuni vuri re se Ziku ishte më keq se ai, lëkundej e i ngatërroheshin këmbët, trupin e mbante si të ngrirë dhe, kur rrotullohej, e çonte dorën më lart se koka.

Në barrakë hynë dy veta; njëri nga ata kish një kokë të madhe si shpellë dhe ca nofulla të dala e gjithë gunga muskujsh.

— Jepi, Ziku, jepi! — tha ai me kokë të madhe dhe, si ndenji një hop në këmbë, u kthye e doli. Kokëmadhit i kish mbetur një shprehje ironie e trashë në atë surratin e tij të madh e me dy sy të vegjël si vrima. Ishte nga ata të barrakave matanë përroit.

Maxhuni qe ulur pranë dritares dhe, kur nuk i hidhte sytë Zanës me Zikun, shihte jashtë dritat e minierës, ndërtesat, sheshet. Plogështia dhe lodhja i patën fluturuar si me magji dhe ai ndjehej i lehtë e i gëzuar.

Në barrakë erdhi prapë ai me kokë të madhe dhe nja dy të tjerë.

— Epo mjaft tashti — tha. — Njerëzia do gjumë.

Dy të tjerët shikonin të ngrysur.

— U bezdisët ju? — i tha njëri nga djemtë e atjeshëm, një djalë i gjatë me rroba doku dhe me një vështrim të mprehtë.

— Shkoi vonë — tha kokëmadhi.

— Ora, s'ka shkuar ende nëntë — tha djali. — Ju, po t'ju flihet, shkoni e flini!

Ai me kokë të madhe se ç'tha me vete dhe qeshi me sarkazëm. Pastaj i tha Zikut:

— Po ti, o lumëmadh. Mirë këta që janë të rinj, po ti ç'do këtu?

Kjo ra si bombë. Ziku u zverdh, uli sytë në tokë dhe e la Zanën në mes të çifteve. Sikur qe zgjatur brenda një çasti dhe Maxhunit ju duk si div me lëvizje energjike dhe të prera.

Shkoi drejt atij që foli dhe i ndenji përballë.

— Nuk të dëgjova mirë. or Adem. Pa thuaje dhe një herë — tha.

Tjetri ktheu kokën mënjanë. buzëqeshi me dy të tjerët që rrinin të ngrysur e desh të dilte. Ziku e mbërtheu për xhakete dhe e tërhoqi.

— Thuaje, pra? — i tha me një zë të ulët gjithë nerva.

— Shiko, mua mos më kap ashtu! — ju shkreh Ademi dhe ja hoqi dorën me një lëvizje të shpejtë. — Po kemi për ta parë mirë ju — ju drejtua të gjithëve. — Këtu ne kemi familje, kemi gra e s'duam hi-hi e hu-hu!

Ziku u prish menjëherë në fytyrë. Ju hodh Ademit përsipër, e mbërtheu për zverku dhe e vërviti me tërbim jashtë derës. Ademi bëri të futej prapë, por Ziku e mbërtheu përsëri për zverku dhe e hodhi jashtë. Krisi një poterë e madhe. Njëri nga ata dy burrat e ngrysur desh ta kapte që prapa Zikun, po Maxhuni sikur u hodh me sustë nga vendi, rendi tek ai dhe e kapi për krahësh.

Atë natë Ziku qe pikë e vrer. Maxhuni nuk flinte dhe dëgjonte Zikun që kthehej në shtrat herë në një krah, herë në tjetrin. Ademi ishte bashkëfshatar i Zikut dhe me atë që kishte bërë i pat fyer të gjithë. Tani nisi ta kuptonte Maxhuni se përse plaka Mone e shihte Zikun vëngër dhe përse ato fjalë që vinin nga barrakat matanë përroit e quanin Zikun njeri që pat rrjedhur e që bënte gjëra të pahijshme. Dukej qartë që këto fjalë ishin më tepër për njërën nga mësueset, për Mirën, sepse Ziku e çonte ndonjë pasdite në fshat, kur ajo kishte konsultim me nxënësit.

Shtatori shkoi. Dhe ditët e nxehta mbaruan më në fund. Një natë shkrepëtiu e bubulliu dhe ra shi i madh. Puna e asaj nate me Ademin u mbyll. Ata të drejtorisë i thanë që të mos përzihej në punët e rinisë dhe ja kishin bërë mirë që e patën vërtitur jashtë. Në shtëpinë e madhe prej dërrase jeta rridhte si zakonisht. Ziku me Maxhunin punonin te Kroi i Helmuar, mësueset herë u gatuanin drekën e herë u lanin ndonjë rrobë, ajo plakë e rrudhur lllomotiste shpota kundër Zikut, inxhinieri ish

njeri i qetë e i urtë dhe gjithë ditën vërtitej nga galeritë. kalamajtë bënin zhurmë; në oborr plasi bari i hollë pas shirave të vjeshtës.

Thoshin se Ziku kish qenë sherrxhi i madh, por kohët e fundit kish ndryshuar shumë. Ajo që e çudiste Maxhunin ishte se ky njeri, që ditën e parë i qe dukur si një plak i drobitur, tani ish rinuar e gjallëruar. Vërtet pantallonat i rrinin të ngushta dhe xhakaventoja i rrinte e shkurtër, por këto nuk i bënin më përshtypje. Shpesh ai rrinte deri natën vonë, duke lexuar një libër e i thoshte Maxhunit se, pasi të mbaronte të shtatën natën, do të vazhdonte një teknikum.

Një herë, kur u kthyen nga puna, gjetën në dhomë një djalë të ri nja 17 vjeç, që kishte hequr llastikat dhe e kish zënë gjumi në shtratin e Zikut. Ai kish një fytyrë të imët dhe leshra të ashpra bojë kërpi. Si dëgjoi zhurmë në dhomë, u ngrit dhe pa nga Ziku.

— Hë, erdhe? — i foli me zë të butë dhe i përkëdhe-li kokën.

Djali nuk foli, po nisi të mbathte llastikat.

— Gjete gjë maqinë, apo erdhe në këmbë? — e pyeti Ziku.

— Gjeta — tha djali ngadalë.

— Si jeni andej?

— Mirë — tha djali.

Ziku shkoi te dollapi i bukës, nxori një tenxhere me makarona që kishin zier mësueset një natë më parë, dhe e vuri në mes të tryezës. Nisën të hanin të tre. Djali hante me lugën e Zikut; një herë njeri, një herë tjetri. Pas-taj hëngrën dhe bukë me djathë e me turshi dhe Ziku piu një gjysmë katruve me ujë.

— Hë, — i tha djalit — u çlodhe mirë?

— Po — tha djali.

— Suta si u bë? I ikën dregëzat?

— U shërua — tha djali. — Na ngordhën dy shele-gë. Pinë ujë tek ata të spërkatjës së farës.

Ziku gogëziu dhe krojti qafën.

— Mirë — i tha.

Nxori portofolin dhe i dha para, rrogën e dy muajve të fundit, ato që kishte mbledhur. Djali nxori një qese të bardhë nga gjiri, i futi paratë në të dhe e futi prapë në gji. Pastaj u ngrit dhe mori një shkop që e kishte lënë pas derës.

— Ti do të vish ndonjëherë? — e pyeti Ziku.

— Do të vij... nga muaji tjetër — tha Ziku.

Djali i dha dorën Maxhunit, kurse Ziku, si u la e si u ndërrua, e përcolli deri matanë përroit.

Ishte djali i Zikut. Erdhi për të marrë rrogën për në shtëpi. Ziku kishte katër fëmijë: tre djem dhe një vajzë. Më i madhi ish 21 vjeç. Vajza ish e vogla dhe ishte 15 vjeç. Ziku qe martuar 18 vjeç. Vëllain e tij të madh e kish vrarë hasmi. Në shtëpinë e tyre kishte mbetur e shoqja, Dilja. Dilja ishte atëhere 29 vjeçe. Një natë i ati i tha Zikut se e martonte me Dilen. Të ishin përmbysur trarët e shtëpisë dhe ta zinin poshtë, atij s'do t'i kishte ardhur aspak keq. Po i ati s'desh ta nxirrte nusen nga shtëpia dhe Ziku i vuri një gur zemrës dhe u martua.

Bëri katër fëmijë. Kur Ziku mbushi të tridhjetat, Dilja pothuaj qe plakur. Në shtëpi tek ata krisi një sherr i pakuptueshëm. Atëhere Ziku nisi të punojë herë në një vend e herë në një tjetër dhe rrallë shkonte në shtëpi. Për të gjithë sikur ishte i huaj. Vetëm rrogën ua çonte rregullisht. Herë e çonte vetë, herë vinte ndonjëri nga djemtë dhe ja merrte.

Kur mësoi këto, ju ndrydh zemra keq Maxhunit. Ai nisi ta donte Zikun si njeri shumë të afërt. Ai tani e kuptonte fare mirë pse Ziku desh kaq shumë të jetonte, jetën, pse përzihej ashtu me djemtë e vajzat e minierës, pse i kish aq të thella rrudhat në ballë dhe pse herë-herë humbte vështrimin e tij në diçka të largët e të hidhur. Çfarë mendonte vallë Ziku në çaste të tilla? A mos i kujtohej vallë djalëria e tij e humbur, jeta pa gëzim, guri i rëndë i zemrës, apo ajo martesë e dhimbshme, e rëndë, e ftohtë?

Maxhuni, i shtrirë në krevat, shikonte nga dritarja

Zikun me djalin që kaptuan shkurret e thanave dhe dolën në bregun e përtejme.

Dielli po ulej matanë grykave të Kilbit, ajri ish i kthjellët dhe në lëndinat përtej përroit skuqnin kokrrat e trëndafilave të egër. Ziku qëndroi një hop në këmbë me djalin, pastaj u ndanë dhe ai erdhi për këtej, nga rruga përmes shkurreve të thanave. Në derë doli Mira dhe shkoi te gardhi të ndente ndërresat. Flokët i kishte lidhur me një shall të hollë dhe kishte veshur një triko të ngushtë që i rrinte puthur pas trupit. Sa e bukur ju duk Maxhunit! Faqet sikur i digjeshin, kaq të kuqe dhe gjithë jetë i kishte. Ziku e pa që atje tej dhe shkoi drejt saj, duke shkelur nëpër barin e hollë të mezhdave. Jashtë ishte kaq qetë e kaq mirë. Pyjet qenë qëndisur plot ngjyra të bukura nga vjeshta, ajri ishte kristal i kthjellët, dielli ish i butë e i ëmbël dhe nëpër shkurret e në barin e hollë fërfëllonte një duhmë e lehtë ere që të kujtonte pranverën.

— Do të vish me mua, Ziku? — e pyeti Mira, kur ky qëndroi pranë saj.

— Kur do të nisesh? — e pyeti ai.

— Ja, tani.

Ajo do të shkonte në fshat, se kishte konsultim me nxënësit.

— Mirë — i tha ai.

Mira mori kanistrën dhe u fut brënda. Maxhuni shtyu me këmbë kanatën e dritares dhe rregulloi kokën në jastëk. I vinte gjumë.

Në fund të shtatorit Ziku shkoi për 4-5 ditë me leje në shtëpi. Ata të shtëpisë i çuan fjalë që të vinte, se kishin një punë me rëndësi. Maxhunit i ranë ca fjalë në vesh, por s'dinte në ishin të vërteta. Thoshin se Ademi u kish thënë atyre të shtëpisë së Zikut së Ziku me mësuesen... por Maxhuni s'e besonte që shpifja të arrinte deri këtu.

Ziku u ngrit shumë herët, ëmbëlsoi gojën me një karamele, ndezi një cigare, u vesh në errësirë dhe doli ngadalë, duke mbyllur me kujdes derën nga prapa. Maxhunit i doli gjumi, po nuk i foli.

Ato ditë që mungonte Ziku, Maxhuni vinte re se si ai, ashtu dhe mësueset dhe inxhinieri provonin atë ndjenjë malli që na pushton kur mungon një njeri i dashur. Nuk kishte pothuaj bisedë që nuk e zinin emrin e tij në gojë. Maxhuni mendohej me veten e vet të gjente si kishte hyrë kështu në jetën e tyre ky njeri.

Inxhinieri, sikur t'i përgjegjej pikërisht një pyetjeje të tillë, tregonte se si njëherë, në dimër, kur në minierë kishte rënë borë e madhe dhe në Qafën e Dardhës kishte mbetur karvani i mushkave që sillte ushqimet për kantieret, i pari njeri që kishte dalë përmes tufanit e i kishte shkuar në ndihmë karvanit, kishte qenë Ziku. Ai kishte dalë më oborr i mbështjellë me peliçe dhe inxhinieri e kishte pyetur se ku po shkonte. Ziku pat bërë me kokë sikur po shkonte në klub, kurse në të vërtetë nuk kishte shkuar në klub, po kishte shkuar te karvani dhe në darkë vonë ish kthyer me ata të karvanit, duke tërhequr një mushkë prej kapistalli, i mardhur e i nxirë i tëri nga të ftohtët.

Mësuese Zana, me vështrim të ëmbël, të ngulur në perdet që gufonte era, tregonte se ditën kur erdhën ato, shkarkuan plaçkat nga një kamion, që shkonte të ngarkonte trupa dhe mbetën pothuaj nja gjysmë dite në xhade duke pritur një maqinë tjetër për të zbritur në minierë. Atëhere patën parë një njeri që vinte nga gurorja. Ishte Ziku. Ai u kishte thënë se zor se mund të kalonte maqinë më, dielli po perëndonte dhe ato pak plaçka që kishin mund t'i mbartnin në krahë. Vetë ngarkoi në kurriz një deng të madh, kurse ato të dyja morën valixhet dhe nisën të zbrisnin nëpër rrugë.

Mësuese Mira, që ish vajzë e qeshur dhe e hedhur, por që kish një natyrë mjaft të ndjeshme dhe të dhembshur, tregonte për diçka tjetër nga bota e Zikut. Ajo tregonte për atë ditë kur ai e kishte shoqëruar për herë të parë, një pasdite kur ajo shkoi te nxënësit në fshat për konsultim. Ziku u ul në vendin e mësuesit, mbështeti nëllëmbët në tryezë dhe ndenji ashtu gjersa mbaroi mësimi. Shikonte fëmijët e shkollës me një kureshtje të jash-tëzakonshme, herë-herë buzëqeshte kur ata i përgjegje-

shin pa ju marrë goja pyetjeve të mësueses dhe në përgjithësi ishte shumë i gëzuar. Kur dolën që andej dhe po ktheheshin prapë në minierë, ai, si të bisedonte me vete. tha:

«Punë e madhe po bëhet, miniera, shkolla, rrugë... eh, punë e madhe po bëhet».

Mira, që s'u dha shumë rëndësi këtyre fjalëve, tha:

«Shkolla, shkolla, po shikoje një herë! Asgjë nuk ka, vetëm një copë dërrasë të zezë dhe bankat».

Ziku lëshoi krahët dhe pa nga mësuesja.

«Pa çka! ja bëri. Sot dërrasën e bankat, nesër do t'i bëjmë të gjitha. Dalëngadalë. Dalëngadalë».

Ata kishin ecur një hop në heshtje. Pas heshtjes Ziku kish thënë përsëri:

«Dalëngadalë. Jemi të varfër, por të gjitha do t'i kemi. Shikomë mua! Ja, këto që kam veshur kam, asgjë tjetër. Kam dhe një copë shtëpi, të varfër jemi. Gjithë jetën kam punuar si kalë. Ç'farë bëra unë? I këputur mbeta. Djersa ime shkoi si uji në kum. Asgjë. Po pse? Sepse vinte beu e na vidhte, vinte italiani e na vidhte, vinte gjermani e na vidhte. Të gjithë na kanë vjedhur. Po tani, ehu...».

Ziku kishte heshtur. Sytë e tij ishin të butë. Një rrudhë e thellë i qe sajuar në ballë.

«...Ehu, shëndeti, pa të gjitha do t'i bëjmë».

— Një njeri si ai që e do punën dhe jetën ka të drejtë të jetë dhe i lumtur — ndërhyri inxhinieri në mënyrë të papërcaktuar në mesin e tregimit të Mirës.

Ai pat mbështetur bërrylin te shpinorja e karriges dhe këmbët i kishte shtrirë përpara. Pastaj drejtoi trupin dhe tha: — Jeta e tij ka qenë e varfër, kanunet kanë rënduar mbi të me një peshë të tmerrshme, 18 vjeç dhe u martua me gruan e të vëllait. Nuk ka dashur ai njeri të bëhej diçka në jetë? Po si? Me se? Kur? Unë e kuptoj fare mirë atë. Thonë se është njeri që s'do familjen e vet. Dhe kur s'do të vetin, kë do të dojë? S'është e vërtetë. Kjo është një gënjeshtëri. Ziku nuk do varfërinë, nuk do injorancën, nuk do kanunet dhe zakonet që e kanë mbytur.

Maxhunit ju mblodh një komb në grykë. Po, kështu

mes oborrit dhe u hodh në oborrin tjetër. Shiu binte si me shtamba, kurse në male zuri skllotina.

— O Adem! Adem! — thirri në drejtim të njërës nga dy barrakat e vogla.

— Kush është? — u dëgjua zëri i një gruaje nga brenda.

— Aty është Ademi?

— Po.

— Thuaji të dalë!

Ziku shkoi pranë barrakës dhe shkundi me pëllëmbë ujët nga flokët. Dera krisi dhe që andej doli Ademi me xhakëtë krahëve duke u mbllaçitur. Kur pa Zikun, e pështyu atë që kishte në gojë e ja bëri:

— Hë, ç'do?

Maxhuni u lëshua në pikë të vrapit.

— Ziku! Ziku!

— Ç'do? — pyeti prapë Ademi, duke shikuar herë Zikun, herë Maxhunin që rendte.

Ziku u përkul vetëtimthi, mori një grusht baltë dhe ja hodhi në fytyrë.

Krisën dyert e barrakave dhe në oborr u duk një tufë burrash dhe djemsh që rendnin drejt tyre. Brenda plasi lebetia e grave.

— Po vriten! Po vriten!

Ademi ishte lëshuar mbi Zikun, po ky që mënjanuar, e pat kapur për beli dhe e kishte hedhur në baltë. Gruaja e Ademit kishte dalë me sëpatë në dorë, po para se të arrinte ajo, ja bëhu turma dhe ja hoqën nga dora.

I ndanë, dhe një burrë i gjatë me mustaqe e mbërtheu Zikun pas dërrasave të barrakës:

— Ta marr shpirtin, për besë! — klithi ai.

Atëhere ndodhi diçka që i shtangu të gjithë. Maxhuni lëshoi një ulërimë dhe u vërvit si skifter mbi burrin e gjatë me mustaqe duke bërtitur:

— Lëshoje, lëshojeni! Lë-sho-jeni!

Qante dhe dridhej. Të gjithë u stepën të habitur. Mbanin frymën dhe shikonin me sy të çakërritur.

— Shikojeni si e kanë bërë — klithi Maxhuni. — Shikojeni!

Ai rendi drejt Zikut, ja nguli thonjtë në setër e desh ta shqyente, po Ziku u tërhoq. Atëhere Maxhuni u vërvit me tërbim, ja mbërtheu sërisht setrën, dhe ja ngriti deri lart.

— Shikojeni! — briti.

Të gjithë hapën sytë kur panë trupin e zeshkët të Zikut gjithë vurrata e njolla mavi.

Maxhuni e lëshoi setrën të binte poshtë, kafshoi buzën deri në gjak dhe s'i përmbante dot lotët që i rridhnin nga sytë e kaltër në faqet flakë të kuqe.

— Kush të bëri kështu?! — pyeti një burrë i shkurtër me xhakëtë lëkure. Ai shkoi drejt Zikut me duart në xhep, i qëndroi përballë dhe e vështroi drejt me vetulla të rrudhura. Ziku ktheu kokën nga Ademi dhe tha:

— Le ta thotë ai.

Burri me xhakëtë lëkure u kthye nga Ademi. Ky gufonte nga zemërimi, gungat e muskujve të nofullave i lëviznin nën lëkurë dhe turfullonte i mbajtur nga dy veta që rrinin të ngrysur.

— Ke për të më parë — hakërrehej ai.

Burri me xhakëtë lëkure, pa i hequr duart nga xhepat, shkoi drejt Ademit dhe i qëndroi përballë:

— Djemtë e vet e bënë ashtu! — thirri Ademi. — Se atë kokë ka.

— Pse?

— Sepse mjaft harboi me atë — dhe ktheu kokën nga ana e Mirës që rrinte mbi mezhde.

Atëhere një «uuuu» e mbytur u ngrit si dallgë nga turma dhe nga grumbulli u lëshua një djalë i gjatë e bërtiti:

— Gënjen! Ky maskara gënjen! — thirri dhe shkoi drejt Ademit.

Plasi rrëmuja. Ademin e tërhoqën në shtëpi, kurse njerëzit bërtisnin.

— Hiqeni nga miniera! Maskarai! Gënjen!

Dikush mori një gur të madh dhe ja hodhi në derë. Burri me xhakëtë lëkure i shtynte e u bërtiste njerëzve që të largoheshin.

— Ka parti këtu — thoshte — dhe partia do ta shohë këtë punë. Shkoni tani!

Rrebeshi i shiut pushoi, po nëpër shkurret e thanave vërtiteshin duhma ere që zbrisnin nga malet. Mjegu-lla qe çarë dhe përtej dukeshin kurrizet e errëta gjithë pyje e gurë të Kilbit. Njerëzit u futën përsëri nëpër barraka dhe zhurma pushoi. Ziku shkoi në dhomë dhe u ul në krevat. Prapa tij, pranë dritares rrinte Maxhuni dhe shkërmoqte nga xhaketa dy kokrriza balte të tharë. Zana kishte ndezur sobën në dhomën e tyre dhe ishte ulur pranë Zikut, në një shkëmb druri. Mirës po i vinte dalëngadalë të kuqtë në fytyrë dhe ishte ulur në karri-ge afër Zanës. Inxhinieri ishte më i qetë. Ai shfletonte një revistë, i ulur në krevat. Kishin ardhur dhe tri-ka-tër veta të tjerë dhe rrinin të heshtur.

Në sytë e të gjithëve sikur qe ndezur një dritë e re.

Pastaj të gjithë ikën. Në dhomë mbeti Maxhuni me Zikun. Ziku u ndërrua, vuri ujë të rruhej dhe hëngri pak bukë me djathë.

— S'është kollaj — tha ai sikur fliste me vete dhe në mënyrë të pakuptueshme. — Por dalëngadalë, dalëngada-lë. Kemi qenë të varfër, shkollë nuk kemi pasur, qorra kemi qenë.

Maxhuni e shikoi me vërejtje.

Po binte mbrëmja. Era i kish shtyrë retë tutje honeve dhe nga perëndimi kuqëlonte qielli nga rrezet e diellit. Pastaj flakërima në qiell u shua dhe në minierë nisën të ndizeshin dritat. Diku te një shtëpi e vogël dër-rase në majën e një bregu ndezën një radio. Jonet e një kënge të njohur përhapeshin nëpër qytezën e vogël dhe nga strehët pushoi kullimi i pikave.

Ziku u rrua, veshi trikon me grykë të lartë dhe u mbush me frymë, sikur të qe çliruar nga një peshë e rën-dë. U dëgjuan hapa nëpër shkallët prej dërrase, pastaj krisi dera dhe brenda hyri Zana:

— Do të shkojmë të hamë darkë?

— Po! — tha Ziku.

Klubi, atë mbrëmje, Maxhunit ju duk më i pastër e më i bukur. Mira dhe Zana hanin në heshtje, minatorët

nëpër tryezat e tjera bisedonin me zë të shtruar dhe në prak të derës përplasej duhma e erës së fortë që zbriste nga malet.

Pastaj, si për inat të Ademit, u mblodhën në barrakën e gjatë dhe Mezani hipi në tryezë, zërtheu fisarmonikën dhe mbështeti mjekrën pas tastierës. Midis djemve dhe vjazave të minierës kishin ardhur dhe fytyra të reja. Ja, prapa shpinës së Mezanit, Maxhuni dallonte fytyrën e një vajze fare të re, që shikonte me ata sytë e pastër rreth e rreth e drojtur dhe me njëfarë kureshtjeje të dukshme. Ajo ishte vajza e brigadierit të galerisë së parë, Saliut. Kishte një javë që i ati e kishte futur në punë, tek arganelot në dishanteri. Duke shikuar atë, atij i kujtohej dita e parë që kishte ardhur këtu, po ashtu i drojtur i gëzuar dhe gjithë kureshtje. Ja dhe dy-tri djem të rinj me flokë të shkurtër, me shiritin e qeleshes së posahequr rreth e rreth kokës, me setra të vjetra, por gjithë jetë e gjallëri.

Maxhuni ndjeu një ngrohtësi të madhe thellë në veten e tij.

Ktheu sytë dhe vuri re se Ziku kishte mbështetur bërryllin te tryeza, pinte cigare dhe bisedonte me inxhinierin dhe me atë burrin me xhakëtë lëkure. Mirës i binin flokët mbi sy dhe Maxhunin sepse e dogji dëshira të shkonte një ditë në shkollë dhe të shikonte nxënësit e saj se si e dëgjonin mësuesen që tani rrinte përballë tij e thjeshtë, e mirë, e dashur. Herë-herë ajo hidhte sytë nga Ziku. Maxhuni fërkoj ballin dhe ju kujtua se pas dy javësh do t'i martohej i vëllai. I erdhi keq kushedi përse dhe u mundua ta largonte këtë mendim. U ngrit dhe shkoi pranë dritares. Në qiell qenë ndezur yjet.

KUR ZUNË SHIRAT E VJESHTËS

Atëhere unë punoja në Stanbobo, në një vend fare të padëgjuar në brigjet e Devollit. Tri-katër barraka mbuluar me katrama, fushë, rrugë të ngushta e morira shëlgjesh të shtrembëra — ja panorama e këtij kantieri të veçuar nga bota, ku ditët në verë ishin të nxehta dhe netët të freskëta. Nuk mund të thuash ndonjë gjë të veçantë për të, për njerëzit, për punën e për gjithshka.

Tamam në një vend të tillë unë pata shkuar me dëshirën time. Kjo ka historinë e vet. Në verën e vitit 1956 mbarova fakultetin e ndërtimit dhe, si njeri fatmbarë, si më thoshin shokët, me emëruan në një drejtori të ministrisë. Të gjithë ja kishin zilinë fatit tim, po unë shkova te ministri, ju luta të më çonte në Stanbobo, me që kisha dhe fshatin tim në këto anë e puna mori fund me kaq. Në fillim duket i çuditshëm ky vendim, që mora në ato ditë korriku, vërtet, po pata edhe unë arësytet e mia. Për këtë zor se të besojnë të gjithë, megjithatë, prapëseprapë, unë do të tregoj me zemër në dorë.

Puna ishte se unë, si bir fshatari, se si më dukej vetja e huaj në ministri. E keqja tjetër ish se nuk kisha ndonjë fizionomi për të qenë. A jua ka sjellë rasti të njihni psikologjinë e një njeriu që s'ka fizik të bukur? Nuk them se të gjithë ata që s'janë të bukur mendojnë kështu si unë, po unë u ngjaja atyre që u duket vetja i tepërt atje ku ka zhurmë e u pëlqen më tepër vetmia.

Më kishin emëruar në Tiranë! Hm! Sa pa mend punojnë nganjëherë ata të ministrisë! Le t'ja jepnin këtë vend ndonjë djalkëze, që i pëlqente të llastohej me vajzat nëpër bulevarde e jo mua. Unë rrija si në gjemba sa herë që isha i detyruar të shkoja në ndonjë mbrëmje vallëzimi, s'dija si të rrija, s'dija kur t'i hidhja sytë e kjo më kishte bërë fare të mbyllur. Për të kërcyer, s'kërceja, rrobat s'më rrinin aspak mirë e asnjë vajzë s'më kishte vështruar ashtu siç kisha lexuar ose parë nëpër filma. Dhe dikasteri më emëronte në Tiranë!

Në Stanbobo, i veshur me rrobat e përditshme të punës, ndjehesha shumë i qetë dhe i kënaqur. Më pëlqenin njerëzit veshur me çizme plot njolla gëlqereje, më pëlqenin të gjithë, se ishin të thjeshtë e as u shkante ndër mend të rrinin e të vështronin kush ish i bukur e kush i shëmtuar.

Kjo nuk duket ndonjë gjë e madhe, po këtë e marrin vesh të gjithë ata që s'dinë ku të ngulin sytë, kur ndodhen para vështrimit hetues të atyre që u pëlqen t'i peshojnë njerëzit nga forma e jashtme. Punë e madhe për njerëz të tillë? Eh, ashtu është vërtet, po ja që është zor të jesh gjithmonë indiferent.

Pra, në Stanbobo shkova me dëshirën time.

Dhe aty dashurova për herë të parë. Sa i çuditshëm është fati i njeriut!

Një pasdite gushti, kur u ktheva në kantier, gjeta në zyrën time një vajzë të re, që qe përplasur në një tryezë dhe po mendohej fare e dërmuar. Fytyra i qe bërë me njolla të kuqe, flokët e prerë shkurt i kishin rënë të shpupuritur mbi ballë e sytë e mëdhenj i ishin enjtur nga të qarët. Ajo më shikoi fare ftohtë e me vetulla të rrudhura, po, kur mori vesh se unë isha inxhinieri i punimeve, më dha dorën e u njohëm.

Quhej Eral. Vajza atë vit kishte mbaruar teknikumin e ndërtimit dhe tani e kishin emëruar në kantierin e Stanbobos, si zbatuese të projektit. Ky emërim i pat ardhur si bombë dhe e kishte hutuar fare. Ajo kishte rëndur në të gjitha zyrat e dikasterit, qe përpjekur poshtë e lart për të anuluar emërimin, po s'pat rregulluar gjë...

Të gjitha këto i tregonte me zë të dëshpëruar e gati të përvaqshëm.

— Ç'fat që pata dhe unë! — më thoshte. — Shumë nga shoqet e mia i mbajtën në Tiranë, kurse mua më degdisën në këtë vend të humbur. . .

Ajo ankohej, psherëtinte, po, të them të drejtën, s'arrija të kuptoja se ç'e shqetësonte kaq shumë.

E, megjithatë, duhej ta qetësoja në ndonjë farë mënyre. E këshillova që t'i futej punës me zell, se kështu do ta kishte më të lehtë. Bile i thashë se pas një kohe mund ta rekomandoja në minitsri, që ta transferonin. Kjo e gëzoi një grimë e buzëqeshi.

Erali buzëqeshte bukur. Ajo çelej e tëra, si moti pas shiut, e zbulonte dy sërë dhëmbësh të bardhë e të rregullt.

Që këtu filloi historia ime me të.

Nuk e di në do të kishim një histori të tillë, unë dhe ajo, po të ndodheshim në rrethana të tjera. Po rasti e kishte sjellë që ne të punonim së bashku në atë kantier të largët e të rrinim ditë për ditë bashkë, duke ndarë gëzimet dhe hidhërimet me njëri-tjetrin.

Atë vit kishin filluar në Stanbobo punimet për ndërtimin e një pende kanali vaditës, i cili do të çante mes për mes një fushë të lënë djerrë. Jo larg barrakave tona, në rrëzën e një kodre të rrumbullakët, ndodheshin dy-tri shtëpi të ronitura nga vitet e të braktisura nga njerëzit qysh kushedi se kur. Afër shtëpive, në një bregore të ngritur aty pranë, dukeshin kryqe varresh që kishin një hije të zymtë e të trishtueshme.

Një legjendë thotë se shumë vjet më parë patën zbritur në këto kullota ca familje çobanësh, të cilët qenë ngulur aty dhe e quajtën fshatin e tyre të ri Stani i Fiçorrëve. Po familjeve të çobanëve nuk u pat shkuar aspak mbarë në këtë truall të lënë djerrë. Brenda dy vjetëve i shoi vdekja të gjithë e njerëzit nisën ta thërrisnin këtë vend të kobshëm Stanbobo. Dhe nuk kishte guxuar njeri qysh atëhere të shkelte më në këtë vend kobëzi. Qindra hektarë qenë lënë shkretë dhe aty, përveç një bari të hollë e të gjatë, nuk të zinte syri asnjë bimë

tjetër. Kurse kanali do të sillte jetën në këtë fushë të vdekur. Do të thyhej një legjendë me pamje të zyrtë në brigjet shtufore të Devollit. Qysh në vitin e parë të punimeve kishin nisur të mbjellnin në brigjet e kanalit plepa të rinj, që lëshonin shtat e tufëzoheshin plot me gjethe të reja...

Në një vend të tillë punoja unë me Eralin. Merreni me mend: kantier në mes të fushës, barraka bojë hiri, rrugë, llaç e gëlqere. Asgjë tjetër.

Erali atë vit mbushte nëntëmbëdhjetë vjet dhe ashtu e bukur e plot hir siç ishte, veshur me një fustan të gjerë plot ngivra, ngjante si një lule. Nuk e kuptoja dot se cilin desh të gëzonte ajo me ato veshje, me ato bluza të holla, që ja nxirrnin aq mirë në dukje format e bukura të trupit. Kthehej nga puna, lahej e vishej me kujdes, pastaj vinte në zyrën time. Aty bisedonim gjatë rreth tiimave, librave e plot gjërave të këtilla. Erali po ma hiqte dalëngadalë drojtjen që kisha ndaj vajzave dhe, ashtu padashur e pa kuptuar, nisa të sillesha i shkujdesur me të.

Ditët shkonin njëra pas tjetrës, duke më sjellë secila diçka të re e bukur në miqësinë me Eralin. Në fillim kisha dashur të mbaja distancë me këtë vajzë, sepse s'kisha dhe arësye pse ta afroja... Unë... kurse ajo ishte aq e bukur... Po jeta është jetë. Një forcë e fshehtë më shtynte drejt Eralit dhe kjo më futte në mendime. Një gëzim i thellë më harlisej në zemër kur kisha pranë këtë vajzë të re, që më afrohej përherë e më shumë. O, s'e pata provuar kurrë këtë gëzim, s'pata provuar kurrë rrahje zemre si atëhere. Ndjenja të reja thurnin si me droje fole në shpirtin tim të trazuar. Dhe nuk ma fshihnin dot këtë luftë të brendshme as sytë, as fytyra që më ndizej flakë sa herë që vinte ajo.

Një ditë, kur erdhi Erali tek unë, e shikova me kaq afsh e zjarr, sa ajo u tremb. Mos vallë ja thanë sytë e mi të gjitha ato që ndjeja? Nuk e di. vetëm se Erali u skuq, heshti një hop të gjatë, pastaj shkoi. Dhe nuk erdhi më tek unë për disa ditë me radhë.

Atëhere, fare i pezmatuar, e qërtova veten. Si nuk e kisha përmbajtur dot? Dhe pata kujtuar...

Kishte ardhur tetori. Që në mëngjez e gjer në të përnduar, mbi tokën që po e zverdhte vjeshta, ndrinte një diell i vakët e i ëmbël. Ujërat e Devollit ishin të blerta dhe rrëshqisnin pa zhurmë në zajat e bardha të shtratit. Natyra heshtte.

Nostalgjia e vjeshtës sikur na mallëngjente të dy: mua dhe Eralin. Mbas asaj ngjarje, që na largoi, ishin bërë të heshtur, të turpshëm e skuqeshim sa herë që na ndesheshin vështrimet. Një ndjenjë e ëmbël si flladet e pranverës më vërshonte në zemër kur shihja flokët e Eralit, që lodronin me erën atje në breg të lumit. Ajo vërvitej poshtë e lart në pendën e kanalit, u jepte udhëzime punëtorëve e rrallë shikonte nga unë, duke buzëqeshur në një mënyrë të tillë, sa është zor ta tregosh. Dhe heshtnim, vështroheshim dhe ndrydheshim.

Një pasdite, kur po ktheheshim nga penda, Erali m'u afrova dhe më tha:

— Ç'ke kështu, Klita?! Ti...

Ajo qe skuqur e tëra. S'qe e zonja të mbaronte fjalën dhe iku përpara gati duke rendur.

Atëhere unë e humba fare. Tashmë isha thellësisht i dashuruar pas saj. Ç'gjë e çuditshme, ç'gjë e ëmbël dhe e madhe ishte të dashuroje për herë të parë!

Ecja pas Eralit dhe sytë s'më shqiteshin nga flokët e saj, nga trupi dhe nga hapat, që i hidhte aq lehtë mbi rrugën plot bar të gjelbër. Një botë e tërë shkëlqënte para syve të mi. Për mua ishin të dashura të gjitha sendet që më rrethonin, sepse ndër to jetonte Erali, ndër to shkelte Erali e buzëqeshte Erali.

Dhe erdhi një ditë që më solli diçka të madhe.

Ishte e diel. Shumica e punëtorëve kishin shkuar nëpër shtëpira, kurse unë me Eralin kishim dalë në brigjet e Devollit. Nga Tomorri frynte një fllad i butë e në qiellin e kaltër lundronin re të bardha.

Rrinim në një trung e heshtnim. Rrezet e diellit lodronin me valëzat e lehta të lumit, që gurgullonin e rrëshqisnin drejt perëndimit, plot melodira të mbytura. Fusha çelej e mbyllej nga hijet e reve e kishte diçka të ngjashme me shpirtërat tona ajo lodër hijesh.

Si ndenjëm një kohë të gjatë në heshtje, Erali u kthye nga unë e buzëqeshi gati me hidhërim. Ajo picërroi sytë e bukur duke pulitur qepallat e tha me zë të dobët:

— Klitë, dua të mbytem. Ja, këtu lumi është i thellë, i gjerë...

Psherëtiu e shikoi përpara, duke mbështetur mjekrën në pëllëmbë. Tashmë sytë i kishte ngulur mbi sipërfaqen e ujit, ndërsa në ballin e lëmuar i dridheshin prej erës tufëza floku të ndritshëm.

— Oh, do t'u mbytke, ë? — thashë unë pa e pasur mendjen aty. — E pse kështu?

Ajo u kthve pravë nga unë. Tani m'i kishte ngulur sytë kaq etshëm, sa e humba fare. Si të mos duronte më, u çua e rendi drejt ujit. Unë u tremba.

— Eral! Je në vete?! — i thirra e vrapova pas saj. Në atë vrap vija re formën e bukur të trupit të saj dhe shpatullat e plota që tundeshin nën bluzën e hollë. Ajo rendte dhe leshrat ja merrte era.

Në atë vrull vrapimi mua sikur m'u ndezën të gjitha ndjenjat, që më qenë platitur nga heshtja e gjatë. E arrita, e mbërtheva nga shpatullat e gati po e shtrëngoja në krahët e mi, po në atë çast hasa vështrimin e saj të trembur e të habitur njëkohësisht. E lëshova.

Po pikërisht në atë çast ndodhi e papritura. Erali m'u hodh në qafë, më harkoi rreth belit krahët e ajthëm e ndjeva pranë vetes tërë trupin e saj që dridhej. I futa gishtërinjtë në leshrat e shkurtëra, ja ngrita fytyrën plot njolla të kuqe dhe e putha. Në ato çaste e humba fare. Për herë të parë në jetën time mbaja ndër duar një trup vajze dhe s'dija ç'të bëja. Po s'vanoi shumë dhe Erali më shtyu si me zemërim, zuri fytyrën me duar e ja dha të qarit, duke u përplasur në një shesh me bar.

— Eral! Po ç'ke ti? — e pyeta i habitur, ndërsa mundohesha t'i ngrija kokën.

Po ajo më vështrroi aq rreptë, sa më erdhi ligisht.

— Lërmë, — tha — lërmë... Oh, mama!... — dhe u ngashërye papë.

Më erdhi shumë rëndë dhe turp. Fytyra më digje

nga të nxehtët e sytë më qenë errur fare. Ndoshta s'duhej të kisha vepruar ashtu. I dërmuar, bëra nga buza e lumit, duke dashur ta leja vetëm për pak kohë. Freskova fytyrën, futa duart në ujë e nisa të hidhja guriçka në fundin e kulluar. Një krapuliq nxitoi të kapë një zall të bardhë, që i hodha unë, po me të parë se nuk ishte ushqim për të, përplasi bishtin e iku i trembur.

— Budalla! — murmurita e buzëqesha fare hidhur.

Kaluan disa minuta. Erali u çua e nisi të më vërente me sy të buhavitur nga lotët. Në buzët e saj endej hija e një nënqeshje të lodhur e qortuese njëkohësisht; u afrova, i përkëdhela flokët e kështu u pajtuam prapë. Vonë u kthyem në kantier, të dashuruar e të lumtur.

Tetori kaloi. Në Stanbobo zunë shirat e pandërprera të vjeshtës. Brigjet e Devollit nisën t'i rrihnin erërat e ftohta të lindjes e mbi fushën e përgjumur rëndonte vazhdimisht ai qiell i murrmë e i zymtë. Arat e hendeqet u mbytën nga ujërat e trubullta, drurët nisën të shkundnin gjethet e verdha e natyra bojë hiri qe tulatur në rrobën e lagësht, duke pritur ngricat e cikmat e dimrit.

Po afrohej koha të braktisnim Stanbobon tonë, që u bë vendi më i dashur i jetës sime. Devolli qe fryrë breg më breg e punimet do të ndërpriteshin, për të rifilluar verën e ardhshme. Tashmë shirat s'të linin të pregatitje llaçin, vërshimet e lumit e bënin të pamundur nguljen e themeleve të digës. Dhe barrakat në atë kurriz toke të verdhë, të rrethuar nga ujërat, i ngjanin një anijeje, që mezi u bën ballë stuhive të vjeshtës.

Punëtorët u larguan të gjithë, së fundi edhe unë me Eralin.

Shkonim në Tiranë për dy arsye: Të emëroheshim nga dikasteri në ndonjë vend tjetër për periudhën e dimrit dhe, e dyta, unë, të kërkoja Eralin për grua pranë familjes së saj. Kështu kishim rënë dakord.

Nga Stanbobo u nisëm një ditë nëntori. Atë mëngjez shiu pat pushuar e retë qenë davaritur nga erërat e natës. Ecnim në një rrugë tërë baltë e Erali s'pushonte së treguari ndodhira të ndryshme; ishte në qejf, që po

shkonte pranë familjes e gëzimi i saj më bënte të buzëqeshja herë pas here.

Po, me sa më kujtohet, kishte diçka të dëshpëruar atë ditë buzëqeshja ime. Nuk desha që të largohesha prej Stanbobos.

Si ecëm dy orë e ca nëpër fushë, dolëm në rrugë të maqinave e aty i hipëm një kamioni për në Rogozhinë.

Stacioni i trenit ishte plot me njerëz, që lëvrinin poshtë e lart me çadra në duar. Nga qielli i murrmë sapo filloi të binte një shi i imët, që rrihte me zhurmë të mbytur pullazet, muret dhe xhamat e dritareve.

Pritëm aty një orë e ca, derisa erdhi treni i pasdites, pastaj hipëm në vagon, në një kabinë të veçuar. U nisëm.

Para nesh kalonin me shpejtësi ara e ugare të mbytura nga ujërat e vjeshtës. Ne përkundeshim në raketa-kun e rrotave të çeliktë, shikonim jashtë e mendoheshim. Erali e pat mbyllur gojën prej kohësh e në sytë e saj kishte rënë një hije e zymtë.

Në një stacion, ku treni ndenji disa minuta, në çastin kur do të niseshim, dera e kabinës sonë u hap me vrull. Brenda hyri një vajzë e një djalë, që qeshnin e bisëdonin me zë të lartë.

— Oh, oh, Petrit! — thosh vajza, duke shtrydhur flokët. — Një pantomimë e vërtetë.

Djali, një brun shtatlart me leshra të zeza të krehura bukur, buzëqeshte e fshinte fytyrën e lagur me shami. Ishte një çift elegant që spitulloheshin dhe shisnin mend.

Ata erdhën e u ulën përballë nesh.

Djali na vështroi një hop. Trikoja e Eralit dhe fundi i saj prej stofi ishin ndotur në dy-tri vende nga balta. Po megjithatë dukej elegante. Kurse kostumi im lera-lera se si dukej në krahasim me kostumin e prerë bukur të djalit që kisha përballë. Nuk e di pse qemë shqetësuar papritur me ardhjen e këtij çifti.

— Arësimitarë jeni ju? — pyeti djali.

— Jo, teknikë — thashë unë.

— Ah! — ja bëri ai dhe u hodhi një sy përsëri rrobave të mia.

Vajza e vështroi me çip të syrit dhe buzëqeshi. Unë ktheva kokën nga Erali; ajo kishte ulur kokën dhe qe skuqur. Kur ndjeu se po e vështroja, ngriti sytë e në atë çast pashë në ta një dritë që s'e kisha vënë re kurrë më parë. Ata thoshin se asaj, Eralit të bukur, i vinte turp që ishte pranë meje.

Nuk kam provuar gjë më të rëndë në jetën time se sa zori që ndjeja në ato çaste. Sikur qeshë bërë brenda një sekonde fare i huaj dhe i largët për Eralin, që pat ulur kokën e skuqur flakë nga turpi dhe mendohej pa nxjerrë një fjalë. Një gjyç më shtrëngonte si me darë në grykë. Desha të isha vetëm. Fytyrën e Eralit sikur po ma zbehte e po ma largonte një mjegull.

Megjithatë nuk mundesha të mendoja keq. Fajin, për të gjitha këto, ja vura çiftit, që sikur na ironizonte.

Ne zbritëm në stacionin e Durrësit, meqë treni aty qëndronte gjatë. Në fillim Erali tha se i pëlqente të rrinte në vagon, po pastaj, si e zënë ngushtë, u ngrit e erdhi me mua, duke tërhequr këmbët me plogësi. Ajo tashmë nuk fliste fare. Mendohej, heshte dhe sikur ruhej të mos e shihnin me mua. Kjo më zemëroi. Mbajta hapat e pashë gati me tallje dhe i thashë:

— Po ti ç'ke kështu? Nga cili ruhesh?

Ajo, si e gjetur në befasi, e humbi dhe bëlbëzoi:

— Unë?... Nga asnjëri. Pse Klita?.. Ua dhe ti!..

Nga deti frynin erëra të ngrohta, që i trazonin retë e murrme lart në qiell. Pullazet e qytetit herë prisnin ca pika të mëdha e herë-herë fshikulloheshin prej erës së fortë, që tërhiqte zvarrë një këngë dimërake.

Tani ne s'flisnim fare me njëri-tjetrin. Heshtnim, mendoheshim e sikur bluanim diçka jo të mirë për të ardhmen tonë. Dhe kështu kishim dalë në një rrugë kryesore. Çifti, që udhëtoi me ne, na kaloi pranë i mbërthyer krah për krah e na vështroi përsëri. Erali i ngadalësoi hapat si padashur e mbeti prapa sikur të mos ishte me mua. Ecte ngadalë dhe shikonte përdhe. E pat humbur fare dhe qe skuqur shumë.

Ashtu, njëri pas tjetrit, hymë në një pastiçeri. Një

pasqyrë e madhe ndodhej para nesh. Shikoja veten dhe Eralin dhe më vinte keq jo për veten time, po për atë vajzë, e cila sikur më dënonte që s'isha dhe aq i bukur. Ajo nuk kuptonte asgjë, ajo nuk ndjente asgjë, kurse unë e pata dashuruar me aq zjarr, me aq shpirt. Unë isha gati të shkoja me të deri në fund të botës, jo sepse ajo ishte e bukur, po sepse e doja. Kurse asaj i vinte zor t'ja shihnin «të dashurin për krahu». Ndoshta kjo vajzë nuk e pat peshuar mirë hapin që hodhi drejt meje, ndoshta ajo që gënijer me veten e saj, duke kujtuar se më donte. Po tani po diziluzionohej e po mbyllej në vetëvete, duke i ardhur keq që kishte lidhur fatin me një njeri si unë. Të tillë nuk e kisha njohur kurrë Eralin dhe të tillë nuk e doja në asnjë mënyrë.

Jashtë po binte të mugëtit e mbrëmjes. Me këto mendime u ngrita e u nisëm për në stacionin e trenit. Nëpër rrugë kishte pak lëvizje e, për çudinë time, Erali sikur po kthehej në dashurinë tonë. Errësira, vetmia ngjallnin ndjenja të ëmbla në shpirtin e saj. Kur ishte vetëm për vetëm me mua, asaj s'i vinte zor për asgjë.

— Klitë! — më tha. — Ti sikur u zemërove me mua.

— Unë? Oh, jo, Eral! Ashtu të është dukur.

Po në stacion ndodhi diçka që i vuri kapak historisë sonë. Erali u takua me disa shokë e shoqe, që i kishte pasur dikur në klasë. Ata e rrethuan plot fjalë e të qeshura dhe ashtu grumbull hipën të gjithë në një vagon. Unë, i mbetur vetëm, i heshtur e i pezmatuar, u vajta pas, pa e ditur as vetë përse.

Brenda në vagon ndriste një llambë e zbetë, që u jepte ndriçim të kuqërremtë fytyrave dhe orendive. Erali ishte ulur afër dritares dhe, kur më pa mua, u skuq dhe e humbi fare.

Unë ktheva kokën mënjanë dhe vështrova jashtë. Më kishte mbetur në sy vështrimi i ngrirë dhe nënqeshja e hutuar e saj. Pse pata ardhur aty? Ç'doja unë? Dashurinë e saj, sepse më pat dhënë fjalën? Çfarë dashurie kishte ajo? Oh, jo jo!

Në ato çaste m'u kujtua ngjarja në breg në Devollit.

Mendime pa anë e fund vërtiteshin në mendjen time. Sa vinte dhe Erali më bëhej më e largët, më e huaj. Nga zemra po më shkulej me dhembje diçka që kishte qenë për mua e ëmbël dhe e shtrenjtë. Tashti i kuptoja fare mirë vështrimet e saj të mënduara, që më hidhte gjatë rrugës sikur desh të gjente tek unë atë diçka të fajshme të asaj historie, që s'duhej të kishte ngjarë midis nesh. Stanbobo ynë kishte mbetur prapa përgjithmonë, diku atje pas fushave të përgjumura e të përbaltura. Kurse ajo desh të dukej.

Bëra për nga dera që të dilja, po Erali më pa.

— Klitë! — thirri ajo. Zëri i tingëlloi në një mënyrë të çuditshme. Shokët e shoqet e saj heshtën. Ajo erdhi tek unë e, me fytyrën tërë njolla të kuqe e me buzë që i dridheshin, tha:

— Po ti pse rri këtu? Hajde!

Nuk ja prisha.

— Është inxhinieri im — u tha Erali shokëve dhe shoqeve dhe më njohu me të gjithë. Ajo dukej kaq e hutuar dhe e tronditur, sa që mua më erdhi shumë keq për të. Bisedat u prenë dhe tashmë heshtnim të gjithë. Për mua ajo ishte një vajzë tjetër. Se nuk u dashka gjë e madhe për të thver një zemër të dashuruar.

Në Tiranë arritëm vonë në mbrëmje. Kryeqyteti ynë edhe në dimër është i bukur. Rrugët janë të pastra e të lara nga shirat, disa drurë mbajnë ende rrobe të gjelbër dhe të gjitha këto të futin në një atmosferë të ëmbël e ëndërruese.

Kur dolëm nga rruga e stacionit të trenit, u ndala vetëm me të dhe i thashë:

— Eral! Unë po shkoj.

Ne, në Stanbobo, kishim vendosur që unë do të shkoja drejt e në shtëpinë e saj bashkë me të.

— Ku? — pyeti ajo, duke më parë drejt me ca sy të hutuar.

— Kam një mikun tim këtu — i thashë.

Një vrundull ere me lagështirë fryu nga ana e bulevardit. Flokët e saj u trazuan dhe ajo hoqi me gishtërinj një cullufe, që i zuri sytë.

— Klita, po... si kështu, Klita? Nuk do të vish nga ne?
Më shtrëngonte një lëmsh në grykë, teksa shihja flokët e saj të errët që i trazonte era me lagështirë.

— Jo — i thashë unë.

— As nesër?

I kapa krahun lehtë, ja shtrëngova pak dhe, ndërsa ajo më shikonte me ca sy si të turbullt e të habitur, i thashë:

— Jo! T'i harrojmë të gjitha, Eral! Lamtumirë!

I ktheva krahët e ika, ngaqë kisha frikë se mos më tradhëtonte zëri, që ma shtrëngonin lotë në grykë.

Pas meje dëgjova një dënesë të mbytur, që e mori era e lagësht e shiut dhe e treti diku, në fshehtësinë e errët të rrugëve. Ndoshta Erali qau, faqet e saj ndoshta i mbuluan lotët e kripur, po unë ika dhe qysh atëhere s'u pamë më...

Tani ka kaluar kaç kohë. Unë jam burrë i martuar dhe sa për Eralin, ajo kushedi se ku do të jetë tani që po shkruaj këto kujtime. Në zemër më ka mbetur vetëm keqardhja, jo për këtë histori të shkuar, por për atë vajzë, e cila s'besoj se e ka gjetur lumturinë. Po si të thuash? Ndoshta ajo s'e meriton as këtë.

MË SHTINI PRANË VESHIT QË TË THEM SE JEMI GJALLË

Daullet nisën të gjëmonin përsëri. Në mëngjezin e thellë, që mezi zbardhte në mes heshtjes dhe mjegullës së dimrit, era e çonte larg murmurimën e tyre drithëruese. Këto daulle sikur tërhiqnin zvarrë një shqetësim të madh e të kobshëm.

— Veshët më bëjnë, o Qani, apo me të vërtetë nisën të bijen prapë daullet?

Ky që tha këto ish një burrë i shkurtër e me faqe të kuqe, në kokë mbante një feste të zezë dhe zverkun e kishte të bëshëm e të trashë.

— Daullet, o Baze! — ja ktheu tjetri, që kishte mbërthyer pëllëmbët e trasha pas parmakut të çatmasë. Dërrasat e brejtura nga krimbi kërcisnin me rënkim nën peshën e trupit të tij. Pas tyre rrinin dhe katër fytyra të tjera të murrëtyera nga thëllimi i mëngjezit e si të ngri-
ra nga ai shqetësim i madh.

— Oj, daullet! — ja bëri burri me feste të zezë.

Katër ditë më parë, kur kishin nisur të binin këto daulle në këto lugje të thella malesh, qenë hapur lajme të ndryshme e kontradiktore. Disa thoshin se në ato anë qe dukur një kolonë partizane e se kjo kollonë s'ish gjë tjetër veçse mbeturina partizanësh të shpëtuar nga operacioni i dimrit që u patën hyrë rrugëve të vështira drejt kufirit. Disa të tjerë thoshin se ish një brigadë e ar-

dhur nga Jugu, e cila, gjë që të çudiste e s'kuptohej dot, përshkonte zona ku gjermanët dhe ballistët ishin mizëri. (Kolona në të vërtetë ishte brigadë, e cila ish ngarkuar të kryente një mision mjaft të rëndësishëm. Asaj i duhej në pak ditë të përshkonte qindra kilometra nga Jugu në Veri, të çante përmes zonave të armikut sa mund e më shpejt, të përballonte kurthet dhe pusitë e tij, dimrin e egër dhe rrugët e gjata, urinë, të ftohtët e netët pa gjumë. Një pjesë e shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë nacionalçlirimtare kishte mbetur e rrethuar diku në malet e Veriut dhe kësaj brigade i duhej të çante si tufan përpara për ti shkuar në ndihmë.

Kjo kolonë që dukur në këto anë pikërisht në atë kohë kur armiku pat hapur fjalë se pas Operacionit të dimrit në male nuk kishte mbetur këmbë partizani. Si u duk ajo, armiku hapi fjalën tjetër se ajo ish një kolonë me mbeturina partizanësh që shpejtonin të shkonin diku drejt kufirit. Dhe nëpër fshatra nisën të gjëmonin daullet, me anën e të cilave armiku ngrinte në këmbë forcat e veta dhe njerëzit e gënjyer.

Në ditët e para daullet gjëmonin me tërsëllëm. Nga fshati në fshat balli qarkullonte fjalët: «Erdhi dita e dasmës sonë. Bjerunj daulleve dhe ngrehuni gjithë sa jeni, për t'u dhënë kopaçen e fundit rreckamanëve që s'duan fe dhe atdhe. As armë kanë, as bukë e as rroba kanë, po kanë mbetur si ai qeni i rrahur që edhe një dru do që t'i dalë xhani».

Me treqind pushkë, ballistë e fshatarë të gënjyer, Bazja kish zënë ca gryka të ngushta, në një fshat të thellë të vogël ku kalonte rruga që të hidhte matanë maleve që ngriheshin si kurorë.

Një ditë më parë atij i kish ardhur një lajm i gëzuar. Në Përroin e Ngushtë, një fshat dy orë larg që andej, kolonës i që kurdisur një kurth, nga i cili nuk mund të shpëtonte kurrsesi. Katërqind e ca pushkë i kishin prerë rrugën, nëntë mitraloza do ta qëllonin nga shpina kur ajo të futej në përrua, nga e-majta do të sulmonin gjermanët me ushtri e armatime të shumta, kurse nga e djathta ngriheshin male të larta e të pakalueshme nga bora e madhe.

Ai mezi e priste sahatin që kolona të binte në këtë grackë. Dhe sahati kishte ardhur. Mbi malet e mbi luginat kishte rënë nata e thellë e dimrit, kur atje larg nisën të shtinin nëntë mitraloza përnjëherësh. Krismat e tyre era i sillte fare afër, sikur të ishin atje prapa pyllit të zhveshur, që nxinte si një endërr e keqe. Pastaj qe ndezur zjarrri i madh i luftës, që përhapej si një gjëzim i dridhshëm.

«Gjynah! murmuriti Bazja, që kishte dalë në çardhak dhe vështronte diku me sy të kredhur në errësirë. Gjynah që s'u ndodhëm atje në këtë sahat, po qëlluam të ruajmë këto gryka të shkreta. Me sa mend, xhanëm, do të shpëtonte këmbë nga ata që të vinte gjer këtu?»

Po ja, në këtë agullimë të thellë, daullet nisën të binin përsëri. Ç'ishin këto daulle që binin me atë gjëzim që era herë-herë e sillte fare pranë e herë-herë e trette diku në gropa të errëta të maleve? Lart në qiellin e hirtë të mëngjezit fluturuan gjela të egër dhe fërshëllima e kraheve të tyre kishte diçka të pikëllueshme.

— Daulle janë, o Baze! — përsëriti Qaniu, pa e lëvizur trupin e madh e si të squllët.

...Pas një gjysmë ore, në lirishtat e pyllit të ahut, u duk një njollë e zezë që lëvizte mbi borë. Njolla zbriti shtegun për nga lugjet e dërstilës, kapërceu sheshet me gëmusha te kullotat dhe mori një rëpirë që zbriste thikë. Bazja fërkoj sytë, që ja përlotte thëllimë i mëngjezit, dhe zgjati qafën e trashë përpara. Njolla, që dukej mes bardhësisë së borës, ishte një njeri që rendte i lodhur e i rraskapitur. Ai tani herë dukej e herë zhdukej në kthesat e rrugës, rrëshqiste rrëpirave me akull dhe në atë rendje kishte diçka të kobshme dhe të zezë.

Një avull ju ngjiti nga brenda Bazes dhe, duke dashur të mposhte tronditjen, ktheu kokën nga burri i gjatë e i squllët dhe pyeti:

— Qen është apo njeri ky që na vjen, o Qani?

— Dushari — murmuriti me zë të mbytur tjetri.

— Kodoshi, — shfryu Bazja — xhindet e ndjekin që vrapon kështu?

Qaniu uli kokën dhe kyçet e gishtërinjve i kërcitën kur shtrëngoi drurin e krimbur të çatmasë. Bazja kapi

me buzë cepin e mustaqeve dhe vështronte përpara me sy të vëngëruar.

Ai që vinte drejt tyre tani po i ngjitej arës përpara shtëpisë. Në një dorë mbante kësulën, kurse me tjetrën shtrëngonte rripin e pushkës, që i lëkundej në sup. Flokët e kish të shpupuritur dhe nuk dallohej mirë dhembje plage apo nga lodhja e kish që qe prishur në fytyrë ashtu. Çorapet e lidhura me gjalma pas kërcinjve i qenë ngarkuar me borë të ngrirë. Bazja e ndjeu që atje tej lajmin e hidhur që po i sillte ky djalë me mustaqe të holla. Një tërbim i çuditshëm ju ngjit në kokë përnjëherësh dhe zbertheu këllëfin e revolverit. Por... si ndodhi atje në Përroin e Ngushtë? Vërtet kishin shpëtuar nga ky Përrua? Ç'njerëz qenë atëhere që patën shpëtuar nga ai çark? Pa të tregonte ky djalë një herë si kishin ndodhur kështu këto punë? E shtyu revolverin përsëri në këllëf dhe e kopsiti.

Djali mustaqehollë, i lodhur e i pafrymë, arriti në oborr. Qaniu zbriti shkallët, duke mbajtur trupin të ngrirë si horek.

— Hë, more Dushar? — pyeti me zë të mbytur. — Ç'sihariq na solle?

I porsaardhuri, i verdhë dyllë, si ta kishin lënë forcat përnjëherësh, u mbështet pas pushkës dhe varj kokën poshtë. Supet i lëkundeshin herë pas here dhe nuk dallohej mirë kollitej ashtu apo ngashërehej.

Qaniu u kthye vetullngrysur nga Bazja. Njëpër mezhda qenë afruar njerëz me pushkë dhe shikonin në heshtje të thellë këtë skenë.

Diçka e rëndë sikur ju këput nga gjoksi Bazes. Në fillim ndjeu se gjithshka ju turbullua, pastaj shtrëngoi dhëmbët dhe në këtë pozë dukej sikur buzëqeshte. Brënda një çasti të shkurtër e kuptoi se ai ishte i fundit që mund t'i mbante me shpresë ata njerëz. Nëse do ta lëshonte zemra edhe atë, atëhere turma do të merrte vrapin në panik.

Zbriti shkallët ngadalë. Andej larg, përmes reve, po lindte një diell i sëmurë dhe rrezet e zbeta të tij binin me

reflektë të zymta në gjerdanet e Bazes. Ndali përpara Dusharit dhe, duke mposhtur një zemërim përzier me tmerr, pyeti:

— Po hë, mor bir, ç'sihariq na solle? Mbrëmë i dëgjua pushkët dhe thamë se sot do të shtronim gostinë.

Dushari u përkul më shumë mbi pushkën e vet dhe supet i dridheshin fort.

— Oj, oj, — tha Bazja — po hajt, na thua ç'ndodhi atje?

— Im vëlla Selamiu u vra — tha Dushari me zë të ngashëryer. — Dhe 40 burra të tjerë, o Baze. Në një sahat e sikur firaksën të gjithë në palë të dheut.

Ngashërimi ja preu fjalët për një çast.

— Sikur luftuam me hije e jo me njerëz — vazhdoi Dushari. — Veç kur na u dukën te grykat e dyfekëve dhe nuk pamë se ç'u bë.

Bazja qe bërë si i mpirë. Ngërdheshja e tij në këto çaste i ngjante më shumë buzëqeshjes dhe të gjithë e dinin se, kur buzëqeshte kështu, do të thoshte se brenda ziente dhe nuk pëlçiste.

— Oj, oj! Ç'po na thua kështu! — dhe e pa Dusharin që poshtë vetullave. — Pa shih! Dhe ju ikën nga duart, ë? Katërqind e ca pushkë ju te Përroi i Ngushtë, gjermanin te bytha dhe na qenka bërë kërdua! Oh, oh! Po tjetër ç'do t'i thuash Bazes?

Dushari futi dorën në gjë dhe nxori një copë letër.

— Ma dha Saliu — i tha.

Bazja e hapi me gishtërinjtë e trashë, përkuli kokën mënjane dhe nisi ta lexonte, duke e mbajtur letrën larg.

«Nga Përroi i Ngushtë shpëtuan. Tashti mbeteni ju në Shkallën e Ahut. Treqind pushkët tuaja do t'i mbajnë një sahat sa të dalin gjermanët përpara. Një sahat dhe do t'i qërojmë hesapet mirë me ta. S.»

Përmes heshtjes u dëgjua ngashërimi i mbytur i Dusharit. Bazja, siç e kishte dorën të zgjatur përpara, e hapi anash dhe ja ngjeshi me sa fuqi që kishte në zverk. Mustaqeholli u përkul mënjane, po shuplaka tjetër, që i erdhi nga e majta, ja çoi kokën prapë në vend.

— Tëmën ndër valle t'i mbajmë Saliut — shfryu i tërbuar ai.

Buzëqeshja i qe shuar, fytyra i qe murrëtyer dhe sytë i patën dalë si grushta.

— I binj daulles! — thirri pastaj me zë të ngjirur.

Asnjeri nuk e mori vesh pse u dha ky urdhër, por shumë ishin të mendimit se, si të mblidheshin, do të tërhiqeshin diku. Punët nuk venin aspak mirë dhe kjo dukej nga sjelljet e çuditshme të komandantit. Daullexhiu hipi mbi një pirg gurësh e nisi t'i binte daulles, duke u rrotulluar ngadalë në vend. Bazja qe ulur në një shkallare dhe shikonte i nxirë si kërcop se si vinin njerëzit, duke tringëllitur armët që i hidhnin në sup. Ai pak diell, që qe dukur aty më parë, tani pat humbur pas reve të murrme, që i kishin zënë frymën horizontit si një masë e rëndë. Një tufë sorrash u trembën nga arat dhe fluturuan drejt malit me krakarima.

Bora llapashitej nën këmbët e atyre që vinin. Ata kalonin përmes kopshtijeve, kapërcenin muret me gurë buzë rrugëve dhe mblidheshin në oborrin e ngushtë. Drita e mugët e mëngjezit i bënte më të zymta fytyrat e murrme. Te të gjithë dukej pagjumësia e asaj nate, që u kishite buhavitur sytë dhe u pat rrudhur lëkurën.

Të treqind pushkët u mblodhën në oborrin e ngushtë dhe Bazja, që qe ngjitur në çardhak, i shikonte si i përhumbur në mendime. Kaloi kështu një çast i gjatë dhe në turmë nisën murmurime me zë të mbytur. Atëhere ai u dha shpejt e shpejt rrugë lëkundjeve të veta.

— Ata që shpëtuan te Përroi i Ngushtë, — tha — tani do të kenë punë me ne. Gjermani do të mbërrijë tani dhe do t'i lajmë hesapet mirë. O burra pra, zini vendet, se erdhi sahati ynë.

Po turma, sikur të mos e kishte kuptuar mirë se ç'u tha, ndenji e palëvizur. Bazja hodhi një vështrim mbi kokët e tyre dhe u bëri me shenjë. Nisi shpërndarja. Teksa shihte fytyrat e zbeta të njerëzve të vet, zemra ju drodh dhe e pushtoi një dëshpërim i madh. «Gjidi kodoshi, shfryu. «Sikur luftuam me hije dhe jo me njerëz, vjen e të thotë. «Veç kur na u dukën te grykat e dyfekëve...»

E vetmja rrugë që të çonte në Shkallën e Ahut kalonte mes fshatit, në një ulluk të ngushtë me mure guri dhe me shtëpi në të dy anët. Dhe njerëzit e zinj zinin vend dikush prapa frëngjive, dikush prapa mureve të gurta, dikush nëpër ledhe rrëzë malit ku ngjitej monopati për në shkallë. Rreth e rreth vendin e qarkonin male të thepisura dhe ky fshat ngjante sikur që ndërtuar në fundin e një kazani të madh.

.. Një orë më pas, atje tej te shtegu i lugjeve të dëtstilës, u duk kreu i një vargu të gjatë, që ecte përmes borës. Mjegulla e mëngjezit ende nuk që shpërndarë dhe era që vinte nga grykat rrëzonte pluhur bore nga degët e nxira të drurëve. Bazja qëndronte në çardhak dhe mudohej të dallonte numrin e atyre që vinin, në një rresht të gjatë dhe të lakueshëm. Po fundi i vargut ende s'po mbaronte e që nga kaptina e rrumbullakët e një kodre të vogël vazhdimisht dilnin njerëz njëri pas tjetrit. Qaniu ua bëri me kokë nja dy vetave që rrinin pranë dhe ata zbritën në oborr një mitraloz. Pastaj vunë ca gurë mbi murin e trashë, afruan kasetat e municionit dhe u shtrinë barkas. Mbas pak, dy veta të tjerë nxorrën nga shtëpia edhe një mitraloz tjetër dhe e vunë nja pesëmbëdhjetë hapa larg të parit.

Bazja i ndiqte me bisht të syrit këto veprime dhe herë pas here çonte dorën te faqja, ku i dridhej një nerv i shqetësuar. Qaniu kishte mbështetur bërrylat në parmak dhe veshtronte me dylbi përpara. Pastaj drejtoi 'rupin.

— Kjo është brigadë — tha.

Bazja shkoi reth e rreth ku nxinin grykat e armëve të njerëzve të tij. Këto gryka dilnin që prapa mureve e që prapa frëngjive, pas ledheve e pas mezhdave qark e qark. «Sikur luftonin me hijen dhe jo me njerëz. Veç kur na u dukën te grykat e dyfekëve...» Po, po. Ai e dinte mirë këtë. «Kodoshët shfryu — Ja ngritën çarkun në Përroin e Ngushtë dhe s'i mbajtën dot. Dhe gjermanët i kishin aty».

Kolona i ra qark faqes së kodrës dhe tani po dilte

në një shesh me dushq të rrallë. Gjithshka ndodhte si në një ëndërr të frikshme, ku të pushton llahtari dhe nuk di të zgjohesh. Në këto hapësira të shkreta të zbardhura nga bora lëviznin kaq shumë njerëz dhe mbretëronte një heshtje e thellë. Kjo heshtje të trembte më shumë se befasia, prapa saj sikur fshihej diçka e mistershme dhe fatale.

Pastaj kolona ndaloi. Nga kreu i saj u shkëputën tri veta dhe nisën të vinin këtej, duke çarë shtratin e borës gjatë një rrëpire me lajthi. Ata ecën një copë herë, u afruan nja 100 metra dhe ndaluan pranë një gorrice të re, që tundte degët e holla nga era. Ai i mesit, që ish pak më i shkurtër se të tjerët e që kish marrë në gjoks një automatik gjerman, bëri dhe nja tri-katër hapa dhe ndaloi.

Bazja ngriti kokën e rrumbullakët dhe hapi gojën si nga habia. Qaniu e dinte se, kur hapte gojën Bazja kësh-tu, do të thoshte se ai ishte bërë i tëri sy e veshë dhe dë-gjonte me vëmëndje.

— Dëgjo, o Baze! — thirri partizani me automatik në drejtim të shtëpive të fshatit. — E dimë që je me treqind pushkë këtu, po, para se të nisin pushkët, dil të themi nja dy fjalë.

Ky ishte një zë i trashë e pak si i ngjirur, që kumbonte tej e tej hapësirave të shurdhëta. Bazja mbylli gojën dhe u mbllaçit, duke shtrënguar nofullat sa i dilnin si grushta muskujt mbi faqe. Nën këmbë sikur i patën ikur dërrasat e çardhakut dhe atij i ngjante sikur do të fundosej nga çasti në çast nga një ligështi e madhe që i priste gjunjët dhe i dridhte zemrën. Ktheu kokën ngadalë dhe pa njerëzit e tij, që i rrinin pranë. Po ata kishin ulur kokët dhe heshtnin me fytyra të zverdhura. Vetullat ju rruhdhën më shumë mbi sytë e vegjël dhe mishi i faqes nisi t'i kërcente si purtekë.

— Dil, Sali! — i tha një burri vvarëlie që i rrinte në krah.

— Ç'do t'i themi, o Baze? — pyeti burri pa e ngritur kokën.

— Dil dhe dëgjomë mua ç't'i thuash!

Burri hodhi automatikun në krah dhe doli mbi murin me gurë në krye të oborrit.

— Folë! — tha ai, duke parë nga gorrica, ku kishin qëndruar ata të tre.

— Dëgjo, — thirri partizani — brigada kërkon të lironi rrugën pa bërë pushkë. Prandaj u vini siguresat dhe mos t'ju gënjejë mendja t'ja bëni bam. Ndryshe do t'jua bëjmë siç e dini vetë.

Bazja kishte haour përsëri sojën dhe çonte gjuhën sa në një bulçi në tjetrën. «Bre, kodoshi, mendoj me hidhërim. Ne në pusi, kurse ai na tregon shkopin».

Burri vrarëlie kishte mbetur si hu majë murit dhe s'dinte ç'të thoshte.

— Folë pra, si e keni bërë hesapin! — sokëlliu me të fortë zëri i partizanit. — S'kemi nge të bëjmë gjyqe të gjata këtu. O jo, o po, na jepni xhevapin tashti!

Bazes ju drodh përsëri zemra nga ky zë i vrazhdë që çante heshtjen e thellë dhe kumbonte gjer tej në shpatet e maleve.

— Thuaj, o Sali, se xhevapin do ta japim pas një sahati — tha.

Saliu ngriti kokën dhe tha këto fjalë, por partizani ja preu:

— Jo pas një sahati. Ju japim kohë dhjetë minuta. Pushkët do t'i hiqni tek arat atje — dhe tregoi me gisht.

— Po ju tha mendja ndryshe, nënat tuaja do të qajnë.

Partizani u kthye, u bashkua me dy të tjerë dhe nisën të largoheshin përmes shtratit të hirtë të borës, gjatë rrëpirave me lajthi. Përsëri mbretëroi heshtja e thellë që të futte drithmën. Dëgjohej vetëm përplasja e lehtë e degëve të zhveshura që i lëkundte era dhe u rrëzonte borën. Atje larg, përmes mjegullës së hollë të mëngjezit të vrejtur dimëror, dukeshin partizanët që ishin hapur gjatë ledheve dhe kishin hequr armët nga supet. Mbi një kokojkë valavitte palat e rënda flamuri që dominonte mbi atë masë të murrme njerëzish.

Saliu zbriti nga muri e nisi të ngjite shkallët e çar-dhakut, kurse Bazja e kish varur kokën e rrumbullakët në gjoks. Faqet e kuqe i qenë bërë rrema-rrema dhe të

dukej se atë njeri tani e mbante në këmbë parmaku i brejtur nga krimbi, pas të cilit kishte mbërthyer pëllëmbët e trasha.

— Nuk na dhe një mendje — ju drejtua Qaniut, pa i ngritur sytë fare nga ai.

— Nuk është dita e gostisë sonë kjo, o Baze! Gostia duhej të ishte bërë në Përroin e Ngushtë, ku ishin katërqind pushkët tona dhe dymijë pushkët e gjermanit — tha Qaniu që tani qe bërë i verdhë si meit.

Bazja e lëshoi kokën mbi gjoks. Ai ngjante si një copë mishi pa gjak e pa nerva. Sytë e vegjël i kishin humbur fare.

— Të mos e bëjmë bam fare? — tha.

— Nuk kemi ç'fitojmë nga kjo. Ata... — tha në mënyrë të paqartë Qaniu dhe tregoi me kokë nga rrëpirat me borë. Atje masa e murrme dhe e heshtur e partizanëve qe shpërndarë në një vijë të gjatë të zhdërvjellët dhe armët i mbante në dorë.

Bazja, duke u përpjekur ta mposhte dridhmën e përgjithshme të trupit, ngriti kokën e pa përpara. Me këtë vështrim sikur desh të gjente tek ajo masë partizanësh atë diçka që e trembte dhe e dridhëronte ashtu. Po çfarë kanë ata, sikur pyeste veten ai, çfarë kanë që ne në pozicione, kurse ata na zbojnë si një qen nga rruga?..

— Koha po mbushet — tha Qaniu.

Komandanti u kthye me fytyrë nga ai dhe e vështroi disa çaste. Një hop më vonë pa pozicionet e njerëzve të vet që dukeshin sikur ishin të zbrazëta. Bazja kërrusi shpatullat dhe zbriti shkallët ngadalë.

U dha urdhëri që të tërhiqeshin në ca ara të ngushta që shtriheshin në rrëzën e një kodre të vogël. Tytat e zezë të armëve u hoqën pas frengjive e pas mureve dhe nëpër borë tani dukeshin vargje të çrregullta njerëzish që shkonin drejt arave.

Kolona partizane nisi marshimin. Vargu i gjatë i saj nisi të zbriste gjatë shtigjeve dhe pastaj hyri përmes rrugës së fshatit që të çonte në shkallë. Kjo shkallë, i vetmi kallim në atë kurorë malesh, ngjitej thikë nëpër shkrepë të thepsura. Dëgjohej zhurma e pandërprerë e hapave që

kalonin e kalonin, duke ngjeshur shtratin e bardhë të borës zhap e zhup, Ky ishte një marshim i shpejtë, diku shkonte kjo brigadë me atë ecje të rrufeshme përmes dimrit.

Bazja nuk mund të shihte asgjë. Ai qe bërë i lig sikur ta kishin zënë ethet dhe qëndronte i shtrirë përmbys mbi kapotën e shtruar në një rrasë guri. Festen e zezë e kish-te ulur gjer mbi vetullat e trasha dhe pëllëmbët i kish-te çuar pranë veshëve, sikur desh t'i mbyllte për të mos dëgjuar se ç'bëhej përreth.

Dhe ja më në fund hapat u larguan e u larguan, gjer-sa nuk u dëgjuan më. Bazes tani i ngjante sikur qe shurdhuar. Ajo heshtje e rëndë e dërmonte me një peshë të çuditshme.

— Më shtini një herë te veshi që të them se jemi gjallë. — tha ai, duke qëndruar përmbys e si i ngrirë — më shtini një herë afër veshit.

Po asnjëri nuk lëvizi nga ky urdhër i çuditshëm. Atëhere Bazja u çua, eci me ata hapa të shkurtër drejt mitralozave dhe mori dy prej tyre dhe i vuri pranë e pranë.

— Sefer! — thirri Bazja. — Këtu je?

— Këtu — tha Seferi dhe u ngrit.

— Po Alushin ku 'e kam? Hajdeni, hajdeni!

Pranë Bazes shkuan dy mitralierët, i pari një gërda-lle e gjatë me një shprehje habie në fytyrë, i dyti i shkurtër e i trashë. Bazja i vuri ata pranë mitralozave, u shtri vetë midis grykave të tyre dhe u tha:

— Më shtini afër veshit që të them se jemi gjallë!

Të dy mitralozat zbrazën nga një shirit njëherësh dhe tej, në arat e mbuluara me borë, u tremb një tufë sorrash që u ngritën me krakarimë dhe fluturuan tutje, gjatë brigjeve të një përroi të ngrirë, ku ngriheshin dush-qe të reja si tym bojë hiri.

NJË NDODHI

Udhëtoja me tren. Në vagon kishte pak udhëtarë. Shëtita kabinat e në njëren pashë një burrë me tëmtha të thinjur, me ca sy të butë e dashmirës. Burri dukej natyrë e heshtur, i kredhur në mendimet e veta, po, kur hyra unë, më buzëqeshi e më ftoi të ulesha aty.

— Pak njerëz sot — i thashë.

— Tani s'levizin shumë — tha ai e më zgjati një cigare.

Pastaj treni u nis.

Para kabinës sonë ndaloi një burrë nja dyzet e pesë vjeç, që mbante për krahu një grua të re me flokë të errët e me fytyrë të zbetë. Duket se kërkonin një kabinë bosh, sepse, si na panë ne aty, rrëshqitën pas xhamave e shkuan më tej.

Shokut tim të rrugës ju end nëpër buzë një nënqeshje e hollë.

Pimë cigaret në heshtje.

— Hele, hele. — tha pastaj papritur e pakujtuar ai — nëse je 40 apo 45 vjeç, pse duhet të marrësh një grua 20-22 vjeç?

— Po edhe qëllon — thashë unë.

— Edhe qëllon... — përsëriti ai.

Si e bloi mirë e mirë këtë këtë frazë nëpër mendje, u kthye përsëri nga unë e tha:

— Po, xhanëm, edhe qëllon.

U mbështet pranë dritares dhe shkundi hirin e cigares, ndërsa buzëqeshte lehtë. Dukej se e ngacmonte diçka që desh të tregonte. Dhe me të vërtetë fjala solli fjalën e më në fund nisi të më tregonte një histori.

— S'ka katër-pesë vjet — ja nisi — që ndodhi diçka që bëri shumë përshtypje. Isha mësues në një qytet të vogël. Në atë kohë na u fejuua një kolegu ynë, një burrë 40 apo 45 vjeç, me një vajzë fare të re.

Kolegun tonë e quanin Fatri, një njeri që, siç i thonë një fjale, nuk hahej as me limon. Ka ca njerëz që të ndjellin në mënyrë të vetëvetishme t'u shfrysh një zemërim, por as shkaku e zemërimit s'e përcakton dot, as rast s'të japin të bësh një gjë të tillë. Ja, i këtij kallëpi qe dhe ai.

Këtë njeri ish e pamundur të mos e gjeje mëngjez për mëngjez në shkollë, sado herët që të ngriheshe e të shkoje atje. Edhe kur binte shi a bënte ftohtë, edhe kur kish grip a nishin pushimet e dimrit, prapëseprapë ai ndodhej atje, i përhershëm dhe i heshtur, gjithmonë i kërrusur mbi fletoret e nxënësve me një laps të trashë në dorë e gjithmonë në një kënd të këshillit pedagogjik.

Po nuk mund ta merrje zët për këtë, jo, kurrsesi. Zët ne e patëm marrë sepse ai bënte një jetë pothuaj të çuditshme, rrojtje njerëzish bosh, thuaj, jo jetë. Pasioni i tij i vetëm ishin bletët dhe në dy dhomat, ku banonte bashkë me të ëmën plakë, kishte lloj-lloj vjetërsirash e dërrasa kosherësh, lloj-lloj qypash bosh apo me mjaltë, absolutisht asnjë libër, me përjashtim të një manuali që bënte fjalë për bletët. Ndizte vazhdimisht dhe sa për të ngrënë darkë vetëm një dritë që të kursente, nuk ulej kurrë me njeri për të pirë një kafe a për të shkëmbyer dy fjalë dhe kishte pothuaj një dyshim të përhershëm se mos i hynte ndokush në shtëpi dhe e vidhte.

Ja, një njeri i tillë na u fejuua me një vajzë të re dhe të bukur. Si e qysh kishin rrjedhur punët, asnjëri s'dinte të thoshte. Vajza punonte në ndërmarrjen leshpunuese. Qe vajzë e mirë dhe e zgjuar, po njerëzit e shtëpisë i kishin fanatikë të prapë e të mykur. Duket që Fatriu e kishte luajtur mirë politikën me të atin e vajzës.

Si kaluan ca kohë, i doli era kësaj pune. Thoshin se vajza nuk e donte, që s'shkonin mirë me njëri-tjetrin (dhe si do të shkonin mirë) e tjera e tjera, po të gjitha këtyre s'di se qysh ju vu kapaku dhe punët ranë në hesh-tje. Duket që ja mblodhën keq vajzës dhe ajo nuk guxoi të bënte më zë.

Po a e dini që sikur u mësua me këtë fejesë? Qemë ngopur së çudituri, a pse punët patën rënë në hesh-tje, s'di si ndodhi po ne, si të thuash, qemë mësuar me të. Bi-le erdhi një kohë që unë sikur i mbaja një lloj anësie. Për t'u çuditur është! Kjo mbase vjen ngaqë s'duam të plasim sherre e skandale, pa çka se këto sherre bëhen për të mirë e jo për të keq.

Në qytetin tonë na erdhi një mësues i ri, një djalë nja 23 vjeç, njeri i heshtur e i turpshëm mund të thoshe. Adnan e quanin, po e thërrisnin Nani. Ai kish një zemër të bardhë dhe të pastër, skuqej si vajzë kur bisedonte me dikë dhe s'ish e mundur të dëgjohej të zihej me njeri. Dhe kish ca huqe të vetat ai. Qëllonte në ditë pushimi që mbyl-lej gjithë ditën në dhomën e vet e atje shkruante e har-tonte vjersha, lexonte a korrigjonte dhe, kur dilte që an-dej, ish i menduar e i verdhë, i ligur e i hequr sikur të ki-shte kaluar ndonjë sëmundje. Po kish dhe raste, në këto ditë pushimi, që humbiste e s'e gjeje dot as në shtëpi e as në qytet. Shkonte në një ekspeditë gjeologjike, bridhte an-dej sondë më sondë me punëtorët e veç kur dukej në mbrëmje vonë tek kthehej i lodhur e i përbaltur, por i gëzuar e plot gjallëri.

Dhe ja, ky mësues shkoi e na ra në dashuri me të fejuarën e Fatriut, Fatimen. Një javë pasi pat ardhur në qytetin tonë e pat parë atë, një ditë tjetër e kish ndalur dhe kështu kish nisur dashuria midis tyre. Po, që ta dinte se ajo ish e fejuara e Fatriut, këtë s'e dinte. Ishte në fi-llim dhe vajza, me sa duket, nuk i kish thënë gjë.

Në një nga këto ditë që punët po ngatërroheshin kë-shtu, mua më qëlloi të shkoja në shtëpinë e tij. E gjeta shtrirë në krevat tek po lexonte diçka dhe librat i kish rrëmujë nëpër dhomë: ca mbi tryezë, ca mbi krevat e ca në dysheme. U çua duke buzëqeshur e më tha:

— Ah, ah! Lëre se si më gjete.

— Nisi të mblidhte librat dhe vija re se qe skuqur e duart i dridheshin lehtë.

Pastaj zumë vend përballë njëri-tjetrit dhe ai më vështroi drejt dhe më tha:

— Bëre mirë që erdhe. Dua të të pyes për diçka.

U mendua pak dhe vazhdoi:

Ne, shtëpitë e qytetit tonë të vogël, i njihnim me çesmës?

Ne, shtëpitë e qytetit tonë të vogël, i njihnim me gisht, kështu që e mora vesh menjëherë se për kë bënte fjalë.

— Mos është një me flokë të zez? — e pyeta.

— Po, — tha — me flokët të zez.

Unë qesha me djallëzi.

— Nuk është e lirë, mjerisht — i thashë. — Është e fejuara e Patriut.

Po unë sikur ja paskësja ngulur me gjemb murrizi. Kërceu nga vendi me bebe të hapura, u zbeh e u zbeh sa të futte llahtarën dhe, pa dashur ta besonte, tha:

— A e di mirë se për cilën të them?!

— E di — i thashë. — Tek ajo shtëpi, vajzë, vetëm e fejuara e Patriut është, një me flokë të zez, pak e zbetë.

Ai u ul prapë, balli i qe rrudhur nga brenga e nga zemërimi dhe tha:

— Patriu është fejuar me të?!

— Po — i thashë unë. — S'ka nja tre-katër muaj.

— S'është e mundur — tha ai me vete. — Nuk është e mundur.

Zuri kokën me duar e mendohej e mendohej, ndër-sa diç i gurgullonte thellë në gjoks. Pastaj më kapi dorën, më vështroi në sy e tha:

— Ai mësuesi ynë, ë?

— Po ai.

Në këtë çast, papritur e pakujtuar, i dha kokës me vrull prapa dhe ja krisi një të qeshure ga, ga, ga, sa të thoshe se luajti nga mendtë. Shpatullat i lëkundeshin fort, kaq me hov dhe me maraz qeshte. Pastaj u bë i

zymtë, i zymtë e mua pothuaj më harroi fare se isha aty. Qe mbështetur pas krevatit, balli i qe mbushur plot rru-dha dhe vështronte diku me sy të humbur në ëndërrim.

— Këtu ka shumë egërsi — tha. — Ka shumë egërsi gjersa arrijnë njerëzit të fejojnë një vajzë si ajo me një njeri si Patriu.

Unë edhe po e merrja edhe s'po e merrja vesh ashtu si duhet.

— Pse, si e ke hallin? — e pyeta.

Po atë ditë nuk më tregoi gjë. Rrinte i heshtur e mendohej, duke u zbehur e duke u vrejtur herë pas here.

Pas ca ditësh e mësova të vërtetën. Të them të drejtën kjo qe për mua, si i thonë një fjale, rrufe në qiell të kaltër. Ku kishte vajtur dhe ish ngatërruar! Ata të vajzës qenë njerëz fanatikë, Patriu po Patri, prit skandalin tani, mendova. Dhe e doja atë djalë, prandaj më vinte keq t'u hynte ngatërresave.

— Shiko! — i thashë. — A s'e lë këtë muhabet? Kemi vajza plot ne, do të gjejmë një për ty.

Por ai e di se ç'më bëri? Më shikoi e më shikoi me keqardhje të dukshme, buzëqeshi hidhur dhe më ktheu krahët. Atëhere e kuptova se kisha bërë një budallallëk. Ai e donte shumë atë vajzë, edhe ajo gjithashtu e donte shumë, kurse unë i thosha se kemi vajza të tjera!

Ta kisha fjalën, që unë i mbaja një lloj anësie kësaj fejese. Kështu qe, përderisa e këshilloja të hiqte dorë. Me fjalë të tjera i thosha lëre atë, u bë si u bë puna e saj, ajo tani është e fejuar.

Por ai nuk ishte nga ata që neqin dorë kollaj. Dhe ja, pas ca kohësh, ishte fund tremujori atëhere, ne vendosëm të bënim një mbrëmje të trupit arësimor të shkollës. Erdhi dhe Patriu në këtë mbrëmje e habia jonë më e madhe qe se ai për herë të parë solli dhe të fejuarën me vete, Fatimen. Gjatë tre-katër muajve të fejesës ne i patëm parë a s'i patëm parë nja dy herë bashkë, kurse në shkollë as që na shkante ndër mend se mund ta sillte. Po, siç duket, këtë e bëri për t'u mbyllur gojën disave që thoshin se Patriu ish njeri i mykur e fanatik.

Pra e solli në mbrëmje.

Unë dhe Nani qemë ulur në një qoshe dhe, të them të drejtën, i druhesha ca këtij djali që rrëmbehej shpejt. Fytyra i qe bërë pulla-pulla nga një tronditje që s'e përmbante dot. Gotat e rakisë i hidhte njerën pas tjetrës dhe qëndronte kokëvarur dhe i zymtë, duke gërryer mbulesën e tryezës me gishtërinjtë që i dridheshin.

Atje përballë dukej Fatimja, e emocionuar dhe e tronditur edhe ajo. Çiftet ngriheshin e uleshin, po Fatriu nuk luante nga vendi; rrinte hijerëndë e si i përkorur pranë saj.

S'di sa kohë kishte kaluar kështu, kur Nanit i tha mendja të ngrihej e të merrte Fatimen për të kërcyer. Më ra lehtë me bërryl e, i skuqur e i tronditur, më tha:

— Liroma pak vendin, të lutem!

Shkoi drejt e të Fatimja dhe e ftoi në vallëzim.

Po Fatriu u err, u zymtua dhe i tha:

— Nuk e di, nuk e di dancin kjo.

Fatimja qe ngritur në këmbë, shikonte e hutuar herë nga Nani e herë nga i fejuari dhe s'dinte ç'të bënte.

— Shkoni ju lutem, shkoni tani! — i tha Fatriu, duke u ngërdheshur ca.

Mua më kaluan mornica nëpër trup. Ishte i ndjeshëm dhe me zemër të zjarrtë ai djalë, s'duronte dot gjëra të tilla dhe mendova se diç do të bënte. Por e mbajti veten qerratai dhe u kthye e erdhi në vend, flakë i kuq në fytyrë. Sytë i shkëlqenin e kafshonte buzët për të përmbajtur një gufim që i dilte nga gryka. Dhe Fatimja qe skuqur, balli i qe rrudhur lehtë e në vështrimin e saj sikur ndrishte një yll i egër; me sa dukej qe zgjuar tek ajo guximi dhe vetëdija e gjendjes ku ndodhej.

Nani mori gotën me duart që i dridheshin dhe më tha:

— Gëzuar!

Pastaj u kthye nga tryeza ku ishte Fatriu e disa të tjerë.

— Gëzuar! — u thirri atyre. — Gëzuar, mësues! — i tha Fatriut dhe e rrëkëlleu me fund.

Por Fatriu, i murrëm e i vrerët, nuk e ngau gotën me dorë.

— As një gotë s'po pi me mua? — i tha Nani.

Fatriu u ngërdhesh e tha:

— Rri tani, rri! Ke pirë shumë alkool.

— Alkool?!

Nanit i shpërtheu gazi nga gryka ga, ga, ga. Shumë-kush ktheu kokën nga ai, kurse Fatriut iu thelluan dhe më shumë gropat e faqeve.

— Më fal pra, më fal — tha Nani dhe u ul.

Kurse Fatriu, si ndenji edhe ca, gjeti rastin teksa bëhej një lojë, mori Fatimen dhe u ngrit e iku.

Të nesërmen, kur erdhi në shkollë, Nani ishte i zbetë si meiti dhe sikur i vinte turp të ngrinte kokë. Hyri në sallën e mësuesve me sytë përdhe e Fatriu e pa vëngër e si me inat. Po ai u ul në një qoshe, hapi një fletore dhe nisi të shkruante.

Në drekë e kapa dhe i thashë:

— Mbrëmë sikur e shkele ca. Fatriu të është zemëruar.

Ai buzëqeshi një grimë si i pikëlluar.

— Më tha të të them që herë tjetër të jesh më i matur.

— Po, — ja bëri ai — ka të drejtë. Vërtet e shkelëm ca.

«Si u zbut kështu menjëherë ky njeri?» mendova unë. Nani ecte krah meje i menduar e i heshtur. «Dhe mbrëmë po kështu, uli kokën para Fatriut dhe i kërkoi ndjesë».

— Ka s'ka të drejtë, tani kështu u bë kjo punë — vazhdova unë.

— Jo, ka të drejtë — nguli këmbë ai.

«Po si i jep të drejtë?!» mundohesha ta merrja me mend.

S'e hapi gojën më derisa kishim arritur afër shtëpisë së tij. Po aty ndali, më kapi dorën me dy gishtërinjtë e më tha:

— Dëgjo! Mua mund të më quajnë dhe egoist, po le ta lëmë punën time njëherë. Po Fatriu, xhanëm, ç'bën ky Fatriu, ë?

Fytyra i qe zverdhur dhe gishtërinjtë i dridheshin. Ngriti sytë e vazhdoi:

— Ja, ka shfrytëzuar mykun e njerëzve të një familjeje, injorancën e tyre, ka shfrytëzuar mosguximin e një vajze për të mbrojtur dashurinë e vet dhe tani...

Pështyu me përbuzje e gati briti me damarë të fryrë:

— Tani do që t'i bëjë një kafaz të hekurt kësaj «lumturie». Dhe nuk na qenka ky egoizëm, bile i tërbuar. Dhe nuk na qenka kjo egërsi, bile e tmerrshme... Po megjithatë, mbrëmë, unë nuk kisha të drejtë. Dhe a e di pse?

Mblodha supet.

— Sepse i fejuari është ai. Dhe mua më takon të bëj diçka tjetër më përpara. Atëhere mund të jemi në rregull. Kurse kështu jo.

E shikoja me vëmendje dhe nuk e merrja vesh. Dhe ai nuk ma shkoqiti më tej s'e ç'desh të thoshte.

Pas pesë-gjashtë ditësh më ftoi t'i shkoja në shtëpi.

Atë natë vjeshte të vonë frynte një erë e tërbuar që i shkundi të gjitha gjethet e fundit dhe shiu përplasej me zhurmë nëpër çatira e rrugë. E gjeta pranë zjarrit me xhaketën hedhur kraheve e këmbëzbathur. Qe ulur në një fron të vogël dhe diç po lexonte.

— A më të lumtë! — i thashë. — Ma gjete kohën kur të më ftosh.

Ai buzëqeshi, më hoqi pallton, më dha një palë çorape të thata e më tërhoqi pranë zjarrit.

— Do një konjak? — më tha. — Ti qenke bërë xurxull.

— As për konjak, as për djall nuk jam, — i thashë — po lëmë të thahem një herë.

U afrova pranë zjarrit, kurse ai hapi prapë librin e nisi të lexonte. Si qeshë tharë mirë e mirë, kthehet e më thotë:

— Edj ç'të desha? Sonte do të marr Fatimen... Po munde, eja me mua. Ka ca plaçka ajo.

— Lëri shakatë — qesha nga zori unë e s'mundja ta shikoja drejt.

— Nuk bëj shaka — ma ktheu qetë e qetë. — E kam me gjithë mend.

— Me gjithë mend?

Të thashë, nuk po bëj shaka. Ja edhe pak e do të nisemi.

Atëhere u nxeha e u tremba, kush e merr vesh, po di që u ngrita ashtu siç isha dhe klitha:

— Ti je i çmendur, more djalë! M'u hiq qafe!

Dhe vajta të vesh pallton.

— M'u hiq qafe! — thirra prapë unë, më tepër për të mposhtur tronditjen time se sa për të përmendur atë. — S'ja kemi ngenë t'u futemi telasheve e të bëhemi gazi i botës.

Aj kishte zgurdulluar sytë dhe më shikonte me habi. Mua më dridheshin duart dhe s'e gjeja dot mëngën që të futja krahun. E, kur më pa në atë gjendje, i dha kokës përnjëherësh prapa, ngriti krahët e ja krisi atij gazit të tij të famshëm. Qeshte e qeshte, sa lotë i dilnin nga sytë.

— Po ja mbath, ë? Ga, ga, ga... Hele, hele, sikur të të thoshin: Shpëtoje një njeri që mbytet, a do ta bëje këtë? Apo do të ktheje kurrizin nga frika se mos të thoshin se e ke hedhur ti në lumë, ë? Ga, ga, ga...

— Të lutem mos më hingëlli kështu mua! — ja ktheva vërtet shumë i zemëruar. — Ç'ka këtu për të qeshur?!

Por ai u ul në cepin e krevatit, fytyra ju brengos përnjëherësh e më tha me zë të butë:

— Më fal, unë... ashtu kot. Ik, ik e mos ma merr për të keq.

Po pse, a më ikej mua ashtu? Se ç'kishte ai djalë që të çarmatoste përnjëherësh. Vërtet që qeshë trembur e po ja mbathja. Kurse ai kishte nevojë për ndihmën time, për fjalën time. Të them të drejtën, nisi të më vinte turp që pata kërcyer ashtu për të ikur.

— Je çilimi — shfryva gjysmë i zbutur, gjysmë i penduar.

Hoqa pallton dhe u ula pranë zjarrit.

— Mua s'më kanë pëlqyer kurrë këto gjëra. — tha-

shë. — Ka rrugë të tjera që kjo punë të bëhet mirë e më mirë.

Po ai, thua se s'më dëgjonte fare, u ngrit, shkoi te doli e nisi të rregullonte diçka atje brenda.

— Po, xhanëm, ti as do që të dëgjosh se çfarë të thonë të tjerët — po zemërohesh unë.

Ai u kthye nga unë e më tha me zë të butë e plot seriozitet:

— Nuk është fjala se s'të dëgjoj. Por nuk bëhet ndryshe. Njerëzit e saj nuk duan ta prishin fejesën që kanë bërë, ajo e ka vështirë t'i bindë ata, ti e di. Çfarë të bëj unë?

— Po skandali? — pyeta unë.

— Po pse skandali, xhanëm, pse skandali? — u nxeh përnjëherësh ai. — Të ndrydhësh dashurinë për hir të një fejeje të padrejtë nuk qenka skandal, kurse të mbrosh dashurinë tënde qenka skandal!

... Në orën njëmbëdhjetë shkua dhe morëm Fatimen. I kisha hyrë mirë kësaj pune tani dhe s'mund ta lija Nanin vetëm. «Fundi dhe në bëhet kështu, bëhet për të mirë» mendoja.

E sollëm vajzën në shtëpi dhe ajo, e trembur dhe e shqetësuar, u ul në një qoshe të krevatit. Hera-herë shikonte nga Nani dhe buzëqeshte pak, duke u skuqur lehtë.

— Hë? — ja bënte ai. — Pak guxim qenka dashur, ë?

Ajo rrudhte ballin, diç i thoshte me lëvizje buzësh që të mos dëgjoja unë e pastaj seç bënte ca gjeste të bukura ku gërshetohej gëzim dhe shqetësim.

Në orën tre pas mesnate. Nani u nis me një «skodë» dhe e çoi Fatimen te njerëzit e vet. Më tha që t'i thosha drejtorit t'ja zëvendësonte orët për nja dy ditë, gjersa të kthehej. Unë shkova në shtëpi dhe as që mbylla dot sy gjersa u gdhi. Mendoja se si do t'i vinte filli kësaj pune.

Të nesërmen në mëngjez shkova dhe ja thashë sekretarit të partisë, në shkollë. Atij i erdhi fare e papritur dhe me sa pashë, nuk i bëri përshtypje të mirë. Mendohej dhe i binte tryezës me majat e gishtërinjve.

— Duheshin — i thashë unë — dhe këtë e bënë për hir të dashurisë.

Ai mbështeti mjekrën në dorë dhe më shikoi drejt.
— Fundi i fundit mirë bënë — vazhdoi ai. — Nuk ishte e drejtë ajo fejesë. Po dhe kështu... Ndryshe mund ta bënin.

— S'kishin si t'ja bënin ndryshe — thashë unë.

— Pse s'kishin si t'ja bënin ndryshe?

— Po ti e di se çfarë njerëzish ka ajo në shtëpi.

Ai ngriti prapë sytë dhe më shikoi.

— Të shtëpisë së saj vërtet janë fanatikë, po ajo që është e reja, ai që është i riu, ne të gjithë, do t'i bindnim më në fund. Eh, po pse kështu, ta marrë e mira, ë?

Po në fund të fundit e drejta ish me ta. Po ata të vajzës qenë njerëz të mykur e të shihje si morën zjarr dhe u tërbuan. «Do t'më njohë se kush jam», shfrynte i ati i Fatimes, një njeri fanatik e kokëshkretë. «Është njeri i poshtër, — dridhej nga inati e shfrynte Patriu. I mori mendjen asaj budallaqeje. Imoral, njeri i degjeneruar. Ai do syrgjynosur, jo ta mbash mësues».

Zien e zien këto fjalë qosheve, po më në fund u mbyllën. Prisinin të kthehej Nani, thoshin se do ta marrë vesh që për atë që bëri, po edhe Nani u kthye dhe e di se ç'ndodhi? Nuk guxoi njeri t'i thoshte një fjalë të keqe. Vetëm i ati i vajzës sëç u grind një natë me të, po edhe ai e mbylli gojën. Kështu është, kur s'ke të drejtë, s'ke dhe gojë të flasësh. Kurse Nani. . . eh, qe një djalë i mrekullueshëm ai. Unë e kam dashur shumë atë njeri dhe sa herë që e bie rasti, më pëlqen të tregoj diçka për të.

Në kabinë ishte bërë shumë tym dhe ne hapëm derën. Në korridor qëndronte një djalë i ri, me ballë të mbështetur pas xhamit. Matanë xhamit rendnin arat dhe kodrat nën raketakun e vrullshëm të trenit.

DUKE DALË NGA NJË NATË E GJATË

Suta nuk i çonte më dhitë nga Kilbi, nga ai mali i zymtë e gjithë shkurre që mbyllte luginën nga ana e perëndimit. Diçka e re qe dukur në ato anë dhe kjo lidhej me pranverën e atij viti, kur në faqen e një kodre përballë Kilbit hapën një rrugë e nisën të ndërtonin një uzinë. Tani luginës i qe shtuar një qytet i ri i vogël me ndërtesa të kuqe, që mbrëmjeve vezullonte nga mijëra pikëza të florinjta. Ky qytet i bukur e i ri qëndronte si një fener i madh mbi luginën e ngushtë, ku rridhnin ujërat e lumit. Prandaj dhe s'i çonte më dhitë nga Kilbi, po i zbrishte poshtë, andej afër asaj kodrës ku lëvrinin maqinat. Kjo i pëlqente shumë Sutës. I pëlqente të dëgjonte nga afër uturimën e motorëve e të shikonte çatitë e kuqe që shkëlqenin atje lart. Po ishte e drojtur ajo e asnjëherë s'qe ngjitur gjer në rrugë. Hipte në ndonjë dru, mbështette mjekrën në sup dhe shikonte atë lëvizje të pakuptueshme që gumëzhinte atje tej. Pranvera harlisej me mjegulla e erëra të ngrohta e mbi fletët e kalbura të dimrit që shkoi nxirrte krye bari i ri. Drurët gjethtësonin, bajamet e lulëzuara pranë shtëpive dukeshin si balona të bardha, dhe Suta mërzhitej që baca sillej ashtu me të. Atë pranverë shoqet e saj qenë nisur për në hekurudhë, po baca i gënjeu ata të rinisë duke u thënë se ajo ishte e sëmurë. Sa i egër që ishte baca! Nëna atë e kishte frikë, motrat

e mëdha gjithashtu e kishin frikë. Dhe Suta e kishte frikë, prandaj s'e hapi gojën kur ai i gënjeu shokët e rinisë. Baca dhe në kuvendin e burrave tha se e prishte fejesën e saj me Selmanin, por Selmani prapë vinte në shtëpinë e saj e diç kurdiste. Dhe shkollën mezi e kreu nga baca...

Kur i çonte të gjitha këto në mendje, Suta niste e qante me vete. Rija i shkruante një letër nga aksioni. Dhe Suta i pat shkruar asaj një letër, bile i thoshte se qante. Rija i thoshte se ajo nuk duhet të qante, por të luftonte si burrëreshë. Bile ajo i shkruante se do t'ja rregullonin mirë atij bacës së saj që sillej ashtu me të, po Suta nxitoi e i shkroi një letër tjetër ku i lutej të mos ja hapnin këtë muhabet bacës, se ai ishte i egër dhe mund...

Rija në letrën tjetër i fliste shumë ashpër që ajo ishte e përlur. Ajo i thoshte se asnjëri s'duhej ta merrte nëpër këmbë jetën e saj, se për këtë kishte lajmëruar dhe shokun Sadik. («Prandaj shoku Sadik erdhi një ditë në shtëpi! E diç bisedoi me bacën», çoi në mend Suta). Me këto mendime harrohej gjithë ditën e, kur binte muzgu e i duhej të kthehej në shtëpi, e kapte një trishtim i pakuptueshëm e këmbët mezi i hidhte nëpër monopat. Po dhitë budallaçka rendnin për në haurin e tyre e Sutës i duhej t'i ndiqte. Herë-herë kthente kokën prapa dhe shikonte se si ndizeshin me radhë dritat e bukura në qytetin e ri mbi kodër, ku dikur ishte një pyll me shkurre.

Në shtëpi e prisnin punët e dorës, endjet, qëndisjet, trikot. Nëna i thoshte se po i afrohej dita. Selmani vinte prapë në shtëpinë e tyre. Herë-herë zëri i tij dëgjohej që thërriste nga porta, herë nga muri e herë prapa kopshtit, gjithmonë natën. Kurse Sutës i rrëqetheshin mishrat. Më parë mbase një 18 vjeçareje si ajo s'do t'i bënte shumë përshtypje ky zë i të fejuarit që vinte e thërriste në shtëpinë e saj. Zakoni kështu e ka dashur gjithmonë. S'kish pse e kundërshtonte vajza fatin. Po tani, mbas gjithë këtyre që po ndodhnin në malësi, Sutës nisën t'i rrëqetheshin mishrat. Baca vërtet kishte thënë se ja prishte fejesën me Selmanin, po pastaj kishte hapur fjalë se s'kish si t'ja bënte së bijës, mbasi ajo vetë e donte atë.

«E dua?!»

Sytë e Sutës nguleshin diku dhe ajo qeshte me hidhërim. Si mund ta donte ajo Selmanin. Që kur ish e vogël e nisi të mësojë për fejesën, ajo sepse i trembej hijes së këtij njeriu. Ai, si një bar i keq, erdhi e u përzje në ëndrrat e bardha dhe dalëngadalë ja mbulonte ato me një hije të rëndë dhe të errët. Kurse baca thoshte se s'kish si t'ja bënte së bijës. Dhe një ditë ja, do të merrte rrugët e përbaltura pas karvanit të krushqve e do të shkonte tek ai. Sutës i bëhej se në ditën e martesës së saj binte shi mbi gjerdhet e lagura, kurse ajo qante në heshtje duke shkuar drejt një kulle të errët dhe të frikshme. Dhe i rrëqetheshin mishrat tani që po ndodhnin kaq e kaq gjëra në malësi e i hapnin sytë asaj për të parë se ç'gjë e egër dhe e ashpër ishte kjo martesë.

Rija i shkruante pikërisht kështu nga aksioni, se kjo martesë ish një gjë e egër dhe e ashpër. Kurse vajza duhet të bëhet vetë zot i fatit të saj. Ajo duhet të martohet me një njeri që e do. Ç'kuptim ka jeta të shitesh e të bliesh si një kafshë? Po, megjithëse tani po vinte vera, Rija dhe shoqet e tjera të fshatit ende s'po ktheheshin nga hekurudha, kurse Suta kish kaq shumë nevojë tani për to. Turni i tyre donte edhe dy javë që të mbaronte.

Në ditët që rrinte në pyll me dhitë Suta nisi të presë diçka. Si e dalë nga një gjumë i rëndë asaj i bëhej sikur qe zgjuar papritmas e sytë ja ngulte monopatin se mos vinte Ai. Kush ishte ai? Jo, ai s'kish të bënte fare me Selmanin. Ai ish një njeri që ajo e donte. Dhe ai e donte. Mbase ja, do të dilte tek ajo ngastra e vogël me li, do të ecte përmes luleve të kaltëra të lirit që dallgëzoheshin nga era e do të vinte drejt saj. Ajo e ndjen zemrën t'i përpëlitet në gjoks, gjaku i vërshon në fytyrë, skuqet e turpërohet, po megjithatë është kaq e lumtur, kaq e lumtur... Ai ecën nëpër lulet e lirit, flutura të bardha tremben nga hapat e tij e ngrihen fluturim, kurse asaj i vjen të qajë me zemrën të mbushur plot nga gëzimi.

Po në monopatin nuk duket të vijë njeri. Rreth e rreth endet ajri i freskët i pyllit, diku ligjërojnë gjinkallat, në zabel dëgjohe zilet e dhive. Suta ul kokën mbi trikon

që punon dhe tani prapë i fanitet Selmani me atë pamje të egër e të neveritshme. Po ajo tani kërkon me ngulm ta shporrë nga përfytyrimi këtë njeri që i fanitet herë pas here. Hija e tij bie si një njollë e errët mbi një lëndinëz të gjelbër ku buis jeta nën rrezet e diellit.

Dhe ja një ditë....

Ishte kohë dreke. Mbi lumë që ndehur një tym zabulime. Asgjëkundi s'ndihej grimë ere e gjethet e drurëve qenë varur e qenë rreshkur. Aty poshtë ujërat e lumit mezi rridhnin e pasqyronin barishtet e dendura që harliseshin në breg. Herë-herë Suta zgjatte kokën mbi ujë e shikonte fytyrën e vet me dy gërsheta të zinj që i vareshin përpara. (Është mosha kur njeriut i pëlqen ta shohë veten, buzëqeshjen e tij të çiltër që i ndrit fytyrën). Dhe Suta buzëqeshte me fytyrën e ëmbël e të bukur të vetes së vet, pasqyruar në ujë.

Tamam kështu e gjeti atë ditë një djalë që zbriste nga monopati i pyllit. Me pantallona në bojë të barit, me xhakëtën hedhur supeve, me një shami të lidhur në qafë ai zbriste duke vërshëllyer, ndërsa u binte gjetheve me fshikull majtas e djathtas. Në dorën tjetër mbante një torbë e mbi ballë i binin flokët e shpupuritur.

Suta që trembur. E shikoi vjedhurazi e diçka e fortë dhe e çuditshme i rrahu thellë në zemër. Djali e pa dhe mbajti hapat.

— Mirë dita! — i tha ai.

Suta uli kokën me një barrë turp dhe nuk mundi t'i përgjegjej. Kurrë s'i pat qëlluar kështu të fliste me një të panjohur dhe kjo e hutonte dhe e tronditte.

— Desha të di se nga i bihet më shkurt — tha djali duke treguar fshatin e saj. — Do t'ju sjellim dritat — dhe buzëqeshi.

Suta, e ndezur flakë, ngriti kokën dhe i tregoi me dorë një udhëz që niste në qoshen e pyllit, matanë lumit. Djali s'e zgjati më. Duke vërshëllyer, kapërceu lumin gur më gur, u hodh matanë e iku. Atëhere Suta, me dridhërimë në zemër, hipi shpejt e shpejt në një dru e nisi të vështronte si po zhdukej djali në shkurret e pyllit, në anën tjetër të lumit. Po ai ecte dhe as e ktheu kokën më,

kurse ajo e ndiqte me sy në heshtje dhe mendohej. As e kuptonte se ç'e shtynte ta shihte këtë djalë me xhaketë hedhur krahëve që kaloi rastësisht para saj. Të nesërmen prapë ai djalë zbriste nga pylli, prapë vinte drejt saj duke vërshëlyer. Këtë radhë Suta gati sa s'qe gëzuar kur e pa me xhaketën krahëve e me ca tesha në dorë. Kësaj radhe ai ish më i qeshur e më i gëzuar e që së largu vetëtinin flokët e tij të krehur bukur. Ajo as që e pat shpresuar se do ta shihte dhe një herë, kurse ai... ai ja tek po vinte me hap të lehtë e duke vërshëlyer.

Qe skuqur Suta, sa i vinte zor po ta shihte ai në atë gjendje e në buzë i qe endur një buzëqeshje e ëmbël dhe e drojtur. Djali ndali pranë saj dhe tha:

— Ah, ç'kam hequr dje në atë rrugë!

Ajo ngriti sytë ngadalë dhe e pa. Sa i mirë që ishte ai! Ç'vështrim i ëmbël dhe i butë buronte nga sytë e tij. Pa e kuptuar, ajo buzëqeshi lehtë.

Djali e yuri re këtë dhe u mendua një hop. Pastaj, me mollëza të skuqura, tha:

— S'ka rrugë tjetër?... Kam dhe këto plaçkat... Kam ardhur te ju vullnetar...

— I dilni këtej, — foli Suta për herë të parë me të e i tregoi rrugën në buzë të lumit, që humbte përmes rakitave — po këtej bie larg.

— S'ka gjë, — tha djali — mjaft që të jetë rrugë e mirë.

Diç tjetër desh të thoshte, po uli kokën e iku gjatë rrugës buzë lumit. Dhe, si qe larguar një copë në zallin e bardhë plot tufëza gjelbërimi, e ktheu kokën dhe një herë prapa dhe vështroi Sutën. Ajo e përcollti me sy gjersa ai humbi prapa brezit të errët të rakitave.

Kështu e njohu Suta Feritin, djalin që kish ardhur në fshatin e saj për të sjellë dritat. Në ato ditë erdhën edhe shumë vullnetarë të tjerë nga qyteti. Erdhën dhe shoqet nga aksioni. Fshati tani lëvrinte nga njerëzit. Në pyllin në rrëzë të Kilbit dëgjoheshin gjithë ditën sëpatat që prisnin dru për shtylla. Këto shtylla i merrnin në krah dhe i renditnin njërën pas tjetrës gjatë kodrës ku ishte ndërtuar uzina. Pastaj nisën të venë dhe telat që shkël-

qenin në diell si vija të bardha shtrirë në hapësirë. Rija dhe disa shoqe u grindën me bacën, po më në fund ja muarën Sutën që të punon në aksionin e fshatit për elektrifikimin. Tani Suta herë latonte drurët në pyll, herë çonte izolatorët pranë shtyllave e herë mbante tarka teli. Feritin e shihte ditë për ditë. Diçka e çuditshme ndodhte në zemrën e saj, që s'mund t'ja fshihte dot Feritit. Dhe ai kish kuptuar diçka nga ana e tij. Në fillim Feriti e vështronte me vëmendje, pastaj nisi të turbullohej kur shiheshin me njëri-tjetrin, pastaj filloi t'i afrohej e të bisedonte me të, ndërsa sytë i mbante në tokë e mollëzat e faqeve i skuqeshin. Pas një muaji ai i tha se e donte. Kjo ndodhi në një mëngjez. Suta solli izolatorët e i la në tokë, kurse ai zbriti nga shtylla e nisi të merrej me këta izolatorë pa e pasur mendjen aty. Të rinjtë e të rejat që punonin rreth e rreth ishin larg dhe Sutës nisi t'i luftonte zemra, sepse e ndjente se ai diç do t'i thoshte. Feriti kurrë s'kish qenë i tronditur, si atë mëngjez. Dhe ajo kurrë s'kish qenë aq e tronditur. Ajo as që e mban mend se çfarë fjalësh foli Feriti, po di që ai i tha se e donte, kurse ajo ndenji një hop të gjatë e heshtur duke luftuar me veten. Ai pastaj nisi t'i kërkonte asaj që t'i thoshte nëse e donte apo jo. Këtë ai ja përsëriti disa herë dhe ajo i tha më në fund përmes një lëmshi të madh që i qe mbledhur në grykë: «Po». Kjo ish një «po» e mekur, sikur trembej se mos e dëgjonte njeri, po ish aq e çiltër dhe aq e bukur. Kur ngriti sytë, Feritit i qe mbushur balli me djersë, ndërsa i buzëqeshte me sy të gëzuar. Ai mori izolatorët e u ngjiti në shtyllë, kurse ajo rendi përmes një are sikur të fluturonte. Era i bubullinte në vesh e i bëhej se kjo erëz sillte kundërmime lulesh. Kjo ish një ditë e bardhë, e bardhë për Sutën. Po, kur doli në krye të arës, e përzhati mendimi i Selmanit. Ky hynte në mesin e lumturisë së tyre si një natë e errët. «Mirë, more bacë, tha Suta me vete. Meqë ti s'e kupton se ç'do të thotë kjo për mua, atëhere unë s'do të bindem.»

Ky guxim që ndjeu në veten e saj e gëzoi. Për herë të parë në jetën e saj ajo e ndjente veten të fuqishme. Kjo fuqi i qe mbledhur dalëngadalë në vetëvete nga të

gjitha ato që ndodhnin në malësi. Dhe ajo s'do ta ulte kokën përpara dorës së egër të bacës e të Selmanit. Feriti i kishte thënë se e donte. As njëqind baca e as njëqind Selmanë s'mund ta ndalnin këtë dashuri.

Dhe erdhi një ditë e madhe për jetën e Sutës. Feriti i tha se do të vinte në shtëpi të saj për të biseduar me bacën, ai me dy shokë, me Rijen e disa vullnetare të tje-
ra. Baca që kthyer nga stalla e qeve e po rrinte në oborr.

— A doni miq? — thirri një zë nga avllia. Ky nuk ishte zëri i mekur i Selmanit, po një zë i qeshur që tingël-
llonte gjer tej.

— Hajde bujrum! — tha baca e u doli përpara.

Hyri Rija me shoqet, Feriti, shokët. Baca u jepte dorën me radhë e mendohej të merrte me mend se pse po vinin kaq shumë njerëz në atë mbrëmje. Erdhi pak më vonë dhe Sadiku e të gjithë hynë në kullë. U ulën rreth e rreth vatrës, ndërsa Sutës i luftonte zemra atje prapa derës.

— Na piqu kafe! — bubulloi zëri i bacës.

— A e dini, o baca Selim, pse të kanë ardhur këta miq? — tha Sadiku më në fund.

— Jo, besa! — tha baca. — Po ani, miq na pastë praku.

Dhe Sadiku nuk e zgjati.

— Kemi ardhur për të mirë, o baca Selim. Sutën duam ta fejojmë me këtë djalë — dhe preku me dorë Feritin.

Baca drejtoi trupin, vetullat ju ngrysën e nisi të shikonte herë Sadikun, herë Feritin.

— Ne e dimë fjalën që dhe në kuvend se e prishe fejesën e Sutës me Selmanin. Po vajzat tona nuk do të mbeten pa u martuar — e kapi ngushtë Sadiku.

Baca lëshoi një «poo» të gjatë dhe mbështeti bërry-
lat mbi gjunjë.

Ra heshtje e gjatë. Pastaj baca tha:

— E dhashë fjalën, more burra, po si me ja ba çikës. Ajo vetë e do Selmanin.

Suta u drodh atje prapa derës. «Ah, jo, bacë, mos gënje më», murmuriti me vete gati me inat.

— Jo, baca Selim, — tha Rija — Suta nuk e do Selmanin.

— A thue? — ja bëri baca duke e parë drejt. — Ti mori çikë mos u përzje në punë burrash!

— Pyesim Sutën, — tha Sadiku. — Të vendosë ajo.

— Na s'e kena zakon me i pyetë çikat, shoku Sadik — tha baca. — Po ani mirë, po e pyesim. — Baca u ngrit. Suta rendi nëpër shkallë e shkoi në odën e zjarrit. Baca zbriti shkallët dhe u duk në derë.

— A ndive? — i tha Sutës.

Ajo u kthye me fytyrë nga ai dhe u tremb kur e pa ashtu me vetulla të ngrysurat e të egërsuar.

— Hajde lart! — tha baca. — Dhe mos ma korit këtë prak, e ndive?

— S'jam duke e koritur prakun — tha Suta, duke e ditur se ku ishte fjala.

— Ndigjo, mori bijë, — bërtiti ai — mos t'ma koritësh këtë prak, se mos zot ma keq për ty. Hajde lart! — dhe ju ngjit shkallëve me vrull.

Suta hyri prapa tij në odën e miqve.

— Pyeteni — tha baca duke gulçuar. — Ajo vetë e do Selmanin.

Të gjithë u kthyen nga Suta që rrinte në këmbë e tronditur si kurrë ndonjëherë. Ajo kish ulur kokën e fytyra i qe bërë plot njolla të kuqe. Zemra i përpëlitej në kraharor.

— Pse s'po flet? — i bërtiti baca prapë. — Thueje faqe këtyre miqve, e do apo s'e do Selmanin?

— Jo, bacë! — tha Suta duke e parë drejt.

Baca shtangu. Ai e shikoi të bijën me sy të çakëritur për një hop të gjatë. S'ja kish pritur mendja kurrë bacës Selim se e bija do t'i përgjegjej kështu.

— A thue? — ja bëri më në fund e vari kokën në vatër. Pastaj e drejtoi prapë trupin dhe e pyeti.

— Po kë don ti?

Suta s'mundi t'i përgjegjej. Te të gjithë zotëronte një heshtje e nderë.

— Ktë, a? — tha baca dhe tregoi me bishtin e çibukut Feritin.

— Po, bacë, — tha Feriti. — Ne duhemi.

— Heu! Kur kshtu, more djalë, po i zgjedhkan vetë çikat tona burrat? — klithi baca.

— Baca Selim.... — tha Sadiku.

— Lemë, burrë — ja preu baca. — S'keni ma punë me mue — dhe u ngrit me vrull. Qëndroi përpara së bijës e i bërtiti:

— Por, në qoftë kështu, kurrë mos t'i pafsha sytë!

Baca doli me vrull dhe pas tij Sadiku. Suta mbësh-tolli fytyrën me duar dhe qau. Po sonte kjo e qarë nuk ishte e një zemre të mbushur me hidhërim. Jo, jo! Kjo ish si një shi i lehtë, pas të cilit do të shndriste dielli. Dhe, gjithë sa kishin për të ngjarë, ngjanë. Ajo me gojën e vet i tha atij, që i ishte trembur gjithë jetën, se nuk e donte Selmanin. Nga ana tjetër ajo kuptoi se ç'gjë e bukur ishte të luftoje për të mos lejuar njeri që të të marrë jetën nëpër këmbë.

— Të lumtë, Sutë! — i tha Rija. — Një ditë dhe baca do ta kuptojë. Ti mos u tremb. Na ke ne të gjithëve në krah.

Dolën të gjithë nga oda.

Në oborr panë bacën që thithte çibukun e Sadiku diç i fliste duke i shoqëruar fjalët me gjeste. Baca nuk fliste, po dëgjonte me vetulla të ngrysur. Ata ikën, e Suta u kthye prapë. Baca nuk i tha më gjë kur ajo i kaloi aty pranë. Dhe gjithë atë natë baca nuk foli më. Dhe të nesërmen në mëngjez ai nuk i foli Sutës. Në zemrën e tij bëhej një luftë që dita-ditës e afronte nga e bija. Kjo e gjitha ishte si një dalje nga një natë e gjatë dhe e ftohtë drejt ditëve me diell të shndritshëm.

AKUAREL NGA LIQENJTË E LURËS

Simoni më qahej vazhdimisht se punët në studio nuk i shkonin mirë. E takoja pasditeve në «Tirana» me filxhanin e kafesë përpara dhe, sapo ulesha pranë tij, më thosh:

— E, u bë gjë për të shkuar gjëkund?

— Jo, — i thosha — ende jo.

Ai thithte fort bishtin e cigares.

— S'kam gjë për të bërë — thosh. — Mbeta pa punë.

Dhe unë e kuptoja mirë hallin e tij. Kish më se një vit që nuk vizatonte gjë dhe priste me sot e me nesër se mos i dilte ndonjë gjë interesante.

Më shumë shpresat i kishte varur tek unë. Një ditë, s'di sa kohë përpara, i kisha thënë se mund ta merrja me vete ndonjëherë kur dilja me shërbim.

— Po në Lurë shkon? — më pat pyetur ai.

— Edhe në Lurë shkoj — i pata thënë unë.

— Atje po më merr. Të shoh se mos bëj ndonjë akua-rei andej. Janë liqenj të bukur, thonë.

Po ja që edhe mua s'po më bëhej për mbarë për andej nga Lura, kështu që Simonin e gjeja dhe e lija në kafe «Tirana».

— Po ti luaj vetë të shkretën — i pata thënë një ditë. — Më vjen dhe zor të të takoj dhe s'jam në gjendje të të ndihmoj.

— Edhe vetë mund të luaj. xhanëm, po vetëm e kam zor të shkoj gjëkund.

Po më në fund e solli rasti që të nisesha për në Lu-

rë dhe gjëja e parë që më ra ndër mend ishte që të lajmëroja Simonin. E mora në telefon dhe ai më çoi një të puthur përmes receptorit.

Pas një ore priste te Pallati i pionierëve. Në sjetull mbante një çantë të fryrë, në njërën dorë një kuti të vogël dhe në tjetrën një triko të mbështjellë me një copë letër.

— E, gati?

— Gati.

Hipi në makinë dhe pastaj nxori shaminë që të fshinte djersët.

— Për nder, shumë bukur — tha. — Kush nisej vetëm andej! Kurse kështu tok e me makinë, hata fare.

Më afroi te hundët paqetën e cigares dhe unë vura re se si i ndriste fytyra nga gëzimi. . .

Në Fushë Lurë arritëm afër drekës. Miku im piktor një e dy dhe mbështette ballin te xhami i makinës me shpresë se mos shihte liqenjtë.

— Je larg, or baba! — i thosh shoferi. — Ohu, gjer te liqenjtë kemi avaze.

— Ti ke qenë ndonjëherë te liqenjtë? — e pyeste ai shoferin, ndoshta për të dhjetën herë.

— Kam qenë, si jo — thosh shoferi.

— E, si janë?

— Liqenjtë — thosh shoferi — Njëri është me lule. Apo dy? Dy, dy më duket janë me lule.

— Po kjo është e mrekullueshme! — thërriste Simoni. — Liqenjtë me lule!

Atë ditë udhëtimi për në Lurë ne të tre flisnim për liqenjtë, për lule e për bar, për pyje me boriga e për bukurinë e lëndinave që shfaqeshin herë pas here anës xhadesë. Simonin e mahnitnin arat me thekër me një gjelbërim si në të kaltër dhe ujdhesat e verdha të trendelinës me pikëzime të zjarrta lulekuqesh. Dukej që qe një poet i natyrës. Këtë poezi na futi dalëngadalë edhe neve. Në fillim Nuçi, shoferi me pëllëmbë të trasha që i fërkonte në timon, buzëqeshte si me qesëndi kur Simoni numëronte ngjyra e reflekse sa herë që shfaqeshin panorama të bukura. po pastaj, siç dukej, i hyri dhe atij krimbi i poe-

zisë, sepse nisi të kthente kokën herë pas here si një poet i frymëzuar për të parë një pishë të vetmuar që dukej ndanë rrugës, ose ndonjë lirishtë me bar të ri futur thellë humbëtirave të pyjeve. Shkurt qe bërë dhe ai një poet natyre. Dhe, që të jemi të sinqertë gjer në fund, edhe unë nuk mbetësja prapa. Dhe kjo për arësyen se, si inxhinier pyjesh, ndjenjën e poezisë e kisha më afër.

Patëm arritur afër liqenjve, po Simonit nuk i thamë gjë. Dëshëm t'i bënim një surprizë atij, kështu që maqinën e lamë në pyll dhe i thamë të bënim një shëtitje të vogël sa për të çmpirë këmbët. Nuçi vinte prapa nesh dhe mezi e mbante gazin.

— Bëka fresk shumë — thosh Simonit.

— Fresk e çfarë fresku! — thosh Nuçi. — I thonë Lurë, or baba!

— Dhe sa i pastër që është gjelbërimi! Oh, s'ngopesh me frymë.

Unë ecja përpara dhe s'flisja.

Më në fund ja ku u duk një cep i liqenit. Dhe pesë hapa dhe ja ku duket i tërë.

— Pa shih! — thirri Simonit. — Po ky?

Nuçi kukuriste me të madhe.

Para nesh hapej Liqeni i Lopëve, i gjerë, i kthjellët dhe i kaltërt si një sy i bukur mes maleve me pyje. Dru-rët, gjelbërimi, çukat e bardha të maleve dhe qielli pasqyroheshin në të me një qartësi të çuditshme.

— Kjo është kryevepër! Kjo është kryevepër! — thërriste Simonit.

Nuçi, poeti ynë i frymëzuar i asaj dite që para se të bëhej poet buzëqeshte me qesëndi për këto pasthirrma të Simonit, bëri ca hapa para me vështrim të kredhur tej hapësirave të liqenit e ndërliku këmbën në një gropë e u rrëzua.

— Po unë i lashë sendet në maqinë! — tha Simonit.

— Mos u bëj merak! — i thashë. — Tani e bije Nuçi maqinën këtu. Ë, Nuçi?

— Oj të prurë.

— E nxjerr dot aty te livadhi?

— Si, ore, s'e nxjerr.

Nuçi fërkoj këmbën e ndërlikur dhe u nis.

— Kurse ne shkojmë te Liqeni i Luleve — i thashë Simonit.

— Pse, këtu është?

— Ja, pesë hapa më lart.

Liqeni i Luleve atë ditë me gjithë mend ishte fantastik. Zambakët e ujit, të bardhë, bojë limoni dhe të kuqërremtë nxirrnin kërcëjtë e luleve mbi gjethet e shtrira si pjata të ndera mbi sipërfaqen e ujit. Rreth e rreth, anës brigjeve me bar të ri e të dendur, ngriheshin pishat e drejta me një gjelbërim të errët e të pastër.

Simoni mezi priste të vinte Nuçi e të fillonte menjëherë punën, po Nuçi nuk po vinte. Kaloi një hop i gjatë që ne e prisnim dhe nuk po vinte. Maqina e tij uturinte e gulçonte diku matanë pyllit.

— Do të ketë mbetur te livadhi — thashë unë.

Në atë livadh buronte ujë, kështu që rrotat xhironin dhe fundoseshin.

U nisëm për te Nuçi. Maqina vërtet kishte mbetur në livadh. Poeti ynë kishte hequr këpucët, këmishën dhe ashtu zbathur e në kanatjere qe bërë i tëri baltë duke shtruar gurë nën rrota. Bile dhe në ballin e dërsitur i kishte mbetur një vazhdë e madhe balte të zezë.

— Aha! — ja bëra unë.

— Paska pasë baltë, dreqi! — tha ai.

Simoni qe pazmatuar. Nuk i vinte mirë që kjo ndodhi për shkak të tij.

— Ta dija kështu... — thoshte ai. — Po ju pse s'thate që s'kalohej?

— Është e pabesë kjo djall balte, kush e dinte.

Ai solli një gur tjetër, mbështeti një dorë në baltë dhe me tjetrën e shtyu gurin nën rrota.

— Do ta provosh dhe një herë?

— Ta provoj — tha Nuçi.

Hipi në sedilje, ndezi motorin dhe i futi marshin. Maqina shungullonte, rrotat xhironin dhe futeshin më thellë.

Zbriti prapë dhe qëndronte në mes të baltës me duar në bel. Atëhere hoqa dhe unë këpucët, xhaketën, këmishën.

— Rri ti, inxhinier! — më tha Nuçi. — Ç'do të bësh?

— Të shtrojmë ca gurë — i thashë unë.

Ndërkohë dhe Simoni po zbathej me nxitim. Ai qe kredhur kaq shumë në këtë punë, sa Nuçin e mori gazi e nisi të qeshte me gjithë shpirt.

— Jo, jo, për nder — thosh Simoni. — Ti për shkakun tim mbete këtu.

— Po ti rri — i thosh Nuçi. — Do ta nxjerr unë, mos ki merak. S'është e para herë kjo.

— Jo, jo, për nder. . .

Ai i kishte përveshur pantallonat gjer mbi gjunjë e po futej me ata kërcej të bardhë në baltën e livadhit.

Kështu që ishim tri veta të zbatuar pranë maqinës. Unë e Simoni sillnim gurë, kurse Nuçi i shtronte nën rrota. Dhe në fund të fundit e nxorëm maqinën që andej.

Një gjysmë ore më vonë qëndronim të ulur në një trung buzë liqenit dhe lanim këmbët, duart dhe fytyrën nga bllanat e baltës. Tani ishim bërë më të heshtur, por më afër me njëri-tjetrin. Simonit i qe sajuar një rrudhëz e vogël në ballë dhe herë-herë, ndërsa shplante gishtërinjtë e këmbëve, i hidhte sytë nga Nuçi që qe mbytur në djersë. Bile njëherë, kur Nuçi u përkul shumë për të marrë ujë me grusht, e mbajti për krahu, ndërsa çorapja e vet i ra në liqen.

Dreka kishte kaluar me kohë. Ne na kish marrë uria dhe u shtruam të hanim gjërat që kishim marrë me vete. Si mbaruam, unë u ngrita dhe thashë:

— Ti, Simon, rri me Nuçin këtu e bëj ç'ke për të bërë.

— Po ti?

— Unë do të shkoj gjer këtu afër e do të kthehem prapë.

— Te Pjetri? — më pyeti Nuçi.

— Po, te Pjetri.

Pjetri është rojtari i pyjeve, një njeri që e do pyllin me mish e me shpirt. Me të nuk është e mundur të merresh vesh kollaj kur vjen puna për të prerë lëndë. Dhe pikërisht nga kjo gjë shumëkush e nderon dhe e respekton atë.

Ndaj të ngrysur, si takova Pjetrin dhe ndenja një

copë herë të madhe me të, po kthehesha prapë te Simonin e Nuçi.

Mendja më thosh se Simonin do ta gjeja te Liqeni i Luleve të ulur buzë ujit e me penel në dorë. Po te Liqeni i Luleve nuk ish as Simonin, as Nuçi e as ndonjë gjurmë tjetër. «Atëhere i ka shkrepur të bëjë ndonjë akua-rel nga Liqeni i Lopëve», mendova unë dhe zbrita për atje. Po as te Liqeni i Lopëve nuk kishte njeri. «Bah! Po ku kanë shkuar?!»

— O Simon! — thirra unë.

Zëri jehoi thellë pyjeve që përflakeshin nga rrezet e fundit të diellit.

— O Simo-on!

— Ej! — u përgjegj Nuçi diku nga ana e livadhit.

Kur shkova te livadhi, nuk po u besoja syve. Maqina ishte futur prapë në baltë, Nuçi prapë që zhveshur dhe mbante një gur të madh në dorë, gati për ta hedhur nën rrota. «Po këta nuk vunë mend? Si u futën prapë maqinën në tragën e parë?»

Sa hapa gojën të thosha diçka, syri më zuri Simonin që qëndronte pak më tej. Ai që zbathur e zhveshur si më parë dhe diç vizatonte me nxitim.

— Hajde, inxhinier! — më tha Nuçi pa lëvizur nga vendi.

Ishte e qartë. Nuçi pozonte një moment nga kapërcimi i vështirësive. Ju afrova Simonit dhe pashë se si kjo ide po mishërohej dalëngadalë në ato viza të trasha që piktori hidhte me nxitim.

— Po si kështu? — thashë unë. — Për çfarë nise e çfarë bitise.

— S'ka gjë, s'ka gjë — thosh Simonin pa i hequr sytë nga vizatimi. — Kjo është më interesante.

— Kush e merr vesh punën tuaj — thashë. — Po të ishe për këtë, s'ishte nevoja të vije gjer në Lurë.

— Po ja që këtu që e thënë të vizatohej Nuçi — qeshte Nuçi me veten e vet.

Simonin vizatonte, Nuçi pozonte pranë maqinës, kurse mua më vinte keq që s'kisha një aparat fotografik. Do të që një pozë e bukur për një piktor e një shofer që qenë

kredhur në baltë gjer në gju me pantallona të përveshura. Më në fund vizatimi mbaroi. Ne e vumë atë përpara dhe afruam kokët të tre. Ishte pa ai kuadër që kishim rreth e rreth, po ai Nuç, veç me nofulla ca më të gjera, me zverk e krahë ca më të trashë.

— Kjo është interesante — thosh Simoni. — Është temë e ditës. Edhe për liqenjtë mund të bëj diçka, po kjo është më interesante.

— Vetëm sytë nuk më duken mirë — thosh Nuçi. — Unë sikur i kam më ndryshe.

— Nuk janë përfunduar — thosh Simoni. — Është vetëm një skicim i shpejtë.

— Po krahët, ç'ne kaq të trashë? — thosha unë.

— Ideja e forcës, or mik, ideja e papërkulshmërisë përpara vështirësive — sqaronte Simoni.

*

Pas tre muajsh u hap ekspozita e arteve figurative, me punime që pasqyronin jetën e klasës punëtore. Simoni më tha në telefon se qe pranuar dhe puna e tij.

Një mbrëmje shkova të shihja ekspozitën, s'do mend edhe punën e Simonit.

Simonin e gjeta para ekspozitës, të mbështetur pas murit te hvrja. Pinte cigare dhe ishte i menduar.

— Hë? — i thashë unë.

— Përsëri hiçgjë — më tha ai.

— Si hiçgjë?!

— Nuk ka sukses. Njerëzit vijnë e shkojnë, po puna ime nuk i tërheq.

Lëshoi bishtin e cigares përdhe dhe e shtypi me majën e këpucës.

— Më interesant është një fakt — vazhdoi. — Dikush ka paracitur diçka nga Liqenitë e Lurës dhe ka sukses. E pra, as që i përdor ngjyrat siç i përdor unë, por megjithatë ka sukses.

— Kush është ai? — e pyeta.

— Një piktor, është mësues në ato anë, thonë.

E kapa për krahu dhe u futëm brenda.

Vërtet puna e Simonit nuk kishte sukses. Në një vend, tre-katër metra larg saj, qenë grumbulluar disa veta dhe shikonin një tablo.

— Ja! — më tha Simoni. — Ajo është puna e atij piktorit.

Kjo tablo paraqitte një traktorist që kish hedhur xhaketën krahëve dhe ndizte një cigare. Më tej dukej traktori i tij, buzë një liqeni me ujë si kristal. Pranë traktoristit që ulur një çunak i vogël me një shkop në dorë dhe diç pyeste me kureshtjen e ndezur të fëmijëve. Atje, në të djathtë të traktorit, zbrisnin dhitë nga monopati e nxitonin të ktheheshin në fshat. Traktoristi shikonte djalin me një nënqeshje të ngrohtë në sy e në fytyrë.

Sa më shumë i shikoje, aq më të afërta bëheshin fytyrat e atyre dy njerëzve, aq më i kthjellët dhe i pastër vështrimi plot ëndrra i fëmijës dhe aq më e ngrohtë dhe dashamirëse nënqeshja e traktoristit. Të dukej sikur nënqeshja e tij i mbushte me dritë dhe jetë hapësirat rreth e rreth gjer larg në horizont, ku zgjatej një linjë tensioni të lartë.

U ktheva dhe pashë përsëri punën e Simonit. Të them të drejtën e ndjeja veten ngushtë duke parë tablonë e tij. Bile sikur që zbehur skicimi që i pat bërë Nuçit dikur. Në vend të Nuçit ish një tjetër më pak i ngjashëm me të, një njeri me zverk e duar të trasha që hidhte gurë nën rrotat e maqinës.

— Nuk e kuptoj, — më pëshpëriti Simoni, që prapa — tema e klasës punëtore është, dinamikë ka, ngjyrat s'i kam përdorur keq ... Ç'i mungon që nuk e pëlqejnë?

Simonin e njihja prej kohësh, njeri i mirë dhe jo pa talent që, shok dhe mik i mirë me mua që, po tani, kur edhe mua më vinte po aq keq sa dhe atij që kjo punë i pat dështuar, nuk mundja kurrsesi t'i thosha një fjalë të mirë. Nuk kish kuptim t'i bëja qejfin kot më kot.

— Hiqi vizë kësaj! — i thashë.

— Pse?

— Nuk ka jetë.

Dhe vërtet fakti që erdhi me mua në Lurë për të

bërë diçka tjetër dhe bëri tjetër gjë, tregonte se ai s'kish-
te gjë për të thënë. Ndoshta dhe për Lurën s'do të bënte
gjë ashtu duke u kaluar gjërave përciptazi.

— Nuk ka jetë, — përsërita unë — ja se çfarë. Me
zotësi profesionale dhe me ngjyra nuk mbulohet kjo. Të
Nuçin brenda një dite e njohe, po kaq është fare pak.

Ai kish rrudhur ballin dhe shikonte tablonë e vet.

PULËBARDHA

— Uh, Beni! U lodha!

Ajo brof mbi kërcinjtë e hollë dhe i afrohet parmakut të urës. Aty poshtë, në shtyllat e nxira nga koha, gurgullojnë valët e detit që murmurijnë ëmbël e mbytur.

— Të hidhem?.. Po?

Djali bën një shenjë me dorë e hesht. Fytyrën e nxirë e të menduar ja puthin rrezet e kuqe të diellit që perëndon.

— Mirë, ja!

Vajza merr vrull, kërcen në majë të gishtave e lëshohet me kokë drejt ujit të vakët. Zhytet për disa sekonda e pastaj del përsipër duke çarë përpara me pash të shtrirë.

— Hidhu, Beni! Oh, ja, shih! — i bën me dorë atij e ~~shket mbi valëzat e lehta, duke lënë pas një dantellë të bardhë e të hollë shkumë...~~

Aj mezi vë buzën në gaz e çohet si me përtrim. Shikon poshtë duke kruajtur gjoksin leshtor e hidhet si gur me sy të shtrënguar.

— Ha, ha, ha! Ndiqmë, Be-e-ni...

Po ai përplas dy-tri herë këmbët e pastaj zë tokë. Shtrydh flokët e murmurit:

— Bah, pse luajta mendsh?

— Beni, e-eja!

Ajo mezi duket. Tashmë kapuçi i saj, rrasur fort mbi leshrat e zeza, noton atje tej ku pulëbardhat çikin me britma gazmore sipërfaqen e ngrohtë të detit. Stërkalat e ujit ndrisnin nën rrezet e fundit e bien pastaj mbi të si dush i kuq.

— Him! — çon buzën në gaz ai, kur sheh se sa larg ka shkuar ajo. Qëndron pranë bregut e ndjek me sy lëvizjet e saj të shkathëta. Herë pas here pulëbardhat çajnë ajrin e brishtë mbi kokën e tij e sulen me vrull drejt horizontit të pakufishëm, ku po, kridhet disku i zjarhtë i diellit.

Ai do të thërrasë:

«Diana, kthehu», — po, kur vë re se ajo shikon drejt tij, ngre dorën lart dhe e tund në ajër.

Mbrëmja është e vakët, e qetë dhe e purpurt. Nga larg vijnë kukurisjet e Dianës që noton duke rrahur ujin fort. Ajo kthehet herë në ijë, herë në shpinë e prapë noton me pash të shtrirë duke hapur ujin rrathë-rrathë. Ja, dhe pak e ajo mbërrin te këmbëzat e urës, Kapet te fundi i shkallëve e ngjitet gjithë vrull, duke shkëlqyer e tëra si një mushama bojë-kafe e posa-nxjerrë nga uji.

— Oh, Beni! Ç'mrekulli! Po ti?

Përkulet e qesh me të madhe duke zbuluar dhëmbët e bardhë e të fortë.

— Mbetë? Mbetë, mbetë?... — e përplas pëllëmbët ndërsa kukuris e fytyra e nxirë i vetëtin nga gazi.

— Hajde, Diana, tani.

— Ku?!

— Po unë s'ta prisha... u lamë... kurse ti...

Ajo psherëtiu.

— Uh, Beni! Po mërzitem, mërzitem shumë atje.

— E pse?

Ai u vrejt e ktheu kokën mënjanë.

— Mirë, rri!

— Beni...

Ajo ju mbështet në krahë.

— Beni, rrimë dhe pak e shohim pulëbardhat.

Këtë radhë zëri i saj qe i thellë, i dridhshëm e sikur i gurgulloi atje në fund të gjoksit.

— Pulëbardhat? He, fëmijë ke për të mbetur gjithmonë ti. — Po Diana s'e dëgjoi fare. Ajo po shikonte fluturimin madhështor të pulëbardhave. S'ngopej së dëgjuari klithmën e tyre gazmore, fshkullimin e krahëve kur çanin ajrin e lëshoheshin drejt perëndimit si të çmendura nga gazi. Dhe gjaku i rrihte kaq shumë në deje, sa i bëhej të mblidhej galuc e të hidhej drejt horizontit të pafund. Atëhere do të ndjente vrullin e erës t'i vërshonte në gji e t'i merrte leshrat pas, atëhere ajo do të ngjitej lart, lart në kupolë të qiellit e të shihte që andej, gjithshka që ka në botë.

Puliste sytë herë pas here e çonte nëpër mend qindra ëndrra.

«Ah, pse s'i lënë dhe vajzat të bëhen pilote? Po, unë do bëhesha pilote. Po jo, jo! Mjeko do bëhem. Gjimnazin e mbarova e këtë vit do të futem në Institutin mjekësor. Ah, ç'mrekulli! Po sa keq që njeriu s'mund t'i bëjë të gjitha këto. Po, jo, jo! Unë do t'i bëj të gjitha, të gjitha...»

Po shpejt u përmend nga këto ëndrra të ndritshme, ktheu kokën e pa fytyrën e të fejuarit. Rrudhi vetullat si të vriste mendjen për të gjetur diçka. Flokët ja shpupuriste një erëz e lehtë, që vinte nga deti.

—Përherë të njëjtën gjë kërkon të bësh ti, Beni. — Zëri i saj qe trashur papritmas. — Po, po! Dhe kushedi sa kohë akoma kështu. Të paktën, tani që jemi në plazh, të pushonim si të na pëlqente më mirë, kurse ti...

— Ç'farë? — Zëri i tij tingëlloi ashpër. — Ti e kupton se s'duhet të më kundërshtosh.

Ajo prapë vrejti vetullat.

— Po, Beni — i tha pastaj duke e kuptuar se ishte e kotë ta kundërshtonte.

— Dhe nuk do të vish me mua? .

— Jo, Beni! Do të vij.

Hodhi një shall të hollë krahëve dhe u nis përpara. Rëra i guduliste putrat e zbathura, që shkelnin fare lehtë mbi atë qilim të hirtë.

— Mirë, Diana! Rrimë ca atje e kthehemi në pistë — i tha ai. Ju avit dhe e kapi prej shpatullave delikate. Leshrat e saj kishin shijen e kripur të detit. Ajo kundërmonte e tëra nga kjo njelmësi e shëndetshme.

Vendi që donte aq shumë Arbeni ishte një urëz e vogël dërrase, që futej si sqep në ujërat e detit. Uleshin aty, varnin këmbët poshtë, e rrinin derisa horizonti errej fare.

Vilat dhe hotelet shkëlqenin gjatë bregut nga dritat e shumta, njerëzit grumbulloheshin plot zhurmë nëpër bufera e restorante, por kjo valë jete dhe gëzimi mezi arrinte deri tek ajo urë e vetmuar, që i shembëllente një anijeje të braktisur e të harruar në molo. Tej nga perëndimi, nën qiellin e ulët veror qëndisur nga miliarda yje, flinte deti i pafund, që shtynte njëra pas tjetrës drejt brigjeve ranore, valëza të vogla e të lehta.

— Pesë vjet, Diana, plot pesë vjet sakrificë për këtë ëndërr.

— Po, Beni!

— Dhe a më kupton? Kam ngrënë në mensë si punëtor i thjeshtë për të kursyer këto para. Kurse ti...

Kështu niste e merrte zjarr ai sa herë që vinin tek ajo urë e braktisur dhe e harruar. Diana çuditej si ndizej aq shpejt natyra e heshtur e të fejuarit, i cili s'nxirrte kurrë një fjalë kur ndodhej në mes të njerëzve. Vetëm vetmia i pëlqente aq shumë si dhe ëndrra e tij. Beni kishte punuar pesë vjet e ca si mësues fshati e kish kursyer disa të holla, për të ndërtuar një shtëpi. Tani s'pushonte së foluri për projektet e tij.

Diana e kish dëgjuar kushedi sa herë dhe e din-

te përmendësh ku duhej ta priste, ku duhej ta pyeste.

— Po ku, Beni?

— O, hiç mos ki merak. Se ku, e kam menduar kaq herë unë. Komiteti ekzekutiv do të më japë një copë vend e atje do ta ndërtojmë shtëpinë tonë. E di? Afër kodrës, Diana!

— Uu, Beni!

— Çë?

— Kaq larg?

— E pse larg?

— Se shkolla ose puna do të më bjerë larg, mor Beni.

— Puna? He, puna thotë. Ti do të rrish në shtëpi, Diana, në shtëpinë tonë.

Ajo çonte buzën në gaz e, duke menduar se sa e largët ishte ajo ditë kur do të mbyllej në shtëpi, fërkonte giunjtë e heshte.

— Mirë, Beni!

Këto projekte, të cilat dikur i pat dëgjuar me interes, tani e mërzitnin dhe e shqetësonin. A thua me gjithë mend ishte kaq i dhënë ky njeri pas një ëndrrë kaq të çuditshme? Fundja, ç'kuptim kishte ajo? Këtë Diana s'e kuptonte dot. Ajo mezi që shkëputur nga muret e shtëpisë e tani duhej kthyer prapë te këto mure.

— Beni, po pse gjithmonë këtu?

Asaj i që neveritur ai vend i heshtur. Diana dri-dhërohej e desh me çdo mënyrë ta hidhte Benin në valët e asaj jete, që tashmë zhurmonte andej larg në vilat e hotelet plot dritë, në vinçat që ndërtonin edhe natën, në gulçimat e lokomotivave që turrëshin nëpër binarët e hekurit e kudo ku fluturonte fantazia e saj, kudo ku shtriheshin ëndrrat e saj të lira në botën e madhe. Oh, kjo urëz e kalbur! Sa e tmerrshme i dukej! I ngjante sikur e kishin lidhur aty, tamam aty buzë detit të pakufishëm, që murmuriste aq ëmbël, aq butë. Dhe shpirti i saj desh të sulej si pulëbardhë drejt horizonteve të reja, desh të dehej në atë vrull fluturimi në pafundësi.

— Beni, shkojmë? — tha ajo pas një heshtjeje të gjatë. Kishin kaluar më se dy orë që rrinin të mbërthyer aty. Në zërin e saj ndihej mërzi dhe shqetësim.

— E ku?...

— Uh, dhe ti Beni... Harrove?

— O, po! Ja, Diana.

Ajo kërceu nga parmaku i urës e ju hodh në qafë. Sa e çuditshme ishte Diana! Sa shpejt ndryshonte ajo! Ja, tani zëri i kumboi nga gëzimi.

— Pse, Beni, ti s'u kënaqe?

— Diana, shallin.

Ajo u kthye, mori shallin e nisi të vallëzonte me të: La-la-la, la-la-la.

Ai i shkante pas e mbante në buzë një bisht cigareje të shuar.

Rëra që ftohur e zbutur nga vesa. Plepat përballë dukeshin si një mur gjigant formash të çuditshme, ndërsa godinat e prisnin këtë mur të zi me konturin e thyer të çatave.

— E sheh, Diana?

— Çfarë?

— Ja, atë vilën e kaltër.

— Po!

Ai buzëqeshi gati me hidhërim e tha:

— Si po?!

— Po ja, Beni, ajo që ka dritare me perde tyli.

— Eh, Diana! Gjithmonë një vajzë e papjekur ke për të mbetur ti — dhe flaku me zemërim bishtin e cigares.

Ajo mblodhi buzët e u kujtua.

— U, po, Beni. Po, po! Kjo i ngjan shumë asaj që ke projektuar ti.

Ngjitën shkallët e shtëpisë së pushimit e u futën brenda.

Ai nxitoi te komodina e nxori projektin nga sirtari. E hapi mbi tryezë e nisi të vizatonte.

— Të kujtohet, Diana, si i kishte dritaret ajo?

Të gjërë, plot dritë e perde. Po, po. Ja, kështu — dhe vizatonte.

Sytë e tij të hirtë, papritmas ishin gjallëruar e shkëlqenin plot zjarr. Çudi! Ç'dritë e jashtëzakonshme ja ndriste fytyrën! Rrudhte vetullat, buzëqeshte lehtë me vete e kridhej gjithmonë e më thellë.

Diana vërtitej para pasqyrës. Ajo veshi shpejt e shpejt një bluzë të hollë e një fund me pala. E nxirë nga dielli, me llërë të hajthme e delikate nën bluzë, ajo shkëlqente e tëra e përhapte gjithë hiret e saj të magjishme. E lehtë si flutur ju afrua Benit, u përkul mbi të dhe e puti në flokë.

— Beni, po ti kur do të vishesh? Ora po vete dhjetë.

— Hajde de. Si s'ke menduar rionjëherë se sa apartamente të bukura bën shteti? — dhe e tërhoqi për krahu.

Ai e shtyu me të keq dhe u vrejti përnjëherësh. Sytë ja flakëroi me shpejtësi të rrufeshme egërsia.

— Lërmë, ç'm'u bëre rrodhe?

Diana qe përplasur pas dritares ku xhami u thye me kërkëllimë. Gjithë gazi i saj qe tretur brenda një sekonde e në grykë po e shtrëngonte lëmshi i lotëve.

— Rrodhe?! — murmuriti me vete e kafshonte fort e më fort çipin e buzës.

Tani nga xhami i thyer frynte era e mbrëmjes, që binte gjithë gazin e jetës. Dhe deti murmuriste plot melodira të mbytura nën atë qiell ngjyrë çeliku, dhe plepat shushurinin aty pranë e sikur e ftonin në gjirin e tyre. Diana ktheu kokën me vrull dhe e vështroi Benin. Ai prapë buzëqeshte i kredhur në projektin e tij. Në sy i shkëlqeu përbuzja, po nuk foli. Bëri nga dera e doli jashtë. Tashmë sikur diçka e rëndë i qe hequr nga gjoksi e merrte frymë lirisht. Buklet e flokut që lodronin me erën i përkëdhelnin faqet e skuqura, ndërsa shihte me një gëzim të padukshëm vargun e hoteleve që llamubritnin buzë detit.

Oh, nga i vinte ky gëzim në këto çaste të rënda! Ndoshta ngaqë mbrëmja ish kaq e bukur, kaq e freskët. O, jo, jo!

Diana ktheu kokën e pa dritaren e thyer të dhomës së tyre. Atje kishte dritë e Beni ndoshta ende s'e kishte ngritur kokën nga projekti i tij. Në shpirt ndjeu ligësi, një ligësi të keqe kundër këtij njeriu që gjithë jetën ja pat kushtuar vetëm një shtëpie, vetëm një çerdheje, e cila do t'i zinte frymën Dianës. Jo, ajo kurrë nuk e donte atë jetë të vogël, atë jetë të mbyllur brenda katër mureve, kur bota ishte kaq e madhe, kur ëndrrat e saj donin qiell të hapur e jo çati tërë blozë. E tani gëzohej që kish ikur qoftë edhe për pak kohë larg ëndrrave të tij të vogla, gëzohej që merrte frymë larg atyre projekteve, që i kishin mbledhur dalëngadalë aq ligësi në shpirt. Për pak kohë! A do të kthehej Diana më tek ai?

Ajo ndali prapë. Një lëmsh ju bë në grykë, sytë ju mbushën me lot e nisi të dëneste.

— Jo, nuk mundem, nuk mundem — murruriti ajo e psherëtiu. — Sonte s'mundem të kthehem më tek ai.

Dy rrëkeza të ngrohta i zbritën në faqe e, si heshti një hop të gjatë duke ecur kok ulur, shtoi me zë të mbytur:

— Dhe ndoshta kurrë, s'kam për t'u kthyer më. — Ajo në ato çaste donte që Beni ta ndiqte, ta zinte e t'i braktiste të gjitha ëndrrat pa kuptim, po ai s'mund të shkëputej dot nga vetja e tij, prandaj dhe drita nuk shuhej në dritaren me xham të thyer, prandaj dhe ajo as që desh ta kthente kokën më andej.

TROJE VETËTIMASH

Një kura e ushtarëve të vjetër të kufirit u liruan. Ata morën rrugën në heshtje, udhëtuan përmes shelgjeve që i tundte era e vjeshtës, kapërcyen lumin me varkë dhe hipën në kamionin që i priste matanë, në bregun tjetër. Vendin e tyre e zunë ushtarë të rinj me kokë të qethur e mustaqe të padërsitura. Tani bëhej gati të nisej kuraja e dytë e ushtarëve të vjetër dhe pritej nga ora në orë të mbërrinte në postë kontigjenti tjetër me ushtarë të rinj.

Kufitar Myrtezai po kthehej në drekëherë nga shërbimi. Ai ecte në bregun e lumit ngadalë dhe vështronte ujërat e fryra nga shirat që vërshonin drejt përrëndimti si një masë e rëndë dhe e ngathët. Në këtë vend, kufiri binte në mesin e lumit dhe Myrtezait i pat qëlluar kaq e kaq herë të vrojtonte aty i shtrirë midis shelgjeve. Po tani këto mbaruna të gjitha. Ishte dita e fundit e shërbimit e, pas kësaj, ai do të shkonte në postë, do të bënte dorëzimet e do të ikte përgjithnjë.

U ul në një trung të rrëzuar dhe ndezi një cigare. Automatikun e vuri mbi gjunjë dhe vështrimin e ngulli matanë, në tokën e shtetit tjetër. Sa e sa herë qenë nisur nga toka e këtij shteti drejt tokës sonë diversantë në netët e errëta. Sa e sa herë i pat prerë ata plumbi i kufitarëve. Po ata përsëri niseshin, përsëri zvarriteshin

si copa nate drejt kufirit tonë. Dhe përsëri plumbi i kufitarit i priste këto copa nate që deshën të sillnin vdekjen. Kufitar Myrtezai pinte duhan në heshtje. Prapa krahëve të tij shtrihej atdheu, hapeshin lëndinëzat e fushat, malet e luginat, fshatrat e qytetet e largëta.

Në një shteg, u dëgjuan hapa. Myrtezai ktheu kokën dhe pa kufitar Vehapin që po ngjitej në rrëpirën e lumit. Ai ecte kokulur dhe, herë pas here, ngrinte rripin e automatikut që i varej në sup.

— E? — i tha Myrtezai.

— Ja! — u përgjegj tjetri po aq shkurt!

Kufitar Vehapi ishte i shkurtër, me shpatulla të ngjeshura e me një shenjë plage mbi vetullën e majtë. Po atë ditë ai dukej më i shkurtër dhe në fytyrë i pat rënë një zbehtësirë e lehtë. Dhe për të ishte dita e fundit e shërbimit. U ul pranë Myrtezait e, si ndenji një hop në heshtje, tha:

— Ja, mbaroi dhe kjo.

Fryma i doli si një psherëtimë.

— Një ditë do të mbaronte — tha Myrtezai pa e shikuar.

— Më mirë të mos e dish ditën që lirohesh — tha Vehapi. — «Ja, të të thonë, sot mbarova shërbimin ushtarak dhe do të nisesh.» Kurse kështu...

Ndenjën një hop në heshtje.

— Na u bë si shtëpi posta — tha prapë Vehapi. — S'qenka kollaj të ndahesh. Po ti e ke më lehtë, xhanëm.

— Pse?

Myrtezai ktheu kokën dhe e shikoi shokun drejt. Ai kishte marrë një degë shelgu dhe po e gdhendte me brisk.

— Helbete, ti je i martuar, të pret gruaja, vajza... doemos. Për ne beqarët, më thotë mendja, qenka më zor.

Myrtezai vërtet kishte grua dhe vajzë. Kur qe larguar nga shtëpia, në ditët e para e digjte malli për çupën e vogël që atëhere sapo kish nisur të belbëzonte, po që ta kish më lehtë se Vehapi...

— Lehtë, thashë — vazhdoi Vehapi duke gdhendur. — Mbase jo kështu, po mua, të them të drejtën, s'më bëjnë këmbët të iki. Kot thonë se ushtari gëzohet, kur i vjen dita e lirimit. Qysh mund të gëzohesh kur ndahesh nga shokët? Këtë do ta ketë nxjerrë ndonjë që s'ka qenë kurrë ushtar.

— Ashtu është — tha Myrtezai.

Dhe pas një hopi:

— Kurse unë u gëzuakam, ë?

— Ohu, ku të mbeti mendja dhe ty — ja preu Vehapi. — Thashë se e ke më lehtë.

Ishte fund tetori e në brigjet e lumit frynte erë e lagësht vjeshtë. Lart shtjelloheshin re që ngriheshin pirqje-pirqje, dhe pushtonin qiellin. Mbi lëndinëzat ku gjallonte një bar i hollë dhe i dendur herë lëvrinin hije e herë ndriçonin lumenj rrezesh dielli që dilnin përmes të çarave të reve.

II

Komandanti i postës së kufirit, oficer Ibrahim, u njoftua se atë mbrëmje pritej të vinin diversantë. Armiku kujtonte se në këtë ditë, kur iknin ushtarët e vjetër dhe vinin të rinj, do ta kishte më lehtë për t'u futur në tokën tonë. Po kjo ishte një gjë e njohur për oficerin e vjetër Ibrahim Skënderi.

Pasdite ai thirri oficerët e postës dhe nisi menjëherë kufitarë të tjerë nëpër pikat e vrojtimit. Gjithshka u bë në heshtje dhe në fshehtësi të madhe. Matanë, në bregun tjetër të lumit, armiku vrojtonte. Si mbaroi këtë punë, oficer Ibrahim hyri në mensë, ku do të bëhej ceremonia e nisjes së kurasë së dytë të kufitarëve që liroheshin.

Brenda zotëronte heshtja. Në krye të mensës ishte vënë një tryezë e madhe e mbuluar me beze të kuqe, një vazo me lule, disa libra të vëna stivë.

Oficer Ibrahimimi doli në krye të tryezës e nisi fjalimin e lamtumirës. Goja i merrej dhe dukej fare qartë që edhe për të ishin të rënda këto çaste ndarjeje. Pastaj, ai ndau fletë-lavdërimet duke i kapur ushtarët në qafë e duke i puthur në faqet e argasura nga dielli e erërat. Ushtarët skuqeshin, emocionoheshin e mezi thoshin tri-katër fjalë duke i palosur me gishtërinjtë që u dridheshin këto fletëlavdërimi. Dhe kufitar Myrtezai e pati të vështirë atë çast kur u puth me komandantin dhe mori fletëlavdërimin. U ul në vend e nga mendja s'i hiqej pyetja: «Çfarë po ndodh sot në postë?»

Ish mësuar ta kuptonte komandantin e vet në heshtje. Ai kishte vënë re në sytë e oficer Ibrahimimit se diç po ndodhte në postë, po këtë komandanti nuk ja tha njeriu. Komandanti përpiquej të tregohej i qetë dhe sikur asgjë s'kishte ngjarë.

— Ju tani do të niseni — tha komandanti. — Maqina ju pret në rrugë e nga dega ushtarake na kanë njoftuar se sonte duhet të jeni në qytet. — Ai heshti një hop duke zhubravitur me gishta një copë letër, pastaj ngriti sytë e pa ushtarët:

— Pra, udhë të mbarë!

Zëri ju drodh. Diçka gurgulloi në gjoksin e fortë të këtij oficeri të vjetër. Vuri kapelën, diç i tha intendentit dhe pastaj nisën të dilnin në oborr. Aty zuri t'i puthte prapë ushtarët një nga një. «Çfarë po ndodh sot në postë?» s'i hiqej që s'i hiqej nga mendja kjo pyetje Myrtezait një kufitarit të liruar. Kuranë e parë komandanti e kish shoqëruar gjer te maqina, kurse sot po ndahej me ta që këtu në oborr dhe sikur ngutej për diku. Intendenti solli një arkë me ushqime dhe nisi t'ua ndante të liruarve, kurse komandanti ngjiti me nxitim shkallët e kapanonit dhe u fut në zyrë.

Kufitarit të liruar Myrteza s'i shpëtonte asgjë nga këto. Ai ishte mësuar ta lexonte në fytyrë, në sjellje e në lëvizje komandantin e vet. Kjo ishte e kuptueshme. Dy vjet, ditë për ditë me këtë njeri, dy vjet në si-

tuata e në çaste nga më të ndryshmet, në jetën e asaj poste. Në fillim, kur erdhi për herë të parë në kufi, ky oficer i vjetër i qe dukur njeri i ashpër. Fytyrën e kishte të argasur e me rrudha të thella në ballë, sytë të vegjël e të ndritshëm, nofullat e dala e të gdhëndura si në gur. Në zverk kishte një shenjë plage që nga koha e luftës kur ishte partizan. Ky oficer i vjetër, që kishte një zë të trashë e pak si të ngjirur, nuk të vështronte në sy dhe fliste pak. Kur e thirri për herë të parë në raport, Myrtezai qe dridhur. Po komandanti fshih-te një zemër prej babai prapa asaj fytyre të argasur e atyre tipareve të rrepta. Këtë kufitar Myrtezai e kuptoi një natë kur të dyve ju desh të rrinin bashkë në përgjim në brigjet e lumti. Kufitar Myrtezai u shtri në mesin e ca shkurreve. komandanti shkoi më tej. Pas pak, prapa krahëve dëgjoji hapa; po vinte komandanti me një krahë fier të thatë.

— Shtroje! — i tha Myrtezait. — Toka të ftoh — dhe ja lëshoi barrën me fier që e kishte mbledhur diku. Pastaj iku prapë, shkoi në pikën e vet të vrojtimit. Kështu ish ky oficer i vjetër me të gjithë kufitarët. Dhe të gjithë ata e donin këtë njeri «të rreptë» si baba.

Intendentit ndante ushqimet, ushtar Myrtezai u shkëput nga turma dhe u nis drejt kaponit. Ngjiti shkallët, u fut në korridor dhe u drejtua për te zyra e komandantit.

Në prak të derës u ndodhën ballë për ballë.

— S'jeni nisur? — pyeti komandanti.

— Shoku komandant... — i tha Myrtezai.

Oficeri i vjetër uli sytë e nisi të dëgjonte.

— Shoku komandant, — përsëriti Myrtezai — mos vallë pritet gjë sonte?

Oficeri Ibrahim i ngriti sytë e tha:

— Po, Myrteza. Na kanë njoftuar se diç mund të kemi sonte.

Ai i rrahu supet kufitarit të liruar, buzëqeshi një grimë dhe shtoi:

— Ju ikni me mendje të fjetur. I kemi marrë masat.

Ra për një hop heshtje. Myrtezai kish mbetur në këmbë përpara komandantit të vet dhe përpiquej të gjen-te fjalë për të thënë diçka. Vetullat i qenë ngrysur e kjo tregonte se diç e pat ngacmuar në sedër. Ngriti kokën e tha me vryll:

— Po si mund të ikim ne?

— Myrteza! — i tha komandanti me zë të ngjirur.

— Ju s'e keni lënë kufirin vetëm, kupton?

Duket se edhe atë e ngacmoi diçka në sedër.

— Po, — tha Myrtezai — ne s'e kemi lënë vetëm, po kështu s'mund të ikim.

Dhe pas një heshtjeje të shkurtër:

— Jo, jo! S'mund të ikim.

Komandanti i futi krahun, e tërhoqi brenda në zyrë dhe mbylli derën. Shkoi e u ul në vendin e vet, mbështeti duart mbi xhamin e tryezës dhe tha:

— S'mund të ikni?! Shiko, kaq kohë në ushtri dhe s'u mësove dot me urdhëra?! Urdhëri është që ju son-te duhet të ndodheni në qytet. Nesër, të organizuar, do t'ju nisim nëpër shtëpira. Në shtëpira ju presin, e di këtë ti? Kohën e shërbimit ushtarak e kryet dhe e kryet me nder. Ç'është ky mosbesim ndaj shokëve që keni lënë këtu? A, kufitar Myrtezai, jo kështu.

Kufitar Myrtezai drejtoi trupin e tha:

— S'është mosbesim ky, shoku komandant. A do të iknit ju nga posta, po ta merrnit vesh se diç mund të ndodhte në kufi?

Oficeri i vjetër Ibrahim Skënderi nisi t'i binte xhamit me gishtërinj.

— Shiko — tha, pasi heshti një hop.

U ngrit në këmbë dhe e kapi Myrtezain për bërryli:

— Shiko... lëri avokatllëqet. Nisuni, ky është urdhër!

— Unë këtë urdhër s'mund ta zbatoj — tha Myr-tezai këmbëngulës.

E mori parasysh, le t'i bërtiste, le të thoshte çfarë të donte komandanti. Uli kokën e nisi të priste bre-shërinë e fjalëve. Po komandanti ja shtrëngoi më fort bërrylin, pastaj i kapi veshin dhe ja tërhoqi pak.

III

Askush nuk u nis atë natë për në qytet. Ata vajtën tek arka e intendentit, i lanë racionet e ushqimit që kishin marrë për rrugës dhe shkuan drejt tek armët e tyre. Shkuan të vigjilonin në kufi, pavarësisht se në xhepa kishin fletët që tregonin se shërbimin ushtarak e kishin kryer. Ç'rëndësi kishte në e kishin kryer apo jo shërbimin ushtarak? Ata mund të shkonin të vigjëlontin jo vetëm duke u ndodhur aty, po dhe po të ishin larg, diku në qytetet e fshatrat e tyre, po ta kërkonte mbrojtja e kufive. I gjithë populli do të ngrihej e do të vinte këtu, po ta kërkonte nevoja. Dhe nusja e Myrtezait do të vinte këtu, edhe të gjitha nuset, vëllezërit, motrat, nënat e baballarët e gjithë Shqipërisë do të vinin këtu nën tingujt e alarmit. Jo më ata që ndodheshin në kufi në një natë si kjo, kur armiku kujton-te se mund të gjente mjegull.

Nëpër shelgjet shungullonte era e vjeshtës. Muzgu qe shtuar me kohë kur ata u nisën për në pozicionet e tyre. Mbi tokë kish rënë një natë e lagësht dhe e errët, ndërsa në qiell vozitnin masa të rënda resh që mbartnin rrebeshe shiu. Myrtezai me Vehapin zunë vend në brigjet e lumit, dhjetë-pesëmbëdhjetë metra larg njëri-tjetrit. Pas shelgjishteve dhe shkurreve rrëshqitnin me murmurime të mbytura ujërat e fryra të lumit.

«Përsëri në vigjëlím, mendonte Myrtezai. Si është kjo puna e njeriut! »

Nga zemra i qe davaritur ajo ndjenjë malli e ndarjes, që e kish pushtuar gjithë atë ditë. Përtypte një

fije bari i shtrirë barkas me vështrim të ngulur diku përpara nëpër natë. Konturet e bregut tjetër mezi shqueshin. Ja, ai sonte po rrinte prapë këtu, si në kaq e kaq net të tjera. Ishte përsëri kufitar, kurse gjithë ato ditë pat menduar për ikjen, për rrugën, për maqinën që i priste diku e që do t'i çonte nëpër shtëpira. Dhe kjo ishte e çuditshme, ishte përsëri kufitar në një kohë kur s'e pat shpresuar kurrë. Desh t'i thosh diçka Vehapit, por Vehapi ish larg dhe ai e dinte se s'duhej të bënte asnjë lëvizje të tepërt. Shoku i tij, dhjetë-pesëmbëdhjetë metra më tutje, qe strukur në ca gëmusha dhe s'jepte shenja jete fare. «Një kufitar i vërtetë ky Vehapi, mendoj me një ndjenjë krenarie Myrtezai. Dhjetë hapa nga unë s'ndjehet i gjallë». Përballë, në tokën e shtetit tjetër, dukej një shtëpi prej guri, fare pranë bregut të lumit. Konturet e asaj shtëpie nxinin në atë natë vjeshte, e të gjitha dritaret e saj ishin të errëta si sy të verbëri. Myrtezai kontrollonte bregun e lumit, shtëpinë, kopshtin përreth saj, një rrugë që zbriste në rrëpirë.

Befas, era i lëkundi fort shelgjet. Vrundulli i saj i fuqishëm oshëtiu një hop duke marrë përpjetë rrjedhës së ujërave. Pastaj, prapë u bë qetësi. Në këtë qetësi të thellë nate u dëgjua diçka rrëshqiti në bregun tjetër të lumit. Pas kësaj u bë një heshtje e gjatë. Pastaj, në kopsht u dukën ca veta që zbrisnin ngadalë drejt bregut të lumit e mbanin në duar diçka të stërmadhe.

Myrtezai i hodhi një gur të vogël Vehapit. Edhe ai ja ktheu përgjegjen po me një gur të vogël që do të thoshte se kishte parë gjithshka.

Njerëzit e anës tjetër hynë në mes të gëmushave dhe dolën buzë ujërave. Lëvizjet e tyre ishin të matura, të fshehta. Ajo që mbanin në duar, teksa ecnin të përkulur, ishte një varkë, të cilën e lëshuan në ujë me kujdes dhe pastaj nisën të përgjonin. Ishin tre ose katër veta të kërrusur pranë varkës.

Ndenjën ashtu një hop të gjatë.

Në një dritare të shtëpisë përkarshi, në tokën e

shitetit tjetër u duk për një çast të shkurtër një dritë, që u ndez dhe u shua menjëherë.

«Ky është një sinjal», mendoi me vete Myrtezai i shtrirë mes gëmushave me automatik përpara.

Dhe me të vërtetë, pas këtij sinjali, njerëzit e bregut tjetër hipën në varkë e nisën të vozisnin në heshtje drejt bregut tonë. Myrtezait i ra diçka e lehtë përpara, ishte një guriçkë sinjali oë ja hidhte Vehapi. I hodhi dhe ai një gur të vogël dhe shtriu përpara armën. Plani ishte ky: Mbi varkën s'do të hapnin zjarr. Diversantët do të liheshin të futeshin në tokën tonë. Si të largoheheshin nga varka e të nriuteshin në bregun, do t'u thërritej që të dorëzoheshin. Nëse ata s'do të dorëzoheshin e do të rendnin te varka, atëhere do të hapej zjarr. U mor vesh me Vehapin për këtë plan dhe nisi të priste.

Ata që vinin, nisën të shquheshin më qartë dhe dalloheshin që ishin katër. Njëri voziste me kujdes të madh, kurse tre të tjerët ishin strukur e shikonin përpara.

«Sigurisht që kanë dhe të tjerë që i ruajnë», mendoi Myrtezai e ja nguli sytë dritareve të shtëpisë përkarshi. Po atje s'dallohej asnjë shenjë.

Në mesin e lumit varka u ndal një hop. Rrjedha e merrte poshtë e, ai që voziste, përpiqej me lopata ta mbante në vend. Pastaj ajo u nis prapë drejt bregut tonë.

Myrtezait ju duk sikur kaloi një kohë shumë e gjatë gjersa ajo mbërriti. Dikush nga diversantët u hodh në ujë pa bërë zhurmë dhe nisi ta tërhiqte varkën. Pastaj të katër ata dolën në breg. U kërrusën pas ca gëmushave dhe kaloi një kohë tjetër e gjatë gjersa u ngritën e nisën të ngjiteshin në rrëpirën e lumit. Ecnin larg njëri-tjetrit, duke u fshehur pas drurëve. Gjithshka po shkonte në rregull. Si ta kalonin pritën, Myrtezai me Vehapin do t'u prisnin rrugët që i çonte te varka dhe do t'u bërtisnin të dorëzoheshin. Sakaq, do të vinin shumë kufitarë të tjerë në ndihmë të tyre. Puna ishte që asnjëri të mos u humbte nga sytë.

Diversantët kaluan rrëpirën majtas e djathtas kufitarëve që përgjonin. Pas shëlgjeve të bregut ishin ca gjerde ferrash që po i zhvishte vjeshta. Të katër ata ju afruan një gardhi, kurse Vehapi dhe Myrtezai u pre-në rrugët e kthyen armët nga ata. Nuk ishin veç një-zet-tridhjetë metra larg.

Përmes errësirës, u dëgjua zëri i fortë i Vehapit:

— Dorëzohuni! Jeni të rrethuar.

Tre nga ata u shtrinë menjëherë e hapën zjarr, kur-se njëri nisi të rendte drejt shëlgjeve. Myrtezai e futi në shënjestër dhe i lëshoi dy breshëri të shkurtëra auto-matiku. Ai që vraponte, shau, u orvat të kthehej që të hapte zjarr, po s'arriti. U këput e ra në një lëndinë duke u përpjekur. Vehapi shkëmbente breshëri me tre të tje-rët që ishin shtrirë. Myrtezai ndërroi vend shpejt e shpejt e nisi të shtinte dhe ai. Plumbat e diversantëve përpla-seshin nëpër drurë e çanin ajrin me vërshtëllima të mprehta.

Papritmas, nga shtëpia e bregut tjetër nisi të që-llonte një mitraloz me breshëri të gjatë. Ky mitraloz villte pa pushim zjarr nga një dritare e plumbat u bi-nin kufitarëve sa para, prapa. Po në këtë kohë, drejt dritares që villte zjarr, nisi të shtinte automatiku ynë. Pastaj një tjetër, një tjetër... Dëgjoheshin hapat e nxi-tuara të shokëve që vinin në ndihmë. Nuk kaloi shumë e mbi diversantët e strukur bubulloi një zë tjetër. Myr-tezai e njohu, ishte komandanti. Në raste të tilla ko-mandanti bëhej si bishë.

— Dorëzohuni! — u thirri ai dhe pas kësaj një tu-fë automatikësh nisën të shtinin kundër tyre.

Diversantët e prenë zjarrin dhe u çuan në këmbë me duar lart. Kishin mbetur dy. Kurse nga dritarja përkarshi mitralozi vazhdonte të villte zjarr.

Myrtezai u kthye me vull nga ky mitraloz e nisi të shtinte. Dhe Vehapi u kthye nga mitralozi. Pastaj, drejt tyre nisi të vinte një grumbull siluëdash. Këto silueta nxitonin të kërrusura me armë në dorë dhe zinin pozicion e hapnin zjarr kundër mitralozit. Vinin kufi-

tarë të vjetër e të rinj duke nxituar anës gjerdeheve nëpër natë. Afër Myrtezait erdhi e zuri vend komandanti. Myrtezai dalloi lëvizjet e tij të shkathëta, trupin e tij që u lëshua në hendek dhe pastaj nisi të shtinte. Me dhjetëra batore shtinin kundër armikut, që hapte zjarr nga shtëpia përkarshi, matanë ujërave të lumit që rridhnin në shtratit e gjerë. Dhe, si kaloi një hop, mitralozit heshti. Ndonjë plumb nga tanët e detyroi atë të heshte. Pas kësaj edhe automatikët tanë heshtën. Tani, pas gjithë asaj zhurme armësh, dëgjohej prapë era e lagësht vjeshtake, që shushurinte nëpër shelgje.

— Të lumtë, bir! — dëgjoji Myrtezai zërin e trashë e pak si të ngjirur të komandantit. Vehapi, dhjetë-pesëmbëdhjetë metra më tutje, ishte çuar në gjunjë e vështrimin ja pat ngulur bregut të përtejme. Automatikun e mbante në duar dhe mundohej të shquante ndonjë lëvizje matanë lumit. Oficeri i vjetër Ibrahim Skënderi nxori kutinë dhe futi një shuk duhan në bulçi. Ai, i regjurr në detyrën e tij në kufi, nuk ndizte kurrë cigare në net si kjo. Futte një shuk duhani në bulçi dhe niste ta përtypte.

Tri orë më vonë, kur një pjesë kufitarësh po kthehej në postë, komandanti ju afrua Myrtazait dhe i hodhi dorën në qafë.

— Ja, — ja bëri me një zë të butë dhe të dhëmsur — ma bëj kabull që u hëngrëm me fjalë.

Myrtezai nuk foli, po shtriu krahun dhe ja hodhi komandantit në sup. Vehapi vinte pas tyre, i heshtur e i menduar. Diku ai psherëtiu.

— Vehap! — i tha komandanti.

— Asgjë, komandant! — ja bëri Vehapi. — Po ja, u mësuam dhe... si do të ndahemi?

— Ne nuk ndahemi, — e qërtoi komandanti — kurrë nuk ndahemi.

Era e lagësht, që sillte shiun, u shpupuriste flokët e larushuar nga thinjat, kurse në horizont ndizeshin e shuheshin dritat e largëta të vetëtimave. Komandanti u ndal, i vuri dorën tjetër në sup Vehapit dhe vazhdoi:

— Ne këtu do të vijmë të gjithë, po t'i duan këto

troje. Këtu jemi gjithmonë — dhe shtriu vështrimin larg në malet që herë-herë ndriçoheshin nga vetëtimat. Nën këto vetëtima që përflakin horizontet e largët, të dukej sikur i gjithë atdheu rrinte zgjuar e vigjëlonte me shigjeta të zjarra për të përzhitur cilindo që do të guxonte të na prekte.

GEZIMI I NJË NATE ME DRITË

— Or baba Muç! Unë kam dy javë që s'kam zbritur në shtëpi, ndërresa të tjera me vete nuk kam, atë punën e asaj ngatërresës me dyqanin e kam. Por, po deshe të mos më lësh, mos më lë. Ti e di.

Ky që thoshte këto ishte një djalë i ri flokëverdhtë e i shkathët, me fytyrë të ëmbël e të bukur, me vështrimin të zjarrtë e të mençur.

Ai tjetri që një plak i thyer, kokën e kishte borë të bardhë nga thinjat dhe hijen e kishte të rëndë e të vrazhdë.

— Po baba Muçi sa kohë ka pa zbritur në shtëpi? Po baba Muçi nuk do ndërresa, një nevojë a një hall nuk e ka? Shiko, të thashë një herë që sonte do të zbres unë e mos më çaj më kokën.

Djali mblodhi këmbët nën vete dhe këputi një fije bar. Plaku, që mprehte nagaçen me gri, nisi t'i mëshonte më fort dhe e vari më shumë kokën te puna e vet.

— Sonte vetëm, or baba Muç! Pastaj shko ti, rri dy ditë po deshe — tha djali me ton lutës.

Atëhere plaku nuk ja vari më. Mprehu nagaçen dhe u ngrit. Djali e ndoqi me sy, po ai as e ktheu më kokën për ta parë dhe iku drejt stanit, ku kërcisnin kusitë e dëgjoheshin muhabetet e çobanëve.

Djali e kuptoi se ishte e kotë t'i lutej më. Plakut i

pat hipur në kokë që të zbriste vetë atë mbrëmje në fshat dhe nuk ish e mundur që ta ktheje. «Po ç'e gjeti kështu, xhanëm, mendoi me vete. Sa herë i kam thënë, kur kam pasur një punë a një hall, ai s'ma ka prishur kurrë, kurse sonte...».

U ngrit dhe çmptiu këmbët. Vuri duart prapa belit dhe u shtriq, duke shikuar rreth e rreth largësitë që po mjeçulloheshin nga mbrëmja. Nga maja e Dalmorit, që ngrihej si një masiv i madh e i vrazhdë, rrokulliseshin drejt pllajave me bar frushullues të Bidokës togje muzgjeshe e hijesh të errëta. Atie në vathë blegërimat e dhenve po rralloheshin e po përgjumeshin dhe tani, si të shuhej dhe ai i kuq i lehtë, atie larg në qiellin e perëndimit, kudo përreth do të binte nata e lehtë dhe transparente e verës.

Plaku doli nga stani me një bohçe në dorë. Diç u tha çobanëve që dolën jashtë bashkë me të, pastaj kapërceu koritat dhe u nis duke shkelur me nxitim në udhëzën e ngushtë përmes livadhit. Pas ju ngjiti, Ballabani, një qen i vjetër stani që gjithë ditën e ditës flinte nëpër hije. Po plakun qeni e donte shumë dhe nuk ish e mundur të mos e nuhaste sa herë që ai nisej për rrugë të largët. Edhe tani, me të parë që baba Muçi vuri bohçen në shkop dhe u var tatëpjetë livadhit me bar të gjatë, kërceu nga strofka dhe shkoi pas tij, duke kuitur e tundur bishtin plot gëzim.

«E, më ndjeve?» ja bëri plaku, kur Ballabani e çiku në pulpë me turinj.

«Ta kisha lënë dhe atë shejtan të shkonte në shtëpi! mendoi pastaj për djalin. Por ç'bëri sonte, ç'bëri nesër mbrëma! Ja, në mëngjez kthehem unë e le të niset ai».

Kurrë baba Muçi nuk kishte nxituar si sonte drejt shtëpisë. I ngjante vetia sikur qe gjallëruar përnjëherësh dhe e mundonte kureshtja si një fëmijë që rend drejt një bregoreje për të parë hapësirat e reja që shtrihen matanë. Dhe ai rendte sa të dilte te Shkëmbi i Vajzës. Me qindra apo mijëra herë i kish rënë rruga të kalonte nëpër këtë shkëmb, me qindra apo mijëra herë

i pat parë grumbujt e shtëpive, që dukeshin atje poshtë, arat buzë përroit, korijet dhe lirishtat, rrugët dhe kopshtijet. Gjithë jeta e baba Muçit kish rrjedhur në këto skërka, ja, në këtë rrugë nga fshati gjer te stanet e nga stanet gjer në fshat. Dhe megjithatë sonte s'e mbante dot veten, po nxitonte duke shkëlur kuturu, nëpër rrugët e ngushta plot gurë. Ballani herë i dilte para e herë mbe-tej prapa dhe baba Muçi i foli nja dy herë me të egër, se e pengonte dhe mend e rrëzonte në ato monopate të thepisura.

Po ja më në fund dhe Shkëmbi i Vajzës. Baba Muçit ju ngadalësuan hapat. Që këtej, si të bëje dhe pesë-gjashtë çapa, dukej grumbulli i shtëpive. Këto shtëpi bënë një lagje të largët, fare të largët të fshatit. Plaku aty pat lindur e aty qe rritur. Aty patën lindur djemtë e vajzat e tij, nipërit e mbesat dhe me mendje këto shtatë-tetë shtëpi ai i quante si një fshat të vogël më vete. Dhe ai qe më plaku aty dhe të gjithë i thërrisnin baba Muç. Rreth e rreth kësaj lagjeje ngriheshin male të larta dhe dimrit rrugët i zinte bora. Baba Muçi nuk e pat ndjerë ndonjëherë këtë largësi nga pjesa tjetër e fshatit. «Ja, tokat s'janë të këqija, vend për të kullotur bagëtinë kemi», mendonte. Po në këto vitet e fundit punët patën ndryshuar. Fshati qe bërë kooperativë, njerëzit nisën të bënin shtëpi të reja, rruga e maqinës erdhi gjer te kryesia e kooperativës, nisën të vinin maqina për të shirë, traktorë, maqina për të shkoqur misër. Kurse në këtë lagje të gjitha këto e kishin të vështirë të vinin. Baba Muçi bëri dhe ai nja dy kornakë të rinj, po tjegullat i mbarti me mushka. Një maqinë për të shkoqur misrin e sollën në krah një tufë burra që ju bënë supet plagë. Traktori erdhi, po si erdhi thuaj. Atëhere baba Muçi shkoi te kryetari dhe i tha:

— «Po ne të njerëz jemi?

— Pse të njerëz?! — i tha kryetari.

— Po rruga s'do të vijë edhe te ne?

— Do të vijë, or baba Muç, po me nga dalë një herë.

Ju jeni në anë fare, kaq kollaj qenka?

— E, e, — ja pat bërë plaku — të ishte kryesia atje

te ne, do ta bënit që ç'ke me atë punë, po nejse».

Në vitet e fundit plaku kishte nisur ta ndjente largësinë e kësaj lagjeje nga qendra e kooperativës. «Larg jemi ngulur, ç't'i bësh?»

Pastaj kishte nisur elektrifikimi.

«Aha, pat menduar ai, këtu zor se kemi hise».

Baba Muçi shihte nga pllajtat e Bidokës se si po ndizeshin dritat fshatrave me radhë. Në fillim ata të largët, atje tej grykave dhe valmares së Dalmorit, pastaj elektriku po vinte përditë e më afër. U ndezën dritat dhe në Dreveshën e Vogël dhe në Dreveshën e Madhe, dy fshatra afër njëri-tjetrit në kurrizin e një mali të butë. Festë, po çfarë feste që bërë atë natë. Që andej vinin gjëmimet e daulleve dhe baba Muçi rrinte te dera e stanit dhe thosh me mendje se dasmë si kjo s'që bërë herë tjetër në ato anë. Krisnin pushkët dhe gjëmonin daullet. Shtinte Drevesha e Madhe dhe i përgjegjei Drevesha e Vogël, shtinte Drevesha e Vogël dhe i përgjegjei Drevesha e Madhe.

Patën thënë se dritat do të vinin dhe tek ato shtatë-tetë copë shtëpi të lagjes së baba Muçit. Inxhinieri tha se do të shtroreshin katër kilometra linjë, zor që vërtet, po dritat do t'ua sillnin. Plaku pat buzëqeshur me qesëndi. Por linja kish filluar të shtrohej. Me mendje të vet plaku mendoi se këtë linjë e shtronin për ta çuar te sharrat, në Qafën e Limerit. Por linja po vinte drejt lagjes dhe shtyllat po afroreshin përditë e më shumë. Plaku rrinte te bagëtia në mal dhe dëgjonte herë pas here nga goja e djemve se dritat po vinin.

— «Ehu! Sharrat po, po ne zor s'e kemi hise — thoshte ai.

— Po ka thënë partia se dritën do ta marrin të gjithë, or baba Muç — i thoshin djemtë.

— Ka thënë, or bij, po dhe kaq tel për shtatë-tetë copë shtëpi nuk harxhohet». Dhe djemtë e stanit, kush dy e kush tre zbrisnin përditë e ndihmonin në punën e linjës dhe i sillnin që andej lajme të reja. Dhe ja më në fund sonte ishte festa e dritave në këtë lagje të vogël. Që në mëngjez i patën thënë se dritat u ndezën të gjithë, po plakat nuk i besohej.

Doli në krye të Shkëmbit të Vajzës dhe hodhi sytë poshtë: Oj, oj! Shtëpitë sikur qenë bërë të reja nga ajo dritë e bukur që shkëlqente dritareve. Gjatë rrugës kishin vënë nja dhjetë-dymbëdhjetë drita dhe plakut ju dukën të bukura dhe gjerdhet, dhe gomradat e gurëve buzë rrugës. Dhe në oborre kishin vënë drita. Në odën e madhe të Selaudinit qenë mbledhur të gjithë dhe që andej dëgjoheshin ca këngë si në kohë dasme. Ballani, që pat mbështetur brinjët në këmbët e plakut, kishte zgjatur trupin përpara dhe shikonte atje poshtë me veshë të ngritur bigë.

«He, edhe ti s'e njeh, ë?» ja bëri baba Muçi duke e shtyrë qenin me gju.

Plaku nisi të zbriste tatëpjetë dhe Ballani rendte përpara. Kur hynë në lagje, baba Muçi ndali te shtylla e parë dhe vështroi llambën atje lart. E vështroi një kohë të gjatë, sa sytë ju lbyrën, pastaj kapërceu një shteg dhe u nis drejt shtëpisë së Selaudinit.

Në oborr ndali përsëri, pa dritat e dëgjoi këngët brenda në odë. Ish si i hutuar dhe nuk u besonte syve. Në këtë oborr të Selaudinit, kur milnin bagëtinë natën, nuset dilnin me kandil në dorë dhe shkonin në kasolle. Kurse tani, nga drita e madhe që qe vënë në krye të shkallëve, dukeshin edhe gurët atje larg te gryka e pusit.

Ngjiti shkallët dhe hyri në odë:

Njerëzit i prenë këngët dhe shikuan nga ai.

— E, baba Muç? — ja bëri Selaudini me sy që i shkëlqenin.

— E — ja bëri dhe plaku si i hutuar.

Selaudini erdhi drejt tij me një gotë raki në dorë. Plaku nxori dorën përpara.

— Prit — i tha.

Shikoi rreth e rreth.

— Prit, prit, — përsëriti — kam një lutje. Dua të më vini në shtëpi.

— Po këtu janë të gjithë — tha Selaudini.

— Mirë, mirë, po hajdeni tek unë.

Dhe bëri përpara. Pas i shkuan gjithë sa qenë.

Dhe në oborr të vet baba Muçi pa dritë. Dritë kishte dhe në të gjitha odat. Hynë në odën e miqve dhe plaku u ul në qoshe. U ulën dhe të tjerët rreth e rreth, duke zhurmëruar e duke biseduar me zë të lartë.

— Dëgjove? — i thirri plakës baba Muçi.

— Nuk ka emër ajo, or baba Muç — i tha Selaudini.

— Ka. Oj Bali — e thirri me emër të shoqen ai dhe të gjithë qeshën me gjithë zemër. Qeshi dhe plaku, duke mbajtur dorën para gojës. Brenda hyri Bali, një plakë e imët dhe e mirë.

— Hë, e prure kokën që andej? — i tha ajo, duke dashur të vazhdonte shakaja.

— Dëgjo këtu — i tha ai. — Pa ma bjerë pak kandilin!

— Pse, s'të del gjithë kjo dritë?

— Jo, bjere, bjere!

Plaka doli dhe solli një kandil të madh me dy veshë. Baba Muçi e ndezi dhe e vari në gozhdën e vet. Tymi nisi të rrihte përsëri atë pjesë të murit blozë të zezë.

— Shuaje dritën — i tha pastaj një djali.

Të gjithë çuditeshin me sjelljet e këtij plaku. Po qejfin nuk ja prishnin. Drejt çelësit shkoi një djalë i ri dhe shoi dritën.

Pas një çasti të gjithëve ju duk se plakosi errësira e plotë. Po pastaj sytë u mësuan dhe nisën të dallonin fytyrat e atyre që ishin rreth e rreth, nën dritën e flakës së kandilit që luhatej sa majtas-djathtas.

Plaku zgjati dorën dhe mori kandilin. Të gjithë tani heshtnin dhe mbanin frymën.

— S'ma mori mendja se do të vinin dritat edhe tene, — tha ai — pse të gënjej, s'ma mori mendja. Po ja...

Ngriti kandilin lart, vështroi andej nga fundi ku rrinte një grumbull djemsh e vajzash në këmbë, pastaj i fryu dhe e shoi. Oda u krodh në errësi të plotë.

— Ndizeni tani, — tha e diçka ju drodh në zërin e trashë — ndizeni or djem, ndizeni!

Çelësi bëri trak dhe oda shkëlqeu nga drita e fortë. Baba Muçi ju kthye Selaudinit dhe i tha:

— Nxirre nga brezi dhe futi tre fishekë!

— Posi!

Selaudini hovi në këmbë, nxori revolverin dhe i futi tre fishekë. Baba Muçi e mori armën në dorë, hapi dritaren dhe shtiu tri herë; krismat morën grykat dhe jehuan gjer tej.

— Të na rrojë Partia! — tha dhe u ul në qoshe. — Tani merrjani sa të tundet. Dhe dua daulle. Bini daullen këtu që ta dëgjojnë të gjithë se ne sonte kemi dasëm të madhe.

Dy djem dolën jashtë. kurse Sadiku i Fahriut nisi të këndonte. Pas tij u hodh një zë i dytë dhe pas kësaj gjëmoi një iso e shtruar dhe plot kumbim. Plaku vështronte djemurinë me ata sytë bojë hiri që i ndritnin nën vetullat e bardha. Kurrë nuk kishte qenë i gëzuar si sonte. Kroi zërin dhe u fut dhe ai në iso. duke përkulur trupin përpara e duke tretur vështrimin në kujtime. Kënga bënte fjalë për dy djem nënash që patën mbetur dëshmorë në një luftë në mes të dimrit. Dhe kjo iso e gjerë dhe e fortë vinte si një rrapëllimë lufte, që zbriste nga grykat e maleve.

Pastaj diku nisi të dëgjohej daullja. Djemtë po vinin dhe i binin asaj me sa u hante krahu. Baba Muçi u ngrit. hapi dritaren dhe shikoi jashtë. Dum-dumi po afrohej dhe ai shihte gjerdanin e bukur të dritave që vargëzoheshin gjatë mezhdave të rrugës. Pastaj sytë i rrëshqiti nga e djathta dhe pa atje larg Dreveshën e Vogël dhe Dreveshën e Madhe që llamburitnin nga qindra pikëza të florinjta. Dhe më tej akoma — fshatra të tjera plot drita të tilla që mbushnin natën me një gëzim të çuditshëm.

— Na këndonin një këngë për dritën! — u tha pastaj djemve dhe u ul në qoshen e vet.

NJË VAJZË QË ERDHI NË DIMËR

Fatriu ngrihej i pari dhe dilte nga dhoma pa zhurmë. Ai e kishte punën larg. Rama dhe Ndreçi flinin edhe ca. Po pastaj nisin zhurmat e mëngjezit dhe ata kthenin fytyrat nga njëri-tjetri e ja bënë me shenjë «E, shkoi ora?»

I dyti ngrihej Rama. Ai vinte plitkën të ziente çaj dhe shikonte nga dritarja. Atje, matanë rrugës, dukej dera e një fqinjë të bukur. Ajo shkonte në punë dhe Ramës ja kish qejfi ta shikonte kur kalonte rrugës me atë hap të vogël e të bukur.

Ndreçit mezi i dilte gjumi. Ai hidhte batanien kraheve dhe rrinte këmbëkryq mbi krevat.

Porta e fqinjës kërciste, Rama afronte fytyrën pranë xhamit dhe e ndiqte me vështrim derisa ajo zhdukej te kthesa e kinemasë. Pastaj i kthehej Ndreçit, që rrinte si i kotur me sy të ngulur në një pikë, dhe i vërsëllente: «Fiu!»

Ndreçi çonte buzën në gaz dhe Rama deklamonte:

— Zgjohu! Mëngjezi me shigjetë e grisi parden e natës...

— E, moj, ti, mjaft me këtë Ymer Kajani tënd!

— Omar Kajami, tutkun, jo Ymer.

— E de, njëlloj është. Omar, Ymer...

Si pinin çaj, Rama shkonte në zyrë, kurse Ndreçi ja hipte kamionit për në oficinë.

Fatriu ishte teknik-gjeologu i ndërmarrjes e vërtitej sa në një ekspeditë në tjetrën për të kontrolluar punimet. Rama punonte në llogari e për këtë i patën ngjitur nofkën «kancelari i hekurit i financës». Kurse Ndreçi ishte teknik-mekanik dhe merrej me riparimin e sondave në oficinë. Gjithë ditën e ditës ata nuk shiheshin me njëri-tjetrin. I mblidhte mbrëmja dhe në mbrëmje ndiznin sobën e piqnin gështenja. Fatriu i lodhur shtrihej buzë krevatit dhe dremiste. Pas pak ai ja niste gërhimës. Ndreçi e kapte për bërryli e i thoshte:

— E, mo, mjaft me këtë vorbe, de.

— Lërmë ta tremb një çikë — i thosh tjetri, duke buzëqeshur i përgjumur.

— Për ta trembur, o? — hidhej Ndreçi. — Për ta trembur ke hall ti?

Ulej në dysheme, vinte këmba-doras drejt Fatriut dhe ja bënte përpara fytyrës:

— Hum, hum, hum! E, mo, iku?

Rama shkrihej së qeshuri. Fatriu shihte, ç'shihte e ngrihej.

— Të mori dreqi, or Ndreç! Ku të lë ti?

— Të lë, thotë. Hë, mo Ramë, thuaje atë «... në gjumë e në varr...» si është ajo puna e Ymerit tënd?

— Ymer... Omar, more gdhë.

— Djalli ta marri de, Omari, po mengadalë me ato gështenja, se do të plasë ndonjëra në gojë e do t'i bëjë dhëmbët përshesh.

Po kishte mbrëmje kur ata bisedonin për diçka tjetër e në këto raste Ndreçi i frynte zjarrit e dëgjonte i heshtur. Rama tregonte për një vajzë që e kishte njohur në një qytet, si qenë prezantuar, si i qe afruar ky e ç'i kishte thënë ajo. Atë e quanin Vera dhe Fatriut e Ndreçit u bëhej sikur e kishin të gjallë përpara syve fytyrën e saj të ëmbël, kaq mirë tregonte Rama. E dinin si fliste, si mernte frymë e bile si tundte kokën apo dorën kur i thoshte diçka Ramës. Kjo vajzë e largët qe bërë një piesëtar i katërt i asaj dhome. E kishin dëgjuar ndoshta për të njëqindën herë historinë e saj

e. sa hapte gojën Rama, ata e plotësonin me mend ato që vinin më pas.

«... Ah, ç'qenke ti! — i thosh ajo Ramës dhe qeshte me admirim për zgjuarësinë e tij. — Pse s'më thua hajde të shëtisim, po përdor diplomacinë?»

— Më fal pra, për diplomacinë — i thosh Rama. — A ka mundësi të shëtisim bashkë?» Ajo qeshte, u jepte flokëve me kokë prapa e dilnin në shëtitje. Rama i kapte dorën. «Ç'djall që është ky Rama. E ka gjuhën brisk», mendonte Ndreçi dhe i frynte zjarrit. Një buzëqeshje e hollë i endej në fytyrën eshtake.

— ...Pastaj hymë në një pasticëri dhe atje e qerasa me sheribrand — tregonte Rama.

«Jo me sheribrand, po me akullore», plotësonte me mend Ndreçi. Atij i kujtohej fare mirë se kështu e kishite treguar në fillim Rama, po tani mbase e ngatërronte. Bile Ndreçi e kishte të gjallë para syve Verën se si merrte në dorë akulloren, si e lëpinte me ato buzët e bukura e si merrte frymë, duke parë rrugën nga xhami i pasticërisë.

Kur vinin letra nga Vera, Ndreçi ulej këmbëkryq mbi krevat, nxirrte briskun e gdhendte diçka. Ai e dinte se Rama, si ta lexonte vetë, do t'ua lexonte dhe atyre e mudohej të mos e tregonte veten të paduruar.

«I dashur Ramë», lexonte Rama. Ndreçi gdhendte. Si mbaronte së lexuari letrën, ai futte briskun në xhep e dilte përjashta për të marrë dru. Ndreçi s'desh ta dëgjonte Ramën që zakonisht pas leximit të letrës thoshte: «E, dhe këto vajzat! Tregohen sikur lënë kokën për ty, po nga ana tjetër kushedi se ç'bëjnë».

Në atë qytet të vogël verior po vinte dimri. Në malarë bora e parë dhe po afronte koha kur edhe çatitë do të zbardhnin një mëngjez çarçafin kristalin. Mëngjezet gdhinin me mjegull, kopshtijet mbetën gollomesh nga gjethet që i rrëzoi era dhe nga Alpet zbrisnin thëllime të ftohta. Në një nga këto ditë Rama tha se do të shkente të merrte Verën. Si dhe qysh ndodhi kjo, as Ndreçi e as Fatriu s'mund të thoshin dot ndo-

një gjë. Ai që ngritur në mëngjes dhe kishte thënë se do të shkonte të merrte Verën.

Ditën që do të vinte Vera tek ata, ra bora e parë mbi pullazet e ulëta e mbi drurët mbetur shkretë në kopshtije. Sllogat e saj të bardha binin nga qielli i rimët, e shtroheshin ngadalë mbi tokën e ngrirë. Atje në brigjet e lumit, në kurrizet e ngritura, nisën të shquheshin bllanat e bardha. Në xhama sajoheshin bulka të bukura e hunjtë e gjerdheve vinin kësula e ngjanin si ca akullore të gjata.

Autobusi vinte në orën gjashtë dhe Rama u kishte bërë telegram që të dilnin e t'i prisnin.

Në oficinë u tha se kishte një punë e kërkoi leje të ikte një orë përpara. Erdhi në dhomë, shkundi bataniet, lau dyshemenë e preu një vandak me dru. Kjo do të ishte dhoma e Ramës me Verën tani dhe, gjersa ata të drejtorisë t'u gjenin një dhomë tjetër atyre, Ndreçi e kishte prerë me mend se do të flinte andej nga ofiçina.

Ndreçi e merrte me mend se si do të zbriste nga autobusi Vera, si do të linte valixhen në tokë e kushe-di, mbase do ta njihte edhe ajo Ndreçin. «Ama, e fortë, mendonte ai, kësaj i them dashuri unë. E do dhe s'pyet për asgjë. Vjen këtu sikur...» Po Ndreçi e kishte gjuhën të ngathët, në mend i vinin kaq e kaq fjalë po ajo djall gjuhe ja linte në mes. Kapte sëpatën e inatin ua nxirrte drurëve.

— Ndreçi! Bëjmë ç'të bëjmë e të marrim ndonjë gjë për darkë — i tha Patriu kur erdhi. — Është si punë dasme kjo, de.

Qe bërë pothuaj natë kur tek ura, përmes borës që binte e binte, u dukën dritat e autobusit. Ai qëndroi në agjenci dhe pranë kokës së Ramës Ndreçi dalloi edhe një kokë të bukur me flokë të errët e të gjatë. Ajo ishte ashtu si e kishte përfytyruar ai, veçse tani ajo ishte pak e lodhur, se helbete, gjithë ajo rrugë... bora... Zbriti Rama me valixhen, pastaj, që nga shkallët e autobusit, zgjati këmbën në borë dhe Vera.

— Mbamë pak! — tha ajo, po Rama po shkundte pallton Ndreçi e kapi për krahu.

— Falem nderit! — i tha Vera, — Oh, sa ftohtë qenka!

Shkoi pranë Ramës dhe përplasi këmbët që t'i ngroheshin.

— Këta janë shokët e mi, Vera — tha Rama si i mërzitur. — Ky është Fatriu, kurse ky është Ndreçi. Papa! Dhe kjo rrugë!

— Gëzohem — tha Vera dhe u dha dorën.

Ndreçi ja kapi lehtë gishtërinjtë e ftohtë, sikur të kishte frikë se mos ja thyente. Ata ishin si një tufë lulësh të njoma.

Pastaj ai mori valixhen dhe nisi të ecte pas Ramës, Verës dhe Fatriut. Vera kishte veshur një pallto të shkurtër si trekuart, këpucë me taka të vogla dhe shorape të holla. Nën dritat e rrugës trupi i saj dukej i vogël, i ajthëm. Ajo mbështetej herë pas here në trupin e Ramës, duke hedhur këmbët me vështirësi në borë. «Kurse ky Rama... i vjen zor, po s'rri pa ja shkuar krahun ai», mendonte Ndreçi.

Në dhomë zjarri që bëre bubulak e tryeza që shtruar.

Vera hoqi pallton e tani, me atë trikon ngjyrë hashashi dhe me shallin e hollë lidhur rreth qafës, dukej shumë e bukur. Faqet nisën t'i skuqeshin nga të ngrohët e nxori krehërin e rregulloi flokët.

Si hëngrën mezet e pinë ca verë, të katër erdhën në qejf. Fatriu u mbështet në kokën e krevatit dhe po i vinte gjumë. «Do që ta tremb një çikë», mendoi Ndreçi, po nuk u ul si në netët e tjera këmbadoras e t'ja bënte përpara fytyrës «Hum, hum...». Kështu e kishte menduar ai Verën: të urtë, me sv të qeshur e me profil të ëmbël. Sonte ajo nuk ishte diçka e largët që ngjallej në mendjen e tij, po diçka që e shihte, që e dëgjonte e bile... jo, jo, s'mund ta prekte. Ai mund ta prekte, po kushedi se si do t'i dukej Verës kjo.

Vera tregonte diçka brenda në dhomë dhe zëri i

saj ishte i butë, i butë e sikur binte mbi qetësinë e natës si ato sllogat e gëzuara të borës. Ndreçi shikonte natën e diçka jashtëzakonisht e ngazëlluar kishte pushuar zemrën e tij. Aty prapa derës ishte Vera. Po ai s'mund të rrinte këmbëkryq mbi krevat si në netët e tjera, e të nxirrte briskun për të gdhendur diçka, prandaj kërkonte sëpatën nëpër errësirë e pothuaj kishte harruar fare se atë pasdite preu një vandak me dru. Bile Ndreçi do të donte që të vinte dikush nga ofiqina, t'i thoshte se e kërkonin në ndonjë ekspeditë për të rregulluar sondat e ai do të shkonte më këmbë diku andej nga malet, ku bëheshin kërkime gjeologjike. Do ta rregullonte sondën, do të ulej pastaj në një qoshe të barrakës së sondës e do të nxirrte briskun për të gdhendur diçka. Atje larg, në qytet të Rama e Fatriu, do të ishte Vera e ai do të mendonte për ta.

— Ndreçi! Ku i le gështenjat? — e thirri Fatriu.

Ndreçi hyri dhe Vera tha:

— Po ju uluni! Dru kemi dhe rrimi të bëjmë ca muhabet. Pastaj ti, Ramë, pse nuk pret dru, po e lë shokun vetëm?

Ndreçi u ul e nisën të bënin muhabet. Herë-herë ai merrete gështenja nga soba, i qëronte dhe ja vinte Verës përpara.

— Faleminderit! — thosh ajo dhe njëherë e vështroi me vëmendje fytyrën e tij eshtake. Me siguri ajo i vuri re ata sytë e mirë të Ndreçit, se i buzëqeshi me dashamirësi.

Atëhere Ndreçi i tha Fatriut:

— Kujdes me ato gështenja, se do të të plasë ndonjëra në gojë e do të t'i bëjë dhëmbët përshesh.

Vera qeshi me të madhe, kurse jashtë binte borë. «Kush e gjen sëpatën tani», mendonte Ndreçi, ndërsa Rama që mbështetur pas kokës së krevatit dhe mendoj.

Që e shihte Verën duke qeshur dhe Ramën të menduar, kjo s'ishte gjë e re për Ndreçin. Kështu ai i pat parë me dhjetëra herë kur tregohej historia e tyre në këtë dhomë, ku kërciste zjarri bubulak. Zako-

nisht, në raste të tilla, Rama thoshte: «E, mo, dhe këto vajzat! Tregohen sikur lënë kokën për ty, po nga ana tjetër kushedi se ç'bëjnë». Ndreçin e zemëronte shumë kjo, po nuk i thoshte gjë. Futte briskun në xhep e dilte jashtë për të marrë dru.

Ishte bërë shumë vonë e shokët po bëheshin gati ta linin vetëm çiftin e ri.

— Epo... — ja bëri Fatriu e lëshoi duart e mëdha në tryezë.

Faqet i qenë skuqur e vështrimi i qe turbulluar nga vera. Ndreçi e kuptoi. Tani kishte kaluar mesnata, diku lehte një qen, angullimi i tij vinte nga largësitë e zbardhura nga bora.

— Bëfshi gjumë të ëmbël! — tha Ndreçi dhe u ngrit. Në mes të vetullave të tij qe sajuar një rrudhë e vogël. Rama luajti pak nga vendi dhe u dha dorën shokëve, kurse Vera hodhi pallton krahëve dhe i përcolli gjer jashtë. Nata ish e bardhë, bora pat pushuar e andej nga lindja, në horizontin e maleve thepa-thepa, po ngrihej hënëza e vonë, duke hedhur tufa lulësh të arta mbi pullazet që zbardhnin.

— Natën e mirë, Ndreçi! — tha Fatriu.

Ai do të flinte te dhoma e një shoku aty pranë udhës, kurse Ndreçi e kish prerë që më parë se do të flinte në oficinë. Atje ishte kolibja e rojes, në të ish një shtrat i ngushtë dërrase me tri batanie leshi e roja i kish thënë që të vinte aty.

Në krahun e djathtë të udhës, buzë lumit, ishte një park e në park Ndreçi shihte një dredhë rrezesh të arta që binin përmes degëve në kangjellat e shkreta. Atje, në pranverë ngrihej një gardh trëndafilësh, gonxhet e tyre ngjiteshin pas drunjve e hapnin me gëzim, duke u dredhur nga flladet e freskëta. Po tani trëndafilët ishin të thatë, bora e butë kish endur si me argjend një gjerdan të ngatërruar plot hije e dritë në atë natë të bardhë. Mbi park, në bregun që binte thikë gjer te kangjellat me kësula të vogla bore, dukeshin

shtëpitë që flinin, dukej porta e fqinjës së bukur me një zilkë në kanar si dhe dritarja e tyre, një dritare katrore që ende jepte dritë mbi oborrin me borë.

«Ende s'kanë rënë», mendoj Ndreçi. e mbajti hapat, duke u munduar të dallonte ndonjë lëvizje atje pas xhamave me dritë. Dhe vërtet, pas pak, dikush ju afrua dritares, zgjati trupin e Ndreçi dalloj një siluetë të brishtë, me leshra të bukura si një tufë manushaqesh, pa si e zuri hija e atij trupi gjysmën e dritares. Vera po varte një perde në gozhdë. Pastaj drita u shua e mbi çati hëna hidhte tufa trëndafilësh.

Kaloi urën e tanë rruga shkante në hijen e kodrës. Qeni angullinte diku në largësitë e bardha kredhur në heshtje.

Të nesërmen e zgjoi zhurma e çelësave të Otellos që hapte klubin. Ai hodhi sytë matanë xhamave të dritares së kolibes së rojes dhe dalloj banakierin e përgjurmur që pat mbështetur gjoksin pas derës e mundehej të hapte dryjtë. Tre dryj: dy të ndryshkur e me kanxha të mëdha, i treti i ri e me teneqe të kuqe.

Ndreçi hodhi bataniet mënjanë dhe hapi dritaren.

— Hë de, hape! — i thirri Otellos me buzë në gaz.

Tjetri ktheu kokën dhe zbardhi dhëmbët.

— S'më bëjnë duart, e mori dreqi — tha e vringëlloi çelësat.

Otellua ishte një burrë i gjatë, i zeshkët dhe me një përparëse doku me tiranta të trasha si sarafan.

Ndreçi u vesh dhe doli në oborr. Nën agun e mëngjezit vërtiteshin afshet e borës, që të përqethnin mishtë. Malet ngjanin si pirqje të bardha e të heshtura. Ai doli prapa barrakës, derdhi ujët e hollë, pastaj lau sytë te lambiku i Halit Rexhës.

— Ik, lanet, mjaft! — i thirri Haliti nga brenda, kur dëgjoj currilin e lambikut.

Ndreçi afroi fytyrën te xhami dhe i tha:

— A t'i fut ca borë?

— Ik dreqin, lëre!

Në klub Otelloja sapo kishte ndezur zjarrin për të bërë kafe. Kutërbonte erë e rëndë rakië dhe duhani. Tryezat qenë rrëmujë. pasi ishte bërë aty një darkë me sondistët e trupit numër 4. që kishin ndenjur gjer në orën një.

— Si u gdhive. Otello? — i tha Ndreçi.

— Ja, më lanë pa gjumë.

— Më bëj një kafe.

Ai shkoi e u ul mbi ca arka bosh. Te një tryezë aty pranë ishte ulur Sadri Leka, shoferi i drejtorit. Sytë i kishte të kuq dhe gogësinte.

— Edhe ju s'ja kaluat keq — i tha Sadriu Ndreçit. Si artiste filmi ishte. E pashë mbrëmë kur zbriti nga autobusi.

Ndreçi nuk i tha gjë. Sadriu muhabet donte dhe ai s'ja kishte ngenë. Po Sadriu s'hoqi dorë nga e tija.

— Ju vuri drunë Rama nga dhoma. ë?

— Ja liruam vetë — tha Ndreçi e nisi të rrufiste kafënë.

— Bravo. ju lumtë! — tha Sadriu dhe i shkeli syrin Otellos. — Këta janë shokë.

Po Ndreçi nuk ja kishte ngenë. Ai pagoi kafënë e doli. Halit Rexha kishte dalë të lahej te lambiku. Ai e kishte lidhur peshqirin si çallmë në kokë e sapuniste veshët.

Bënte ftohtë. Oborri i oficinës dhe oborret e fjetoreve aty pranë kishin gjysmë metri borë. Ndreçi u nis për në drejtori. Ata të ekspeditës së Lugjeve të Verdha kishin sjellë procesverbalet e ekspertizës dhe do t'i shqyrttonin në këshillin teknik.

Pas borës që ra pothuaj gjithë natën po lindte një ditë e qetë me diell të zbryllët. Shtrati i lumit sikur qe ngushtuar nga bora që kishte mbuluar zallet. Ndreçi ecte në një tragë që kishin hapur buzë rrugës punëtorët e karburantit dhe ata të baxhos.

Në drejtori ende nuk qenë mbledhur ata të ekspertizës dhe Ndreçi hyri në zyrën e Ramës. Rama kishte

dy fije letra përpara. kafshonte bishtin e lapsit dhe mendohej. Dukej i mërztitur.

— Si u gdhive? — i tha Ndreçi.

— Ç'ka, mirë! — ju përgjegj Rama me një zë të ngjirur.

Ndreçi as po e merrte vesh fare Ramën. Çfarë i pat ndodhur atij që dukej kaq i mërztitur?

— Po Vera si është? — e pyeti.

— Mirë — tha Rama dhe shtriu krahët në tryezë. Ndreçi vuri re manshetat e këmishës së Ramës dhe kollaron e tij të lidhur bukur. Flokët i kishte krehur me kujdes dhe qe rruar taze.

— Në dhomë e le? — e pyeti përsëri Ndreçi.

— Po ku ta çoja? — tha Rama si i bezdisur. Sytë i kishte si të errët nga mërzia dhe fytyrën e zbetë sikur ja përshkonte drita e një ironie të hollë.

Ndreçi nuk i foli më. U ul pranë sobës dhe nisi të ngrohte duart.

Këshilli teknik mbaroi punë aty nga ora dhjetë dhe Ndreçi u nis për në oficinë. Te dera e fjetores pa Verën që ishte mbështetur te pezuli dhe ngrohej në diell. Me sa duket ajo mërzhinte. E veshur hollë, me atë xhakëtë të shkurtër e me çorape setapura ajo me siguri mërzhinte. Fytyrën e kishte të zbetë dhe nën sytë e bukur i qenë sajuar dy lema mavi. «Çfarë kanë këta?» mendoi Ndreçi.

Shkoi drejt saj dhe e pyeti se çfarë kishte.

— Asgjë! — tha ajo dhe buzëqeshi pak me trishtim.

— Ke ngrënë mëngjez? — e pyeti Ndreçi.

— Po, hëngra — tha Vera dhe buza ja drodh pak, ndërsa mendohej të buzëqeshte.

Ndreçi ja nguli sytë drejt, ndërsa ndjente se diç kishin ata që qenë aq të mërztitur të dy.

«Hajvan dhe ky Rama, mendoi, si e ka lënë këtu vetëm, zjarr nuk i ka ndezur. t'i blejë një palë çorape të trasha në mend nuk i ka shkuar, ka ngrënë mëngjez a s'ka ngrënë, dreqi e di».

— Hajde — i tha.

— Ku? — e pyeti Vera më shumë me sy se sa me zë.

— Të hamë ndonjë gjë! — i tha Ndreçi. — Mëngjez kushedi nuk ke ngrënë, tani ora është dhjetë dhe mund të hamë ndonjë gjë.

— Jo, të falem nderit — tha Vera dhe kapërdiu diçka të rëndë.

— Mirë, pra! — tha Ndreçi.

Ai hyri në dhomë, i ndezi zjarrin, pastaj shkoi. U kthye tek ajo pas nja dhjetë minutash dhe i solli një palë çorape të gjata e të trasha të mbledhura në një letër dhe dy byreqe. Ja la në dorë dhe iku.

Pasdite, kur Ndreçi kthehej nga ofiçina dhe shkonte në mensë për të ngrënë bukë, e pa përsëri Verën që rrinte vetëm përpara fjetores. Rama kushedi ku ishte. Ajo e përshëndeti dhe i bëri një shenjë. Ndreçi ju afrua dhe ajo ja ktheu corapet, duke i thënë:

— Të falem nderit, po nuk mund t'i mbaj.

Ishte e qartë. Punën e çorapeve ajo ja kishte treguar me sa dukej Ramës dhe Rama i kishte thënë që t'ja kthente. Ndreçit i erdhi shumë zor, por i mori çorapet dhe iku.

Në mbrëmje ja dha Fatriut çorapet.

— A do t'i veshësh ti këto? — i tha.

— O, pse jo! — tha Fatriu. — Mrekulli fare. Po pse i bleve?

Ndreçi ja tregoi si qëndronte puna.

— Ku vajti dhe u ngatërrua me atë! — tha Fatriu.

Ishin ulur në tavernë e po pinin nga një raki.

— Pse? — e pyeti Ndreçi si me habi.

— Thonë se s'ka qëndruar mirë ajo — tha Fatriu. E njihnin nja dy nga ata shoferët e trupave.

Ndreçi nuk foli. I kishte ngulur sytë në një qoshe gjithë tm e zhurmë të tavernës.

— Është afër mendsh — vazhdoi Fatriu. — Ndryshe si do të linte qytetin e vet ajo e do të vinte këtu? Këtë s'ka si e pranon Rama. Ti e njeh Ramën.

— Të ëmën — psherëtiu Ndreçi i menduar. Atë sikur e zuri rakia përnjëherësh dhe kokën e ndjente të rëndë. Këtë dashuri të tyre ai e kishte spjeguar ndry-

she. Rama ishte një djalë mjaft simpatik dhe i zgjuar. Si mos ta donte një vajzë atë, qoftë dhe pse ai punonte në një qytet të vogël si ky?

Paguan dhe dëlëa. Nga Alpet kishte zënë të frynte një erë e ftohtë dhe gjithshka pat ngrirë. Termometri i madh në murin e postës shënonte 10 gradë nën zero. Pirgjet e borës qenë bërë parmakë akulli. Nga strehët e depos së NTSHAP-it varehin kulme të gjata. Afër urës u ndanë dhe Ndreçi u nis për në oficinë. Ai nuk e kuptonte gjithë atë mërzi që e kishte pushtuar. Nuk desh ta besonte se punët qëndronin kështu, por, me sa dukej, e vërteta ashtu ishte. Vera ishte një vajzë shumë e bukur, me sy të mëdhenj si bajame, me flokë të gjatë e të dendur. Dhe Rama shumë simpatik ishte, po nuk mund të giente një tjetër si Rama ajo andej nga vendi i vet? Thoshte se prindërit e kishin aprovuar dashurinë e saj. Po si i aprovokan kaq kollaj prindërit, kur vaja e tyre ikën 200-300 kilometra larg?

Të ëmën — psherëtiu dhe një herë Ndreçi me hidhërim të madh.

E nesërmja gdhiu me një lajm të ri: Rema e la Verën. Ai kishte marrë 15 ditëshin e lejes dhe kishte shkuar në fshatin e tij. Vera bëhej gati të kthehej prapë andej nga erdhi.

— Të iki vetë?! — e pyeti Ndreçi atë që i solli lajmin.

— Ka shofera sa të duash — tha tjetri me thumb.

Ndreçi ndjeu gjakun që i hipi në fytyrë.

«Jo, mendoj, kjo është poshtërsi. Derisa e mori, bënte s'bënte, duhet ta kthente vetë, nëse desh të ndaheshin. Kështu jo».

Mori një shuk leckash dhe fshiu duart.

— Mua më jep nja dy orë leje — i tha përgjegjësit të oficinës.

Përgjegjësi i oficinës, që nuhatte diçka, e hetoi me sytë e vëngëruar dhe i tha:

— Ç'i do këto dy orë leje?

— Kam një punë — tha Ndreçi.

— Po çfarë pune pra?

Ndreçi u ndodh ngushtë e desh, s'desh ja tha. Ai desh të shkonte gjer në qytet e të shihte se mos i gjen-te ndonjë maqinë për ta nisur atë ashtu siç duhej.

— A s'na lë rehat me gjithë atë! — tha përgjegjësi i pakënaqur — Boll halle kemi vetë, na duhej dhe ajo tani.

Pasдите vonë, kur mbaroi puna, Ndreçi mendonte se Vera kishte ikur. Ai kishte rrasur duart në xhepat e peliçes dhe era e lumit i rrihte fytyrën. Qielli ishte i vrej-tur, një vrerësirë e lartë ngjyrë plumbi që tregonte se do të binte prapë borë. Plepat e zhveshur, atje te sheshi i plazhit në zall të lumit, ngjanin si tym i hirtë. Bënte dimër.

Para postës kishin qëndruar dy «Skoda» dhe në parmacët e lulishtes verore, që tani dukej e shkretë, ki-shin vënë këmbët shoferët dhe bisedonin me njëri-tjetrin. Nga dera e bufesë, që ndodhej përballë, doli gati me një frymë Vera dhe shkoi drejt Ndreçit. Ky mbajti këmbët i shtangur nga habia.

— Po ti? — i tha. — Këtu qenke?

— Sa mirë që të takova! — tha Vera.

Ajo dukej e dobësuar, fytyra dhe buzët i qenë mavijosur nga cikma. Vetëm sytë e mëdhenj i shkrep-tinë një grimë.

— Hajde! — i tha Ndreçi dhe shkuan drejt klubit.

Në klub sikur u prenë përnjëherësh bisedat kur hynë ata. Po Verës nuk i bëri shumë përshtypje. Ajo eci me hap të sigurt përmes tryezave dhe kaluan e u ulën andej nga fundi. Pas tyre hynë edhe dy shoferët e «Skodave». Njëri nga ata, një kuqo me xhaketë lëkure, mbështeti bërnylin në banak dhe nuk ja hiqte sytë Verës.

— Kanë dy orë që s'po më ndahen — tha Vera duke shtrënguar buzët e duke përtypur një buzëqeshje plot brengë. Në tëmtha asaj i rrihte një damar i hollë.

— Kjo për të gjithë ju paska qenë një çudi, ë? — tha pastaj.

Sytë i qenë ndezur nga një zemërim i çuditshëm.

— Dëgjo — i tha Ndreçit. — Mund t'jua tregoj vendin vetë atyre, po s'mundem ta bëj tani. M'i qëro na sytë. të lutem.

Ndreçi brofi në këmbë, dhe, duke u lëkundur përmes tryezave me atë trupin e madh si ari, shkoi te banaku. E mbërtheu nga kyçi i dorës shoferin kuqo dhe e tërhoqi jashtë.

— Hë, byrazer, ç'do? — i tha shoferi.

— Nuk është mirë — i tha Ndreçi me të butë — Lëreni rehat, ju lutem.

Tjetri sikur u shkreh.

— A? — ja bëri.

— Ikni! Kur s'ju bie njeri në qafë, ç'keni që e trazoni?

Prapa krahëve të Ndreçit kishte qëndruar shoferi tjetër.

— Do të na ndalosh të rrimë në klub? — tha ai.

— Jo. Po ju bëni si të doni.

Ndreçi u kthye nga Vera. Nga ajo qenë kthyer shumë kokë që e vështronin në heshtje. Asaj i rrëshqiti një buzëqeshje e hidhur dhe tha:

— Më vështrojnë. Të gjithë më vështrojnë sikur të isha një njeri i zbritur nga Marsi. E mirë, Ndreçi, porosit dy raki, të lutem. Unë s'kam para, ika me mendje të ngritur.

Ajo kafshoi çipin e buzës fort dhe shtoi me një zë të trashur:

— Vija tek ëndrra ime. Sa e neveritshme më duket.

Ndreçi bëri porosinë dhe Vera piu gjysmë gotë me një frymë. Ndreçi sikur qe nemitur nga kjo dhe e vështronte me një lloj habie.

— Mos ki frikë — i tha Vera. — Nuk të turpëroj. Unë në mendjen e këtyre të gjithëve, mbase dhe në mendjen tënde, jam ngritur si një femër e ligë. Ç'kanë më shumë femrat e liga? Rendin nëpër botë me kë të mundin, ku ngrysen, nuk gëdhihen, pa strehë, pinë. A ta nderz dhe një cigare tani? Të betohem për gjënë më të shtrenjtë që s'kam pirë kurrë raki dhe duhan. Po tani do të pi. Më jep një cigare!

-- Nuk e pi — tha Ndreçi me vetulla të rrudhura.

— A, shumë mirë — ja bëri Vera, kur vuri re që Ndreçit s'i vinte aspak mirë. — Shumë mirë!

Asaj po i skuqeshin faqet dhe kishin zënë t'i ndritnin sytë. Qeshi nën zë, një e qeshur si e thatë dhe e hidhur.

— Vërtet iku ashtu Rama? — e pyeti Ndreçi, ndërsa i mbante sytë të ulur në mbulesë.

— Po, iku! — u përgjegj ajo ftohtë.

— Po pse?

— Sepse u zhgënjye. Më dinte femër të ndershme, po unë s'isha e tillë. Porositmë dhe cigare, të lutem. Ti s'e merr me mend sa bukur mund ta pì unë cigaren.

Ndreçi e vështroi drejt si me frikë. Si i fliste kaq hapur dhe pa droje ajo?

— S'e beson? — tha Vera. — Besoje! Është plotësisht e vërtetë. Do të porositësh cigare?

— Jo!

— E po në djall shko dhe ti.

Ajo desh të ngrihej, po kur vuiri re në sytë e Ndreçit një si perde të lëngshme, u topit dhe u ul përsëri.

— Ç'ke? — e pyeti me një zë të dridhshëm.

S'i besoj këto — tha Ndreçi. — Pse më gënjen?

Ajo u lëshua në shpinoren e karriges dhe trupi sikur i qe shkrifur përnjëherësh.

Pa shih! — ja bëri. — Paska një njeri që s'i besoka këto.

Uli sytë te jaka e trikos dhe bëri sikur po hiqte atje me gishtërinj një fije peri, po në të vërtet e kishte ulur kokën që të fshihte lotët. Ndreçi u drodh.

— Mbase Rama nuk ishte për ty — tha Ndreçi.

Ajo dënosi nja dy herë, pastaj fshiu sytë dhe u kthye nga ai.

— Po — tha.

— Ti e doje shumë atë. Ai na i lexonte letrat e tua.

Ajo ngrinte dorën lart dhe me këtë i thoshte: «Mjaft. Nuk dua të flasim fare për këtë».

— Dua të më bësh një të mirë — i tha. — Të më giesh një vend sonte për të fjetur dhe të më presësh një biletë për autobusin. Do të m'i bësh?

— Po — tha Ndreçi. — Patjetër.

— Të falem nderit shumë — tha ajo dhe i kapi dorën. — Ti je njeri i mirë.

Në klub hyri Sadri Leka, shoferi i drejtorit. Shallin e kishte lidhur reth fytyrës dhe që rruar taze. Ai kërkoi me sy nëpër klub, pastaj erdh drejt tryezës së tyre.

— Mirë mbrëma! — salutoi me kokë, pastaj iu kthye Ndreçit. — Duhet të nisemi sonte për në Serinë.

— Kush?

— Ti. Ka dhënë urdhër drejtori të shkosh në Serinë. Janë prishur dy sonda. Më tha të të marr e të të çoj atje.

— Po rruga e Serinës është e zënë — tha Ndreçi.

— Jo — tha Sadriu. — E hapën sot maqinat e ush-
risë.

Vera shikonte herë njërin, herë tjetrin. Ndreçi u ndodh ngushtë. Nga i doli kjo bela e re tani? Ku ta linte Verën?

Dolën. Sadri Leka ecte pak prapa dhe herë pas here kruante zërin. Dita e shkurtër e dimrit kishte mbaruar. Tani nëpër rrugë qenë ndezur dritat e rralla të qytetit të vogël dhe në park rrëzohej hera-herës pluhur bore nga degët e drurëve. Vera që mbështjellë nga të ftohtit dhe në trotuarët e ngrirë dëgjohej hapi i saj.

Te hoteli Ndreçi e la Verën me Sadriun dhe vetë u ngjiti lart.

— Kam një hall — i tha sportelistit. — Të paguaj sa të duash, veç më gjej një dhomë teke.

— Dhomë teke?

— Më duhet medoemos. Kam një shoqe dhe më duhet medoemos një dhomë teke.

— Për atë? — pyeti sportelisti.

— Po — tha Ndreçi.

— Për nder nuk kam po s'ta mbaja. Kanë një mbledhje ato të baxhove dhe e kam të zënë gjithë hotelin. Të ishte për ndonjë djalë, ta rregulloja, po dhomë tek nuk kam.

— Shih, pash nderin se mos më gjen.

— Për kokën e fëmijëve nuk kam. Ja. Shikoje re-
gjistrin.

Sportelstisti nuk gënjente. Ndreçi e njëhte mirë atë. Zuri mjekrën me dorë e nisi të mendohej. Si t'ja bënte tani?

— Të më kishe thënë që në mëngjez... po tani, si

t'ja bëj thua ti? — vazhdonte t'i fliste sportelisi.

Ndreçi i tha «natën e mirë» dhe zbriti shkallët. Sadriu rrinte tre-katër hapa larg Verës, i ulur në parmakun e berberhanes. Vera rrinte në këmbë dhe mbështilte xhaketën nga të ftohtët.

— A të të çoi në dhomën tonë? — i tha Ndreçi. — Hotel s'ka. Mbase është Patriu atje e t'i them të shkojë të flerë në ndonjë vend sonte.

Ajo e pa me sytë e mëdhenj sikur i lutej që të mos ja përmendte më këtë. Sadri Leka rrinte te parmaku dhe heshte si një hije. Ai priste që Ndreçi të mbaronte punë e të niseshin.

— Si t'ja bëj? — i tha Sadriut Ndreçi.

— Pse, si e ke punën? — e pyeti ky, sikur nuk kishte dëgjuar se ç'flitej.

— Kam hallin e Verës — tha Ndreçi. — S'di ku ta rregulloj të flerë.

Sadriu u ngrit e nisi të ecte përpara. Ai u bëri një shenjë që t'i shohin pas.

Arritën te maqina, një «Gaz» pesëvendsh, që shoferi i parë e kishte mbajtur shumë mirë. Po në nëntor ai pat shkuar ushtar dhe maqinën e kishte marrë Sadriu. Me Sadriun Ndreçi nuk kishte ndonjë miqësi. Ai e njëhte fare pak, këtë shofer që s'kishte një muaj e ca që kishte ardhur në ndërmarrje. Dinte për të vetëm një gjë: Sadriut i pëlqente të mburrej para shoferëve se e ngiste maqinën shumë shpejt.

Sadriu hapi derën e «Gazit» dhe ndezi dritat e vogla. Fytyrën e kishte si të trembur dhe faqet i jenë zbehur. «Hipni» ua bëri me kokë dhe vetë u ul në timon.

— Se mos e rregullojmë andej nga Malçi — tha.

Malçi ishte një lagje e largët e qytetit, ku banonin oficerë me familjet e tyre. Ndreçi mendoi se Sadriu njih-te ndonjë njeri atje, hapi derën e pasme dhe futi Verën. Vetë u ul përpara me Sadriun.

— Njeh njeri? — pyeti Ndreçi.

Po Sadriu nuk u përgjegj. Ai pa nga xhami majtas, pastaj pa dhe nga xhami tjetër djathtas dhe e lëshoi maqinën përpara.

Heshtnin të tre.

Kur kapërcyen urën, Ndreçi i tha Verës:

— Nesër do të kthehem patjetër dhe do ta rregullojmë atë punën e nisjes.

Vera nuk foli. Ajo ishte mbështetur në fund të sediles dhe fytyra e saj ngjante si diçka e zbetë që shquhej në errësirë.

U dukën dritat e para të Malçit, ndërtesat dy dhe tri-katshe që ngriheshin në të djathtë të rrugës. Pastaj maqina udhëtonte përmes Malçit, po Sadriu nuk po ndalonte gjëkund. Kaluan dhe shtëpitë e fundit. Rruga doli përsëri në shesh të hapur përmes një lugine të ngushtë dhe të errët. «Ku po shkojmë?» pyeti veten Ndreçi.

Sadriu që përkulur mbi timon dhe e ngiste maqinën me tërë shpejtësinë. Rrotat e saj rrëshqisnin nga akulli, po ai manovronte mirë. Ishte i vjetër në zanat. Ishte 32-33 vjeç dhe thoshte që kishte hipur në timon kur që fare kalama. «Po ku po shkojmë?»

«Gazi» mori një kthesë me shpejtësi dhe u ndodhën papritur përballë postblokut të hyrjes në karburant. Nga kolibja doli një roje me pushkë, një fshatar me setër ushtarake dhe, duke ruajtur sytë që ja vrisnin dritat, u afrua te shoferi. Sadriu i jepte gaz maqinës, motori uturinte e shungullonte. Ai hapi derën e i bërtiti rojes:

— Aty është, ë?

— Kush, more?

— Si, ore, aty qenka! Domethënë nuk e paska vendin të lirë?

— A?

— Të mos gënjejë, turp të ketë. Natën e mirë! Kështu thuaj.

Përplasi derën fort, i mëshoi «Gazit» dhe i dha maqinës prapa me kaq shpejtësi sa të thoje se nga çasti në çast do të gremiseshin diku në honet e natës.

Ndreçi e Vera sikur qenë mpirë. «Ç'po bëhej kështu». Sadriu frenoi me forcë sa kokët e tyre u përplasën prapa, pastaj e lëshoi maqinën përpara me ulërimë, rrotulloi timonin me shpejtësi dhe e futi në rrugën e ekspeditës së Serinës.

— Sadri! — i thirri Ndreçi.

— Nuk e sheh, ç'mizerje! Lërmë, se për nder më vjen t'i futem me dru qenit. Kur s'e kam revolverin me vete. Po do ta shohë nesër ai.

I dha kokës me vrull dhe fërkoj mjekrën pas supit. Ndreçi hapte sytë nga habia. Kjo i dukej si një ëndërr. Ktheu kokën dhe pa nga xhami jashtë. Po dilte hëna dhe shkurret qenë mbuluar krejt nga bora. Vetëm drurët e lartë kishte zënë t'i lëkundte një erë e fortë që frynte nga veriu. Po, ishte rruga e Serinës. Maqina ngjitej e ngjitej nëpër shpatin e një mali. Malçi dhe lugina e errët kishte mbetur atje poshtë. Dritat sa vinin e largoheshin dhe tani gjithshka që kredhur në qetësi dhe nën dritën e kuqërremtë të hënës. Vetëm maqina uturinte si e xhindosur dhe Sadriu hante veten me dhëmbë e grindej me vete për diçka. Ndreçi e pa me bisht të syrit dhe e mami. Shpatullat i kishte të gjëra Sadriu, po Ndreçit ja merrte mendja se e hante.

Kur dolën në një pllajë, Sadriu frenoi me tërbim, fiku motorin dhe doli jashtë.

— Ah, na tani. Për ju e pësova. E shikon?

Ai tregoi me kokë nga xhadeja kryesore atje poshtë në luginë. Atje dukeshin dritat e kuqe të stopëve të një kamioni që shkante tutje.

— Kontrolli rrugor, për nder. Zbritni! Më morët në qafë. Tani do të më heqë patentën. Ju e dini që janë punë me zarar këto. Obobo!

Ndreçi zbriti në tokë.

— Të morëm në qafë? — i tha.

— Unë s'kam si kthehem tani me ju. Zbritni. Kush të beson si e kishim punën ne? Jo, ju, po s'deshët të zbritni, po iki unë.

Ai hapi derën e maqinës dhe mori peliçen. Pastaj shkoi gjatë rrugës, tatëpjetë.

Ndreçi u përmbajt. S'desh të bënte skandal. I digjte dëshira t'i futte një dru të mirë këtij njeriu, por u përmbajt. Gjaku i pat ikur fare nga fytyra dhe mezi mbushej me frymë. I vinte tmerrësisht turp nga Vera. Ajo qëndronte e tulatur në sedilje dhe s'jepte shenja jete.

Frynte erë e fortë që të ngrinte. Hipi në vendin e vet dhe mbylli dyert.

— Mos u mërzit — i tha Verës Ndreçi me një zë që i dridhej. — As unë nuk e kuptoj këtë.

Ajo as foli, as lëvizi dhe as jepte shenja jete. Ndreçi ktheu kokën dhe pa përmes errësirës fytyrën e saj të zbetë dhe sytë e mëdhenj që i pat ngulur diku. E pat mbështetur kokën pas sediljes dhe sikur që lëshuar e tëra.

— Vera, dëgjove?

Ajo tundi kokën lehtë dhe nuk lëvizi.

Kaloi një gjysmë ore. Motori u ftoh dhe këmbët e tyre po bëheshin kallkan.

U dëgjuan hapa që ngjiteshin gjatë rrugës. Ishte Sadriu. Ai kapi dorezën me vrull, hapi derën dhe u ul në timon.

— Paskeni qenë interesant. Mirë. Po ju çoj deri te magazina dhe më leni rehat. Ju e dini që këto janë punë me zarar.

— Mua sikur do të më çoje në Serinë — i tha Ndreçi. — Rrugën e kishin hapur maqinat e ushtrisë.

— Unë s'jam në dispozicionin tënd. Po deshe, ju çoj te magazina, po deshe zbrisni që tani.

U dëgjua një si gulç, pastaj një ngashërim i mbytur. Vera po qante. Nervat e saj nuk e patën duruar më këtë tension.

Sadriu, që qe bërë si i hardallosur, ktheu kokën dhe ja bëri me një zë cinik:

— Kome, kome?

Ndreçi e mbërtheu me një forcë të përbindshme për bërryli dhe i tha:

— Nisu!

— Ku?

Desh t'i thoshte «Në të sat ëme», po u përmbajt nga Vera.

— Ku të të thotë mendja — i tha.

— Mirë! Deri te magazina, atje bëni çfarë të doni.

Ai e nisi maqinën, kurse Ndreçi ktheu kokën nga Vera dhe i tha:

— Mos u shqetëso!

Magazina ndodhej në një shpat mali 1800 metra mbi nivelin e detit. Që atje në Serinë mbanin plot katër orë të mira në këmbë. Dimrit, kur rrugën e Serinës e zinte bora, gjeologët shkonin me maqina deri te magazina dhe pastaj pjesën tjetër e bënin në këmbë. Po ç'kuptim kishte kjo sonte? Të arrije rreth orës 11 në magazinë dhe pastaj të niseshe vetëm nëpër pyje me borë!

«Le të vërtitet si të dojë, qeni! mendoj Ndreçi. U pa kjo punë. Do ta gdhijmë në maqinë».

I kalonin të rrëqethura herë pas here në trup. Si kishte rënë kështu në kurthin e këtij maskarai që tani dukej qartë pse i kishte bërë të gjitha këto! Ç'pat kujtuar ai?

Ktheu kokën dhe e pa me nofulla të shtrënguara. Dhe ai ktheu kokën dhe e pa. Pastaj u përkul nga ana e Ndreçit, ja afroi buzët te veshi, dhe me intimitetin e dy njerëzve të njohur i tha:

— Sa të poshtër u treguat ju. Vetëm për vete e doni.

Ndreçi e vështroi një hop me një gaz plot maraz në buzë, pastaj e ktheu kokën edhe më dhe pa nga Vera. Ajo përsëri qe tulatur në fundin e sediljes dhe heshtte si e vdekur. Sadriu turfulloi me vete dhe fërkoj mjekrën me nervozizëm pas pelices. U linte të kuptonin me këto Verës dhe Ndreçit sa i tërbuar ishte.

— O Sadri! — i thirri Ndreçi, ndërsa zëri i kumbonte nga gazi plot maraz. — Pa ma spjego si qe puna që do t'i gjeje Verës vend për të fjetur në Malç?

Ai i dha kokës prapa dhe qeshi.

— Kome, kome? — ja bëri dhe qeshi prapë.

Si ta kish pickuar një gjarpër, Vera u hodh nga vendi dhe ja flakëriu me shuplakë fytyrës.

— Mbajeni! Mbajeni! — thirri. — Pse ç'kujton, mor maskara? Mbaje!

Ishin të thirrura gjithë dëshpërim e egërsi, zëri i dilte i çjerrë dhe dridhej e shungullonte. Hapi derën e desh të hidhej, po Ndreçi e kapi për krahu dhe i bërtiti:

— Vera!

— Lëshomë, lëshomë.

— Vera!

Zgjati këmbën dhe shtypi pedalin e frenave. Maqina

frenoi. Ai e uli Verën në sedile dhe ju kthye Sadriut:

— Ktheje!

— Ta kthej?

— Ktheje!

Sadriu fërkoj mjekrën pas pelices dhe i tha Verës:

— Dëgjo! Për këtë që më bëre, mund të të shqyjej.

— Ktheje të them dhe mos i folë më asaj!

— S'kam ku ta kthej. T'iu çoj te magazina dhe thye
eni qafën! Asnjë shaka s'dini, as shokë s'jeni. Pse, çfarë
bëra unë? Mirë, mirë.

Ai i futi marshin maqinës dhe e nisi përsëri.

Po afronte mesnata. Jashtë shungullonte era e ftohte e maleve. Bora, që kishin qeruar buldozerët, ngrihej në dy pirgje të mëdha në të dy anët e rrugës. Përballë, nëpër dritën e mekur të hënës, shquhej kurrizi i bardhë i një mali.

Te magazina arritën aty rreth orës 12. Magazina ishte një barrakë dërrasash në një shesh të shkretë dhe fare e vetmuar. Kur nuk ishte bërë rruga e Serinës, aty binin materiale për gjeologjinë dhe që andej deri në ekspeditë i transportonin me mushka. Tani e përdornin për arka kampionesh, meqë në Serinë magazina ishte e vogël.

Sadriu e mbajti maqinën nja 50-60 metra larg magazinës. Dyert e dritaret ishin të mbyllura dhe sheshin rreth saj e rrihte era e ftohtë. 1800 metra mbi nivelin e detit, male që kapeshin varg njëri pas tjetrit dhe lugina të thella që s'u dukej fundi. Ndreçi zbriti dhe shkoi drejt magazinës. Ai shpresonte se mos gjente magazinierin aty. Qëllonte që magazinieri flinte në magazinë, kur e zinte nata. Si që larguar 30-40 hapa, ndjeu ulërimën e Verës që bërtiste e përpëlitej. U kthye dhe rendi drejt maqinës, po në atë çast Sadriu e hodhi Verën në buzë të rrugës, ndezi maqinën, e ktheu si i xhindosur dhe e lëshoi tatëpjetë gjatë rrugës. Iku.

Ndreçit i qe zënë fryma nga rendja dhe, kur arriti te Vera që qe zhytur në borë, e kapi dhe e ngriti. Leshrat e saj qenë shpupurishur, sytë i qenë çakëritur dhe damarët e qafës i qenë fryrë.

— Lërmë, lërmë! — bërtiti ajo dhe qante. — Të gjithë maskarenj jeni. Lërmë!

— Vera, Vera! — e shkundi Ndreçi.

Nervat e tij s'e duruan dot të gjithë këtë. Zëri ju trash dhe ju pre në grykë.

— Maskarenj! Maskarenj! Maskarenj!

Ajo i bërtiste me gjithë zërin, dridhej e shungullonte. I shpëtoi nga duart dhe rendi, po Ndreçi e arriti dhe i thirri me zë të trashur:

— Vera! Hajde të mbledhim veten. Të lutem shumë!

Ai kapi ballin me dorë. I qe mbledhur një lëmsh i madh në grykë. E gjitha i dukej si një ëndërr. Tri net më parë, ndërsa priste të vinte autobusi me Verën dhe Ramën, ai ndjente një lloj emocion të çuditshëm nga kjo vajzë që rrinte midis tyre. Dhe kjo kishte ardhur, ai pat dalluar kokën e saj të bukur prapa xhamit të autobusit dhe kishte ndjerë një gëzim të çuditshëm në zemër. Jetën që do të vazhdonte më tej Ndreçi e përfytyronte kështu: Ajo me Ramën do të merrnin një dhomë dhe Vera do ta rregullonte atë bukur. Ai dhe Patriu, si shokë të Ramës dhe të saj, kur të vinin nga puna, do të ktheheshin tek ata dhe Vera do t'u bënte çaj. Ndreçin e ngrohte shumë kjo gjë. Ai do t'u priste dru, do të vërtitej midis tyre si një vëlla, të dielave do ta çonte Verën në sport, mbasi Ramës sporti nuk i pëlqente. Ishte viti 1959 dhe gjeologjia sapo kishte filluar në atë krahinë veriore. Kur kishin ardhur, kishin qenë 18 gjeologë, sondistë e motoristë, dhe kishin nisur punën në një ekspeditë të vetme. Po tani, pas tre vjetësh, qenë bërë nëntë ekspedita me treqind e ca veta. Kishin kaluar dimra të ftohta bashkë, kishin hequr mbi shpinë izolimet e borës, telashet e transportimit të maqinerisë rrugë e pa rrugë maleve nëpër trupat e mineralit. Të gjitha këto i kishin bërë shokë. Mund të të zinte nata në cilëndo ekspeditë dhe të gjithë i kishe shokë. E njihnin njëri-tjetrin nga peliçet, nga duart me vaj dhe nga fytyrat e argasura nga era.

Ndreçi as që e merrte me mend se në një ambient të tillë do të ndodhte një histori kaq e hidhur. Tri net

dhe ja Vera ku ndodhej me të thellë në male, midis të ftohtit dhe natës.

E dëshpëruar, e zhgënjyer nga dashuria me Ramën, e fver nga një maskara si Sadriu. Po përse?

— Hajde, Vera! Bën shumë ftohtë.

Ajo qe tulatur tani pas atij shpërthimi dhe dridhej. Ishte me xhaketën e hollë dhe me çorapet setapuro. Mërdhinte.

Ndreçi hoqi peliçen.

— Vishe! — i tha.

Ajo e mori dhe e veshi. Ndreçi kishte një xhaketë doku dhe një triko leshi të trashë me grykë.

— Do t'i harrojmë të gjitha — tha Ndreçi, ndërsa nisën të shkonin drejt magazinës. — Asgjë s'do të mbajmë mend nga kjo — foli përsëri ai me një lloj gëzimi që i gurgullonte përbrenda.

Ajo ishte e verdhë si meiti dhe nuk foli fare.

— Do t'i harrojmë patjetër. Vera.

Ai nuk e thoshte përse do t'i harronin të gjitha, po Ndreçi kishte parasysh faktin se njerëzit e gjeologjisë nuk ishin ata që pat njohur ajo.

Atie larg, në shpatin e një mali, u dukën dritat e maqinës së Sadriut që doli nga një kthesë.

— Vetëm më vjen keq për një gjë, — tha Ndreçi me sy të ngulur andej nga maqina — kush m'i preu krahët mua që s'i dhashë një dru atij?

Tundi kokën me hidhërim, nisi të ecte dhe pas pesë-gjashtë hapash tha:

— Desha t'a mbyllja pa skandal këtë punë, se këtu ishe ti. Po nejse! Këtu jemi.

Ai ndali, fytyra i qe prishur dhe gati thirri duke tundur dorën në ajër:

— Maskarai!

Sheshi i magazinës ishte i ngrirë. Ndreçi vuri re se dyert ishin mbyllur me dryj. Shkoi te një dritare dhe e shtyu fort. Dritarja nuk hapej. Provoi një tjetër, po edhe ajo ishte e pamundur që të hapej. Të ftohtët dhe era të grinte. Nisën të vërtiteshin rreth mureve, po ishte e pamundur të gjeje një vend ku s'të zinte era.

Ndreçi e dinte se një gjysmë ore larg magazinës, ndodhej një fshat. I tha Verës të shkonin atje dhe u nisën. Po, sa bënë 200-300 hapa, ndien ulërimat e qenve. Në fshat ishte e pamundur të hyje në atë orë. U kthyen prapë dhe arritën te magazina. Pastaj u nisën për në Serinë

* * *

Të nesërmen pasdite u kthyen nga Serina dhe, me të arritur në qytet. Ndreçit i thanë se e kërkonte drejtori. Ata erdhën me kamionin e Kolës që çoi koronka gjer te magazina dhe Kola i tha se drejtori qe zemëruar shumë. Ai i tha gjithashtu se Sadri Leka e kishte lënë maqinën para drejtorisë dhe kishte ikur.

Ndreçi nuk i pat thënë gjë Kolës. I vinte keq vetëm për Sadriun që kishte ikur. Me një maskara të tillë kishte qeif të këmbente nja dy fjalë.

Zbritën tek ura dhe shkuan drejt barrakave të drejtorisë.

Ngjitën shkallët dhe Ndreçi trokiti në derë.

— Hajde. — i tha drejtori — lëre pak atë shoqen dhe hajde ti.

Fytyrën e kishte të ngrysur dhe shikonte xhamin e tryezës. Ndreçi ju ul përballë.

— S'e marr vesh — tha drejtori. — S'ma merrte mendja që do të bëje ti gjëra të tilla.

— Ç'farë, për shembull. po bëj unë. shoku drejtor? — tha Ndreçi.

— E vogël është kjo? Merrni maqinën për punë të tilla?

— Po të ishte edhe ti në vendin tim, shoku drejtor, kështu do ta pësoje.

— Si do ta pësoja kështu?

— Do të të gënjente ai maskara, ti do të besoje dhe do të shkoje me të. Pastaj, do të të linte në mes të rrugës siç na la ne. Dhe vetë pastaj mbyll maqinën dhe kri-sën e ikën. Të duket e pabesueshme kjo?

Drejtori po e shikonte me vë nendje. Ai heshti një hop. pastaj i uli sytë përsëri dhe tha:

— Mirë, mirë. Mbylleni tani këtë dhe atë shoqen ni-seni.

— Kurse unë them ta mbajmë. Bisedova me të, kështu s'ka si ikën ajo dhe po t'i gjejmë një vend, ta mbajmë të punojë këtu.

Drejtori tundi kokën.

— Jo, jo — tha.

— Po përse, xhanëm? — e pyeti Ndreçi, ndërsa ndjeu gjakun që i kërceu në fytyrë.

— Se do të na ndodhin histori të tjera — tha drejtori.

— Pse?

— Për ç'punë erdhi ajo këtej?

— Erdhi te Rama. Ajo e donte Ramën. Kurse Rama, ja, po ta them shoku drejtor, u tregua një maskara.

Drejtori buzëqeshi si me ironi.

— Ku ta dinte ai? — ja bëri.

Ndreçi shtriu krahët në tryezë dhe e vështroi drejt:

— Çfarë të dinte? Pse, ç'është ajo sipas mendjes suaj?

— Dëgjo, dëgjo, — ja bëri drejtori — lëri avokatletet. Ç'është ajo sipas mendjes sate?

— Një vajzë e mrekullueshme që vuan këto ditë në shpinën e saj mykun e mendjeve tona. Po ta them me plot gojën, është një njeri i mrekullueshëm. Po tani unë e di si arësyetojmë ne: Ç'do kio vajzë kaq e bukur këtej? Ajo vjen nga një qytet i madh dhe ne themi: Si ikën ajo nga qyteti i saj dhe vjen këtu? Ajo është një vajzë e zgjuar dhe ne themi: S'mund të gjente një djalë tjetër si Rama ajo andej nga vendi i vet?

— Po pikërisht — tha drejtori. — Dhe kështu mund të mendojmë.

Ndreçi buzëqeshi me maraz:

— Po pse të mos mendojmë se ajo e dashuron Ramën? Se për këtë dashuri nuk pyet për asgjë dhe vjen këtu njësoj si do të shkonte kudo? Përse duhet të jetë imorale ajo që të vijë tek ne?

— Pse do ta linte Rama atëhere? — e pyeti drejtori.

— Sepse Rama është gjithashtu i mykur, maskara, do të thosha. Dhe ai kështu arësyeton.

Ndreçi brofi në këmbë. damarët i qenë fryrë dhe shkoi e hapi derën.

— Hyrë, Vera — i tha ai.

Ajo hyri, përshëndeti lehtë me kokë dhe qëndroi në këmbë.

— Kjo është ajo, shoku drejtor, e keni parë? A mund të jetë kjo një vajzë e ligë? Ramëra dhe Sadrira mund të hedhin baltë mbi këtë, po, po të kemi vdekur ne, atëhere mund të përlyhet kjo.

Vera qe skuqur dhe rrotullonte sytë sa te njëri te tjetri. Drejtori kishte mbetur gojëhapur. Ai po shikon-te Verën që qëndronte përballë tij dhe sikur qe topitur.

— Ku ke punuar më parë? — e pyeti.

— Isha nëpunëse arke në bankë — tha ajo.

— Po pse erdhe... nejse, ulu!

Ai çoi gishtat në flokë. mbështeti kokën në pëllëmbë dhe vështronte jashtë. Fytyra e ngrysur po i zbutej dalëngadalë. Ndreçi kishte ulur kokën dhe tundej lehtë në karrige duke u zënë me mendimet e veta.

— Atyre do t'u vijë turp — tha ai si me vete — Ne të gjithëve duhet të na vijë turp nga kjo.

Drejtori vazhdonte të shikonte jashtë. Verës po i skuqeshin faqet dhe në flokët e errët po i treteshin kristalet e borës.